

---

# PËRMBAJTJA E REVISTËS:

---

Numri XXVIII, viti 2005

Faqe

---

*Reforma zgjedhore:*

Sistemet zgjedhore në zgjedhjet pluraliste në Shqipëri:avantazhet, disavantazhet dhe mësimet e nxjerra	Luan OMARI	4
Sistemi zgjedhor dhe problemet e përfaqësimit në Kuvend	Niazi JAHO	11
Sistemi zgjedhor dhe stabiliteti në qeverisje	Gent IBRAHIMI	17
Barazia gjinore dhe sistemet e kuotave zgjedhore për gratë	Aurela ANASTASI	25
Sistemi proporcional zgjedhor, anët pozitive dhe implikimet e mundshme në vendin tonë	Damian GJIKNURI	34
Problematika e sistemit proporcional në raport me realitetin shqiptar	Blendi KAJSIU	45
Ndryshimi i sistemit zgjedhor dhe pjesëmarrja në këtë proces	Kristaq KUME	59
Shprehja e sovranitetit të popullit: mënyrat e votimit	Jacques CADART	69

---

## TABLE OF CONTENTS:

---

28<sup>th</sup> issue, year 2005

---

	Page
<i>Electoral reform:</i>	
Electoral systems on the pluralist elections in Albania: advantages, disadvantages and lessons learnt	
Luan OMARI	4
Electoral system and representation problems in the Parliament	
Niazi JAHO	11
Electoral system and the stability in governance	
Gent IBRAHIMI	17
Gender equality and the electoral quating system for women	
Aurela ANASTASI	25
Proportional electoral system, positive sides and the eventual implications in our country	
Damian GJIKNURI	34
Problematic of the proportional electoral system toward the Albanian reality	
Blendi KAJSIU	45
The change of the electoral system and the participation in this process	
Kristaq KUME	59
The expression of the people's sovereignty: ways for voting	
Jacques CADART	69

---

*Në këtë numër të revistës botohen prezantimet e paraqitura në konferencën “Sistemi zgjedhor në kontekstin shqiptar”, organizuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, më datë 27 janar 2006.*

*Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.*

## Sistemet zgjedhore në zgjedhjet pluraliste në Shqipëri: avantazhet, disavantazhet dhe mësimet që mund të nxirren

*Prof. Luan Omari*

Në axhendën e partive politike shqiptare dhe të institucioneve kushtetuese si Kuvendi dhe Presidenti i Republikës është vënë përsëri ndryshimi i Kodit Zgjedhor, madje edhe mundësia e ndryshimit të sistemit zgjedhor, çka do të kërkonte edhe ndryshimet përkatëse në Kushtetutë.

Përvoja jo e mirë e zgjedhjeve të 3 korrikut 2005, kritikën e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe pakënaqësitë e shprehura nga shumë parti politike, në veçanti edhe nga dy partitë më të mëdha, për zhvillimin e zgjedhjeve, për disa dukuri që deformuan vullnetin real të zgjedhësve, e bëjnë jo vetëm të dobishëm, por edhe të domosdoshëm një diskutim të thelluar për reformën zgjedhore.

Dihet se me sistem zgjedhor, në kuptimin specifik të këtij termi, kuptohet tërësia e normave juridike që përcaktojnë mënyrat se si votat e hedhura gjatë zgjedhjeve të përgjithshme ose gjatë zgjedhjeve për qeverisjen vendore shndërrohen në vende të fituara nga partitë pjesëmarrëse ose nga kandidatët e tyre dhe nga kandidatët e pavarur.

Sipas studiuësve të sistemeve zgjedhore, numri i tyre aktualisht është shumë i madh, ai arrin në disa qindra, por të gjitha këto sisteme mund të kategorizohen në tri grupe ose familje të gjera: mazhoritar, gjysmë proporcional (ose i përzier) dhe proporcional. Këto tri grupe mund të ndahen në nëntë sisteme kryesore.

Veçori dalluese e sistemeve mazhoritare është se ato pothuaj se gjithmonë përdorin zona me lista njëemrore kandidatësh. Një variant i sistemit mazhoritar është zhvillimi i zgjedhjeve në një raund, në të cilin fiton ai kandidat që fiton më shumë vota se të tjerët.

Ndërsa një variant tjetër i sistemit mazhoritar është ai që parashikon që kandidati fitues duhet të marrë shumicën absolute, pra mbi 50 për qind të votave. Në rast se asnjë kandidat nuk e arrin këtë shumicë, zhvillohet një raund i dytë ku hyjnë dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota dhe në këtë raund fiton ai që merr më shumë vota se tjetri.

Sistemi proporcional bazohet në parimin e barazisë ndërmjet votave të fituara nga një parti në shkallë vendi dhe vendeve që ajo merr në organin e zgjedhur (parlament a këshill bashkiak). Edhe në sistemin proporcional ka një numër variantesh, ndër të cilat, krahas atij që bazohet te përdorimi i listave partiake në shkallë vendi ose kombëtare, është edhe ai i sistemit proporcional në bazë rajonale.

Sistemet gjysmëproporcionale ose të përziera kanë, gjithashtu, një numër jo të vogël variantesh. Ndër to, në bazë të raportit midis aspektit proporcional dhe atij mazhoritar, dallohen sistemi proporcional i korigjuar me elemente mazhoritare dhe sistemi mazhoritar i korigjuar me elemente proporcionale.

Duke analizuar praktikën zgjedhore të 150 shteteve, Bashkimi Ndërparlamentar ka vërejtur se në morinë e sistemeve zgjedhore mbizotëron ai mazhoritar, por gjithmonë e më shumë shtohen metodat e ndryshme të përfaqësimit proporcional, si dhe sistemet e përziera.

Në parim, çdo sistem ka anët e veta pozitive dhe negative. Nuk ekziston një sistem që të jetë absolutisht i preferueshëm ndaj të tjerëve. Është më i mirë ai sistem që u përgjigjet në mënyrë më adekuate kushteve politike, gjeografike dhe traditave historike të një vendi konkret.

Në Shqipëri, gjatë periudhës së tranzicionit, që nga viti 1991 e deri më sot janë zhvilluar gjashtë zgjedhje të përgjithshme, me pesë sisteme të ndryshme, çka tregon qartë një mungesë stabiliteti, e kushtëzuar edhe nga fakti se, si

rregull, pala humbëse gjithmonë e ka kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve.

Siç dihet, zgjedhjet e para u zhvilluan më 31 mars 1991, mbi bazën e një sistemi mazhoritar, të trashëguar nga regjimi komunist. Megjithëse në parim, sikurse u tha më lart, një sistem i tillë është plotësisht demokratik, në kushtet konkrete të asaj kohe ishte e qartë se ai favorizonte Partinë e Punës, e cila mbante ende në duart e saj levat e pushtetit, kyçet e ekonomisë dhe drejtimin e mjeteve kryesore të informacionit, ndërsa partitë e opozitës, të krijuara pak muaj më parë, ishin në organizim e sipër.

Parlamenti i parë pluralist, më 4 shkurt 1992, miratoi ligjin e ri “Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.

Ky ligj përcaktonte që Kuvendi Popullor do të përbëhej nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 të zgjedhur drejtpërsëdrejti në bazë të një liste njëemërore për çdo parti politike. Në çdo zonë zgjedhore fitonte kandidati që merrte më shumë se 50 për qind të votave në raundin e parë, përndryshe do të zhvillohej balotazhi në raundin e dytë ndërmjet dy kandidatëve me më shumë vota. Krahas listës njëemërore, çdo parti kishte mundësi të paraqiste kandidatët e vet në një listë shumemërore ose të përgjithshme. Një parti politike mund të kishte deputetë të zgjedhur në listën e përgjithshme, me kusht që kjo parti të fitonte jo më pak se 4 për qind të votave në shkallë kombëtare.

Me këtë sistem zgjedhor, që i ngjiste atij gjerman, ligjvënësi synonte që të arrihej barazia më e mundshme e votave, por njëkohësisht që të shmangej copëzimi i Parlamentit, çka do të krijonte vështirësi për formimin e një shumice të qëndrueshme, që të mund të qeveriste. Pra, ligji i synonte të bashkonte drejtësinë dhe barazinë e votës, të lidhura me sistemin proporcional, me nevojën e krijimit të një shumice të qëndrueshme, të siguruar nga sistemi mazhoritar. Për këtë arsye, sistemi ishte në thelb proporcional i personalizuar me elemente mazhoritare.

Ligji zgjedhor i 1992-së u miratua me një konsensus të përgjithshëm dhe përvoja e zbatimit të tij ka qenë pozitive.

Pas mbarimit të legjislaturës, më 26 maj 1996 u zhvilluan zgjedhje të reja për Legjislaturën e 14-të të Kuvendit, pasi ky kish miratuar disa ndryshime në ligjin zgjedhor. Ndryshimi kryesor parashikonte që, duke ruajtur cakun minimal të 4 përqindshit, që i duhej çdo partie për të pasur deputetë të zgjedhur në listën shumemërore, caku për grupimet ose koalicionet zgjedhore të formuara nga dy parti caktohej në 8 përqind, dhe në rast se koalicioni do të përfshinte 3 ose më shumë parti, caku rritej në 4 përqind për çdo parti.

Sistemi i parashikuar ishte demokratik, por kjo nuk pengoi një sërë shkeljesh flagrante që karakterizuan zgjedhjet e 26 majit 1996.

Kriza e re politike provokoi zgjedhje të parakohshme që u zhvilluan më 29 qershor 1997. Në pragun e këtyre zgjedhjeve Kuvendi miratoi ndryshime të tjera në ligjin zgjedhor. Numri i deputetëve u caktua në 155, nga të cilët 115 të zgjedhur drejtpërsëdrejti në çdo zonë, ndërsa 40 mandatet e tjera u ndaheshin kandidatëve të përfshirë në listat shumemërore të partive të ndryshme, në bazë të votave të fituara në shkallë vendi në raundin e parë. Për të fituar mandate në listat shumemërore, caku minimal i votave që duheshin marrë u ul nga 4 në 2 përqind.

Analiza e ndryshimeve në këtë ligj zgjedhor mund të nxjerrë në pah dy karakteristika kryesore:

1) Me caktimin e saktë të numrit të deputetëve (155) dhe të numrit të të zgjedhurve midis kandidatëve të listave shumemërore, sistemi zgjedhor, nga proporcional me elemente mazhoritare, u bë mazhoritar me elemente proporcionale (ose mazhoritar i korrigjuar).

2) Ulja e caktuar nga 4 në 2 përqind, që favorizonte partitë e vogla, kompensonte dëmin që ato mund të pësonin nga përforsimi i elementit mazhoritar.

Aktualisht, neni 64 i Kushtetutës në fuqi përcakton sistemin zgjedhor, që është përsëri mazhoritar i korrigjuar. Numri i deputetëve është caktuar në 140; 100 zgjidhen drejtpërsëdrejti në zonë dhe 40 në bazë të listave shumemërore. Në këtë mënyrë, përfundimi global i afrohet një ndarjeje

proporcionale. Caku i nevojshëm për të përfituar nga pjesa proporcionale është 2.5 për qind për një parti politike dhe 4 për qind për një koalicion partish.

Meqenëse paragrafi 2 i nenit 64 të Kushtetutës thotë vetëm se numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicion partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve, mbeti që të përcaktohej formula e saktë e llogaritjes së vendeve në Kuvend. Kjo u bë në Kodin Zgjedhor të vitit 2000, që u zbatua në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001. Mirëpo, kjo formulë ishte e ndërlikuar dhe jo e qartë, kështu që ajo u ndryshua me amendamentet që iu bënë Kodit Zgjedhor më 2003, nga i ashtuquajtimi komision bipartizan. Por edhe kjo formulë e fundit ishte përsëri e ndërlikuar dhe e paqartë, siç e vërente edhe raporti i paraqitur nga Komisioni i Venecias dhe ODHIR, i cili sugjeronte hartimin e një formule të re, që të zbatonte me saktësi dhe qartësi më të madhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës.

Një nga ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor më 2003, që prekte edhe sistemin zgjedhor të zbatuar deri në zgjedhjet vendore të tetorit 2003 dhe të parashikuar në nenin 64 të Kushtetutës, ishte kalimi në zgjedhje me një raund, në të cilin fiton kandidati që merr më shumë vota se të tjerët, por jo detyrimisht shumicën absolute. Eliminimin e raundit të dytë e sanksionoi edhe një vendim i Gjykatës Kushtetuese që interpretonte pikërisht nenin 64 të Kushtetutës, vendim ku afirmohej se raundi i dytë, për të cilin bën fjalë ky nen, kuptohej vetëm si një mundësi, nëse do të parashikohej në Kodin Zgjedhor, dhe jo si një detyrueshmëri.

Në këtë mënyrë u ruajt sistemi i tanishëm i përzier, me raportin numerik ekzistues midis deputetëve të zgjedhur në listat njëemërore dhe në ato shumëemërore, por me një thjeshtësim të dukshëm të procesit zgjedhor.

Me ndryshimet e vitit 2003 në Kodin Zgjedhor u vendos të kishte vetëm një fletë votimi në të cilën zgjedhësi të shprehte preferencën, veçmas, si për partinë politike (sipas listës shumëemërore, ashtu edhe për kandidatin në listën



njëemërore). Mendoj se ky ndryshim pati pasoja negative. Së pari, në rastet kur zgjedhësi votonte për një kandidat të një partie, por njëkohësisht, sipas listës shumemërore, për një parti tjetër nga ajo e kandidatit, fleta e votimit e hedhur rregullisht në kuti, quhej e pavlefshme nga komisioni i qendrës së votimit. Kjo e rriti shumë numrin e fletëve të shpallura të pavlefshme në shkallë vendi. Së dyti, kjo bëri të mundshme atë dukuri që u quajt “fenomeni i Dushkut”, që ndodhi në një zonë të vetme zgjedhore, por që pati pasoja vendimtare në krijimin e një shumice të madhe në Kuvend nga partia që fitoi zgjedhjet.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor në vitin 2005, përpara zgjedhjeve të 3 korrikut, në disa drejtime sollën përmirësime, por në disa drejtime të tjera patën pasoja negative. Një ndryshim ishte edhe përdorimi i dy fletëve të votimit: njëra për kandidatin e zonës përkatëse dhe tjetra për partinë e preferuar. Ky ndryshim në parim ishte i drejtë dhe nuk cenonte vullnetin e lirë të zgjedhësit, i cili mund të preferojë një kandidat të caktuar, por jo parti. Por ai bëri të mundur që të favorizonte atë dukuri që u cilësua si “Dushku i madh”, që u vërtetua jo më në një zonë zgjedhore por në shkallë vendi.

Nga kjo analizë, sado e shkurtër dhe sipërfaqësore, e zgjedhjeve të deritamishme, mund të nxirren disa përfundime:

1. Sistemi mazhoritar me një mund, që funksionoi në zgjedhjet e 3 korrikut 2005 për sa u përket zonave njëemërore, pasqyroi një dukuri negative që është vënë në dukje edhe nga shumë studiues e specialistë që kanë analizuar zbatimin e këtij sistemi në vendet anglosaksone. Kjo dukuri është se diferenca midis dy partive kryesore, përsa u përket vendeve të siguruarra në Kuvend, është mjaft më e madhe se sa ajo që rezulton nga votat e marra nga secila prej tyre.

Për këtë arsye, mendoj se ndoshta duhet rikthyer te sistemi me një mund që pjesërisht e eliminon këtë anomali dhe konsiderohet disi “më i drejtë” se i pari. Përparësia e sistemit me një mund është se u lejon zgjedhësve që të shprehin një preferencë për një kandidat në raundin e parë, pavarësisht se

ky kandidat mund të mos ketë shanse për t'u zgjedhur. Vetëm në raundin e dytë partitë e ndryshme grupohen dhe atëherë zgjedhësi, pasi kandidati i tij është eliminuar, mund të votojë për një tjetër, që i duket më i mirë se sa të tjerët që kanë mbetur në arë.

Ruajtja e pjesshme e sistemit mazhoritar, sidoqoftë, do të garantonte një rol më të madh të bazës së partive dhe të zgjedhësve në caktimin e kandidatëve.

2. Zbatimi i pjesshëm i sistemit proporcional te ne ka forcuar rolin dhe ndikimin e partive në jetën politike, sepse në këtë sistem (me listat shumëmore) zgjedhësi voton jo aq shumë për njerëzit se sa për partinë në tërësi dhe programin e saj. Nga ana tjetër, edhe deputeti është i vetëdijshëm se mundësitë për zgjedhje varen kryesisht nga vendi rendor që ai ka në listën e paraqitur nga partia. Prandaj për të, më shumë se vlerësimi nga zgjedhësit, kanë rëndësi lidhjet me udhëheqjen e partisë, çka favorizon edhe shfaqjet e konformizmit dhe të karrierizmit.

3. Sistemi i përzier, i zbatuar në vendin tonë, sidomos në zgjedhjet e vitit 1992, ka pasur një përvojë pozitive, duke kombinuar anët e mira të mazhoritarit dhe të proporcionalit. Përvoja do të kish qenë edhe më pozitive sikur formula e parashikuar në Kodin Zgjedhor për ndjekjen e vendeve në Kuvend t'i përgjigjej plotësisht kërkesës së nenit 64, paragrafi 2 i Kushtetutës, që parashikon një rezultat sa më proporcional edhe në kushtet e një sistemi të përzier.

Anomalitë e përsëritura në zgjedhjet e ndryshme nuk e kanë burimin te sistemi zgjedhor, por te dukuri të tjera negative, si manipulimi i votave, presionet e ndryshme mbi zgjedhësit, mangësitë e mëdha në listat zgjedhore, taktikat jo korrekte në aleancat ndërpartiake etj. Shumë nga këto mangësi, po të ekzistojë një vullnet i mirë politik, mund të shmangen edhe pa ndryshimin e sistemit.

Megjithatë, për këtë çështje, fjala e fundit u takon partive politike.

## Sistemi zgjedhor dhe problemet e përfaqësimit në Kuvend

*Niazi Jaho*  
*Jurist*

Për çdo vend demokratik zgjedhja e sistemit zgjedhor është një ndërmarrje e një rëndësie të veçantë. Ai ndikon thellë në jetën politike të këtij ose atij vendi. Për të krijuar një sistem të përshtatshëm zgjedhor, ne na u desh të kërkonim asistencën e specializuar të ekspertëve të huaj dhe sidomos të Komisionit të Venecias. Në të njëjtën kohë, u mbajtën parasysht edhe kushtet konkrete të vendit tonë, siç mund të jenë tradita, shkalla e emancipimit demokratik, niveli arsimor dhe kulturor etj. Sistemi zgjedhor u sanksionua në nenin 64 të Kushtetutës, ku thuhet:

“1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drejtpërsëdrejti në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish, 40 deputetë zgjidhen nga listat shumëemërore të partive sipas renditjes në to.

2. Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

3. Partitë që marrin më pak se 2.5 për qind dhe koalicionet e partive që marrin më pak se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve nuk përfitojnë nga listat shumëemërore përkatëse.”

Sistemet zgjedhore që sanksionohen në Kushtetutë supozohet të kenë jetëgjatësi si edhe vetë Kushtetuta.

Përvoja e disa vendeve demokratike ka vërtetuar se para ndryshimeve të këtij ose atij sistemi zgjedhor, për një kohë të gjatë janë zhvilluar diskutime dhe debate të thella dhe të gjithanshme. E njëjta gjë mendoj se duhet të ndodhte edhe te ne, por duket se nuk po ndodh kështu. Ne e kemi bërë zakon që me reformën zgjedhore të angazhohemi në prag të zgjedhjeve ose pas raporteve të OSBE/ODIHR-it dhe jo në vazhdimësi. Mund të themi se për çështje që kërkojnë kohë, studime më të thelluara dhe argumente më të plota, siç është, p.sh., problemi i sistemit zgjedhor ose çështje të tjera të karakterit kushtetues, përvoja e deritanishme mendoj se nuk ka qenë rezultative. Lidhur me këtë çështje, praktika ka vërtetuar, gjithashtu, se kur aktorët politikë nuk njohin informacionin bazë dhe rezultatin e studimeve në këtë fushë, janë të prirur të marrin vendime me ngarkesa subjektive. Ka edhe raste kur njohuritë mbi sistemin zgjedhor ata i përdorin për të përkrahur sistemin që është në favorin e tyre në një situatë të caktuar dhe jo duke e vlerësuar çështjen në kompleks.

Shumica e partive politike te ne ose një pjesë e mirë e përfaqësuesve të tyre, janë shprehur për ndryshimin e nenit 64 të Kushtetutës, sepse vetëm kështu, siç thuhet, do të parandalohet dalja përsëri në skenë e “dushkut”. Pyetja e parë që mund të bëhet do të ishte: “Po të mos ishte “dushku” a do të kërkohej ndërrimi i sistemit? Në qoftë se po, atëherë problemi, edhe pse i qartë, mbetet për t’iu nënshtruar një debati gjithëpërfshirës.

Pyetja e dytë që mund të bëhet: “A është neni 64 i Kushtetutës ai që prodhoi “dushkun”, ose “dushku” është rezultat i mungesës së vullnetit politik dhe i mospërputhjeve të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor me nenin 64 të Kushtetutës (është fjala për proporcionalin), si dhe për shkak të konfunzionit dhe paqartësive të këtyre dispozitave ose të boshllëqeve që u shfrytëzuan nga partitë politike në strategjinë e tyre të “dushkut”? Kam mendimin se nuk është neni 64 i Kushtetutës që prodhoi “dushkun”.

Po të jetë kështu, përse atëherë kërkohet ndryshimi i sistemit zgjedhor? Mos vallë ndryshimi kërkohet kryesisht për reduktimin e numrit të deputetëve

dhe rritjen e pragut zgjedhor? Edhe kjo mund të jetë e diskutueshme, por kryesorja është sistemi.

Një “dushk i vogël” u vërtetua edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Në atë kohë disa parti politike siç ishin PSD, PAD, PBDNJ iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e dy neneve të Kodit Zgjedhor (neni 66, pika “ç” dhe “d” dhe neni 87) si antikushtetuese. Ishin nene që rregullonin proporcionalin, por Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetuese vetëm njërin prej tyre, nenin 66 pika “d”, sepse ajo nuk mund të vendoste për zbrazëtitë ose pasaktësinë në ligj. Organizmat ndërkombëtarë në atë kohë deklaruan se PS-ja fitoi, por shkalla e fitores ishte më e madhe se ç’duhet të ishte. Në shprehjen “më e madhe” duhen kuptuar deputetët që prodhoi “Dushku i vogël”, që reflektoi në përfaqësimin në Kuvend si rrjedhim edhe në një farë cenimi të legjitimitetit të tij.

Qysh nga viti 1991 dhe deri më sot në asnjë dokument ose rekomandim të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias as mbas “Dushkut të vogël” dhe as mbas “megadushkut” të 3 korrikut 2005, kur është folur për kuadrin ligjor në përgjithësi dhe për dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë për proporcionalin nuk është ngritur asnjë fije dyshimi për nenin 64, nuk është thënë asnjë fjalë për ndonjë ndikim të tij në atë deformim që ndodhi. Them deformim, sepse sidomos zgjedhjet e 3 korrikut vërtetuan se strategjia e “Dushkut” ishte e ndjeshme dhe e pranishme, e zellshme dhe e ndërgjegjshme, deformuese për vullnetin e zgjedhësve dhe e transmetueshme në përfaqësimin joreal në organin më të lartë legjislativ, Kuvendin. Megjithëse disi më ndryshe dhe në një shkallë më të vogël, kjo strategji, siç përmendëm edhe më lart, u zbatua edhe në vitin 2001. Dispozitat e Kodit Zgjedhor për shpërndarjen e mandateve plotësuese në pjesën më të madhe të tyre mbetën të pandryshuara. Vëzhguesit e misioneve të huaja në Shqipëri në raportet paraprake të zgjedhjeve të 3 korrikut evidentuan këtë deformim (që fatkeqësisht nuk u parandalua) dhe theksuan se nuk dinin shkallën, masën ose shtrirjen e tij. Në një shoqëri demokratike, në kushtet e zgjedhjeve të

lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, rotacioni i pushtetit është normal.

Por kur maxhoranca me çdo kusht kërkon të mbajë pushtetin, ndërsa opozita, me çdo kusht kërkon ta marrë atë, dukuritë negative janë të pashmangshme. Pikërisht ky koncept i zbatuar në praktikë cenon zgjedhjet e lira dhe standardet që kërkohen.

Në përgjithësi, me ndonjë përjashtim, përfaqësuesit e partive tona gjithmonë kanë deklaruar se në përmirësimet e mëtejshme të legjislacionit në fushën e zgjedhjeve do të mbanin parasysh dhe do të zbatonin rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias. Duke studiuar raportin e OSBE/ODIHR-it të 7 nëntorit 2005, kam përshtypjen se ky raport dhe rekomandimet e tij ende nuk janë studiuar siç duhet ose janë studiuar, por me këtë ose atë çështje mund të ketë vërejtje. Kjo është normale, megjithëse mendoj se duhet pritur edhe ecuria e diskutimeve që do të zhvillohen në komisionin e Kuvendit të ngritur për këtë qëllim. Për të qenë më të qartë, e kam fjalën për sistemin zgjedhor, OSBE/ODIHR-i ka rekomanduar që disa dispozita që kanë të bëjnë me proporcionalin të formulohen dhe të zbatohen në atë mënyrë që të përputhen me nenin 64 të Kushtetutës. Por në këtë raport lihet e hapur edhe dëshira e autoriteteve shqiptare për të rishikuar sistemin aktual.

Mendoj se edhe pa ndryshuar sistemin, nëpërmjet ndryshimeve të dispozitave të Kodit Zgjedhor mund të parandalohet “Dushku”. Komisioni i Venecias dhe i OSBE/ODIHR-it, qysh në prill të vitit 2004, vinin theksin te ndërlikimi i shpërndarjes së mandateve në nenet 65--68 të Kodit Zgjedhor, që më 2003 u bënë edhe më të ndërlikuara me “lista shumëmemërore të përbashkëta” etj. Por me gjithë rekomandimet për t’i bërë ato me të kuptueshme dhe më të plota, asgjë nuk u bë gjatë ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në janar të vitit 2005.

Partitë e mëdha, thuhet në raportin e OSBE/ODIHR-it të 7 nëntorit 2005, me strategjinë e tyre dëmtuan objektivin kushtetues për proporcionalitetin

“në raport sa më të afërt” të sistemit zgjedhor.

Kuadri ligjor nuk siguron realizimin e objektivit të shprehur të Kushtetutës. Ai nuk krijon një Kuvend të bazuar mbi parimin e përfaqësimit proporcional. Partitë politike mund të anashkalojnë synimin e sistemit zgjedhor dhe të shtrembërojnë mandatet plotësuese në favor të tyre. Ky nuk është konkluzioni im, por i OSBE/ODIHR-it.

Kodi Zgjedhor, sipas OSBE/ODIHR-it, veç të tjerave, ka një mangësi serioze që bie ndesh me standardet ndërkombëtare. Ai lejon që partitë të depozitojnë në KQZ marrëveshjet e brendshme partiake për renditjen e përfituesve të mandateve, sipas kritereve të përcaktuara nga partitë. Në vitin 2005, shumë parti depozituan marrëveshje të tilla në KQZ. Kjo është problematike, sepse ul sigurinë e zgjedhësve se vota e tyre do të kthehet në mandate të shpërndara sipas kritereve transparente. Ka interes të përmendet se në raportin e OSBE/ODIHR-it vihet në dukje, gjithashtu, se mospërsëritja e zgjedhjeve për listën shumëmemërore të partive në një zonë të caktuar, mund të cenojë barazinë e votës që është një standard i vendosur ndërkombëtar dhe mund të ndikojë në shpërndarjen e mandateve. Në këtë raport tërhiqet vëmendja në atë pjesë ku flitet për regjistrimin e kandidatëve dhe të konkurrimit për listat shumëmemërore. “Është me vend të vihet në dukje - thuhet në këtë raport - se lista e PR-së një parti përbërëse e koalicionit ... (Partia Demokratike e Re, Partia Demokratike, Bashkimi Liberal Demokrat etj) përmblen emrat e 30 anëtarëve të PD-së, por PS-ja nuk e ankoi vendimin e KQZ-së për regjistrimin e këtyre anëtarëve nën siglën e PD-së”. Për të parandaluar “dushkuri” që krijoi deformimet e përmendura më lart, veç të tjerave, OSBE/ODIHR-i rekomandon: “Të riformulohet neni 16 i Kodit Zgjedhor që lejon partitë të regjistrohen pranë KQZ-së me marrëveshje koalicioni me “lista shumëmemërore të përbëra” - kjo duhet të hiqet. Partia duhet të paraqitet në fletëvotimi ose si parti ose anëtarë të një koalicioni, po jo në të dyja format. Duhet të hiqet, gjithashtu, mundësia që anëtarë të një partie të paraqiten si kandidatë të një partie tjetër, pasi zbehet

dallimi midis partive të veçanta, dëmtohet objektivi i sistemit zgjedhor dhe çorientohen zgjedhësit. Në të vërtetë, pavarësisht nga deformimi që shkaktoi dukuria “Dushk”, ai nuk duhet absolutizuar. E them këtë, sepse në zgjedhjet e 3 korrikut u vërtetuan edhe mjaft shkelje të tjera. Kështu p.sh., vëzhguesit raportuan parregullsi serioze lidhur me listat shumemërore në 9 zona ku u vonua përfundimi i numërimit dhe ku votat nuk u numëruan në mënyrë të ndershme, siç parashikon paragrafi 7.4 i dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së i vitit 1990. Pretendime të tilla u paraqitën edhe në 10 zona të tjera. Në mjaft komisione zgjedhore, madje dhe në grupet e numërimit, u vërejt diktimi dhe ndikimi partiak, politizimi i tejskajshëm, çka çoi në veprime arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin.

Komisioni i Kuvendit për reformën zgjedhore, siç është thënë, do të ketë parasysh rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

Në qoftë se do të arrihet konsensusi i gjerë për ndryshimin e sistemit zgjedhor, duke amenduar nenin 64 të Kushtetutës, kjo do të reflektonte edhe në rishikimin e disa dispozitave të Kodit të Zgjedhor. Në të kundërt, vëmendja kryesore mendoj se duhet të përqendrohet në mjaft dispozita që duhen rishikuar, plotësuar, qartësuar. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për ato dispozita që kanë të bëjnë me proporcionalin, për të mos lënë hapësira për interpretime subjektive dhe me interes të këtij ose atij subjekti zgjedhor.

Muaji janar 2006 po mbaron. Ditët kalojnë. Përmirësimet që i duhen bërë Kodit Zgjedhor janë të shumta. Ka edhe dispozita antikushtetuese. Edhe kreu mbi referendimet ka mjaft të meta. Do të sugjeroja që të angazhoheshim fillimisht me ato dispozita që kanë të bëjnë me zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për të krijuar kështu mundësinë e përgatitjeve paraprake.

Meqë si rregull, nuk është e rekomandueshme që 6 muajt e fundit para zgjedhjeve të bëhen ndryshime në legjislacionin zgjedhor, komisionit të posaçëm të Kuvendit mund t'i sugjerohej që në tematikën e tij ta kishte parasysh edhe këtë. Kam mendimin se koha që mbetet nuk premtton rishikimin e të gjithë problematikës që paraqet Kodi Zgjedhor në fuqi.



## Sistemi zgjedhor dhe stabiliteti në qeverisje

Gent Ibrahimimi LL.M

Instituti për Studime Publike & Ligjore

Shqetësimi i parë që më lindi, kur mora porosinë për të përgatitur një paraqitje për temën “*Sistemi zgjedhor dhe stabiliteti në qeverisje: Përvoja në Shqipëri*”, ishte nëse do të mundesha të hidhja në letër një material 6-7 faqësh ashtu siç m’u kërkua nga organizatorët (*Fondacioni Friedrich Hebert dhe Qendra për Studime Parlamentare*).

Nëse nocionit “*stabilitet në qeverisje*” do t’i jepnim vetëm kuptimin e tij bazik ose origjinal, atë të pasjes së numrave të mjaftueshëm në parlament për të siguruar një qeverisje njëpartiake, korrelacioni midis këtyre dy faktorëve dhe, për pasojë, edhe përfundimi i paraqitjes sime do të ishte i thjeshtë e do të shprehej në fjalinë e mëposhtme: “Na duhet një sistem zgjedhor mazhoritar (qoftë në formën e tij më drastike të *first past the post/shumicë e thjeshtë* ose në formën e votimit me dy raunde/shumicë absolute), për të pasur një qeverisje të stabilizuar në këtë vend.

Më lejoni të shtjelloj argumentin (*ose më saktë dogmën*) e mësipërm në një farë detaji. Janë të shumta studimet që tregojnë se në ato vende, ku sistemi zgjedhor është mazhoritar, në secilën nga format e përmendura më sipër (*first past the post vs. ballotazhit që synon të sigurojë shumicë absolute*), qeverisja njëpartiake ka një incidencë shumë më të lartë se në vendet me sistem zgjedhor proporcional<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Një studim nga Andre Blais i botuar në “*International Political Science Review*” tregon se sistemi mazhoritar, në variantin *first past the post* prodhon qeveri njëpartiake në 72 për

Pse ndodh kjo? Mos ndoshta shoqëritë e këtyre vendeve janë më uniforme në bindjet e tyre politike? Absolutisht jo. Është sistemi zgjedhor ai që, me vetëdije, sakrifikon përfaqësimin e pakicave për hir të stabilitetit në qeverisje.

Praktikisht, sistemi mazhoritar bën të mundur që votuesi, kur shkon në kutinë e votimit, të votojë për një qeveri të caktuar e cila ka një program dhe përbërje të paracaktuar në një masë të madhe (*shumë e përhapur dukuria e qeverive hije*). Me fjalë të tjera, programi zgjedhor dhe ai i qeverisë së ardhshme është një (*natyrisht në rast se kandidati për kryeministër nuk gënjen gjatë zgjedhjeve*), sepse ai nuk varet nga negociatat paszgjedhore mes partisë kryesore dhe aleatëve të saj, të cilët natyrshëm mund të divergojnë me partinë kryesore në disa pika të programit.

Koalicionet janë më pak të mundshme kur zgjedhjet realizohen mbi bazën e këtij sistemi. Natyrisht nuk është e vështirë të argumentosh se qeveritë e formuara në këtë mënyrë (*pra me votat e vetëm një partie*) janë më të çliuruara se qeveritë e koalicionit për të çuar përpara reforma dhe politika të rëndësishme mbi të cilat ato patën ndërtuar platformat e tyre zgjedhore.

Po kështu, sistemi mazhoritar ka prirjen të gjenerojë qeverisje më ideologjike, duke qenë se fituesit nuk kanë pse t'i zbusin nuancat e tyre ideologjike për hir të arritjes së një konsensusi me aleatët, të cilët mund të qëndrojnë në pozicione të ndryshme në spektrin ideologjik. Natyrisht që pasojë imediate e këtyre proceseve është një qeverisje më stabël në atë kuptim bazik të përmendur më sipër, ku votëbesimet ose mosbesimet në parlament janë thjesht teori. Si rezultat, qeveritë kanë prirjen të shërbejnë deri në përfundim të mandatit të tyre kushtetues.

Sa u trajtua më sipër nuk është aksident, por rezultat i një inxhinierie zgjedhore të frymëzuar nga një qëllim i përpiktë, për të “fabrikuar” në mënyrë artificiale ose për të ekzagjeruar me paramendim të plotë shumicën

---

qind të rasteve, ndërsa sistemi proporcional arrin të sigurojë qeveri njëpartiake vetëm në 10 për qind të rasteve.

parlamentare në raport me shumicën reale që ekziston në terren.

Sistemi mazhoritar, në formën *first past the post* përdoret në 43 vende të botës, përfshi edhe Britaninë e Madhe si përfaqësuesja më klasike. Sistemi tjetër me balotazh përdoret në shumë vende të tjera, përfshi Francën si përfaqësuesja më klasike.

Natyrisht që qëllimi që i vë vetes sistemi mazhoritar, për të prodhuar një qeveri njëpartiake, pra, të mbrojtur nga humoret parlamentare, nuk realizohet gjithnjë në praktikë. Në rast se do të merrnim si shembull Anglinë, e cila ka një sistem zgjedhor mazhoritar në formën e tij më drastike, do të shihnim thjesht të kundërtën. Një studim i komisionuar nga Qeveria Angleze, i cili ka marrë në shqyrtim historinë parlamentare të Anglisë në 150 vitet e fundit, ka treguar se në vetëm 64 nga këto 150 vite, Britania e Madhe është qeverisur nga maxhoranca njëpartiake. Në pjesën tjetër të kohës, vendi është qeverisur nga koalicione, ndonëse ai nuk ka qenë gjithnjë i domosdoshëm.

Kjo është pra, mënyra sesi sistemi mazhoritar, të paktën në teori, garanton stabilitet në qeverisje.

Sidoqoftë, unë refuzoj ta kuptoj stabilitetin në qeverisje vetëm si çështje të numrave dhe të mundësisë, për të pasur ose jo një qeveri njëpartiake. Në qoftë se bëjmë marrëveshjen e fjalës për t'i dhënë konceptit “stabilitet në qeverisje” një kuptim më të gjerë politik, natyrisht që korrelacioni midis sistemit zgjedhor dhe qeverisjes nuk është kaq aksiomatik.

E pra, në këtë kuptim më të gjerë politik, qeverisja e mirë është premisa e parë dhe më e rëndësishme për të pasur stabilitet. A nuk është vallë premisë për stabilitet aftësia për të qeverisur në harmoni me interesat e të gjitha grupeve të shoqërisë, pavarësisht nga sfondi i saj ideologjik? A nuk është kohezioni social kusht për stabilitet në qeverisje. A nuk është, në fund të fundit, *third way* një tentativë për të minimizuar rolin e ideologjisë në qeverisje dhe për të siguruar kështu stabilitetin jo thjesht përmes numrave, por përmes shërbimit më të mirë të mundshëm për numrin më të madh të mundshëm të zgjedhësve?

Nga ana tjetër, a mund të quhet stabilitet në qeverisje një situatë (*tipikisht e krijuar nga sistemet mazhoritare*), ku opozita politike është e pallogaritshme dhe e paefektshme dhe ku, për pasojë, qeverisja deformohet nën peshën e efektit korruptiv të pushtetit?

Natyrisht është e pamundur që një qeveri t'i shërbejë me të njëjtën devotshmëri dhe intensitet interesave të të gjitha grupeve, sepse shpesh ato janë në kolizion të plotë ose të pjesshëm me njëri-tjetrin. Në kohë të ndryshme, interesa të ndryshme diktojnë vëmendje të ndryshme.

Sidoqoftë, në këtë kuptim më të gjerë, një sistem zgjedhor proporcional është po aq i aftë të sigurojë qeverisje të stabilizuar sa dhe një sistem mazhoritar. Po si mund të ndodhë kështu? A nuk është vallë e vërtetë se një sistem zgjedhor proporcional ka prirjen të prodhojë qeveri koalicioni? Për më tepër, në vendet që kanë zgjedhur këtë sistem zgjedhor, qeveritë formëzohen pas zgjedhjeve si rezultat i negociatave ndërpartiake, të cilat shpeshherë janë sfilitëse dhe zgjasin me muaj të tërë (*tipik është rasti i Holandës*). Situatat e vakuimit institucional janë tipike. Më tej akoma, nëse partitë e koalicionit nuk arrijnë të gjejnë gjuhë të përbashkët (*çka nuk është ndonjë çudi e madhe po të kemi parasysh se sistemet proporcionale shpesh lejojnë futjen në jetën politike edhe të partive ekstremiste*), zgjidhja e vetme e mundshme, për të dalë nga impasi politik, janë zgjedhje të tjera. Një tjetër faktor destabilizues është edhe kompleksiteti i procesit të votimit dhe i llogaritjes së rezultatit, që shkakton vonesa dhe në disa raste moskuptime.

Duke lënë mënjanë listën e efekteve destabilizuese të sistemit zgjedhor proporcional, është e nevojshme të listohen efektet e tij stabilizuese në atë kuptimin e gjerë politik të përmendur më lart. Kështu, një sistem zgjedhor proporcional është i menduar të garantojë përfaqësim më të mirë në jetën politike e institucionale të pakicave të çdo lloji. Kjo bën të mundur që pakicat të mos marginalizohen politikisht, çka mund të sjellë si pasojë kërkimin e rrugëve jashtëligjore dhe jashtëinstitucionale nga këto të fundit, për të shprehur

pikëpamjet e tyre (*teorikisht ky rrezik është iminent në një sistem mazhoritar*).

Po kështu, këto sisteme, duke ofruar realisht më shumë zgjedhje për votuesit, janë në gjendje të galvanizojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin zgjedhor, një tregues ky i shëndetit të demokracisë. Një tjetër mënyrë se si sistemi proporcional garanton stabilitet në qeverisje, ndonëse kjo është një formë e padëshirueshme, është aftësia e disa partive të mëdha për të qëndruar në qeverisje, pavarësisht nga ndryshimet brenda koalicioneve, duke siguruar kështu një stabilitet që i kapërcen edhe kufijtë e legjislaturave. Kështu p.sh., në Itali, kristiandemokratët kanë zotëruar të gjitha qeveritë e koalicionit të krijuara në atë vend që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri në mesin e viteve '90.

Një stabilitet të tillë, ndoshta fjala më e mirë për t'u përdorur në këtë rast është stanjacion, do ta kishte pasur zili çdo Qeveri Britanike e formuar në rrugë ultramazhoritare. E pra, në të gjitha këto mënyra (*dhe shumë të tjera më të imëta*) një sistem zgjedhor proporcional është në gjendje të sigurojë një qeverisje të stabilizuar po aq mirë sa një sistem mazhoritar, ndonëse duke përdorur mjete dhe strategji të ndryshme.

Natyrisht, me këto që thashë më sipër nuk dua të asgjësoj ose të minimizoj rolin e sistemit zgjedhor, si faktor në gjenerimin e një qeverisjeje të stabilizuar. Sistemi zgjedhor ka qenë dhe mbetet faktori numër një në këtë drejtim. Unë desha vetëm të përçoj mesazhin se sistemi zgjedhor nuk është gjë tjetër veçse mekanizmi përmes të cilit votat dhe parapëlqimet e qytetarëve shndërrohen në karrige në institucionet përfaqësuese. Ai nuk është një kurë universale për problemet e zgjedhjeve e, në këtë kuadër, as për problemin e stabilitetit në qeverisje.

Po sa shanse ka sistemi ynë zgjedhor për të prodhuar një qeverisje të stabilizuar? Në rastin e Shqipërisë jemi të dënuar të bëjmë një diskutim vetëm cilësor e akademik për aftësinë ose paaftësinë e sistemit tonë zgjedhor, për të prodhuar qeverisje të stabilizuar. Kujtoj se sistemi, në formën e tij aktuale, është testuar vetëm dy herë, madje duke bërë ndryshime të rëndësishme në

Kodin Zgjedhor, siç ishte p.sh. futja e versionit *first past the post* në zgjedhjet e fundit. Nuk mund ta fsheh zilinë që provova kur lexova materialin e sipërpërmendur britanik pikërisht për korrelacionin mes sistemit zgjedhor dhe stabilitetit në qeverisje dhe pashë që ata i referoheshin një periudhe kohore 150-vjeçare. Mendova që atyre do t'u mjaftonte edhe një analizë e thjeshtë sasiore për të arritur në përfundimet e duhura. Krejt në të kundërtën, Shqipëria ka pasë vetëm dy zgjedhje me sistemin aktual zgjedhor. Në vitin 2001 zgjedhjet parlamentare rezultuan në një shumicë parlamentare të mjaftueshme për një qeverisje njëpartiake. Në zgjedhjet e fundit të 2005-ës koalicioni ishte i domosdoshëm. Por edhe në atë rast kur shumica qeverisëse u sigurua vetëm nga një parti, keqadministrimi i procesit zgjedhor i bëri rezultatet të diskutueshme dhe, për pasojë, e bëri Qeverinë të dobët.

Po le ta shohim në teori sa i aftë është sistemi ynë zgjedhor, për të siguruar një qeverisje të stabilizuar. Siç e thashë, në pamundësi për t'iu referuar të dhënave sasiore (*ndonëse rasti i Gjermanisë, modeli i së cilës është marrë në një masë të madhe nga Kushtetuta jonë, na ofron disa të dhëna empirike*), analiza e mëposhtme do t'i referohet kryesisht shkronjës së ligjit.

Sistemi ynë zgjedhor karakterizohet rëndom si sistem proporcional i personalizuar, sepse kështu etiketohet modeli mëmë, sistemi gjerman. Unë kam dyshimet e mia në lidhje me këtë karakterizim, të cilat do t'i ngre pak më poshtë. Sidoqoftë, thelbi i sistemit tonë është përpjekja për të kombinuar votën për personin në zonat zgjedhore njëemërore me parimin e përfaqësimit proporcional nëpërmjet votimit në 2 fletë. Pra, ideja është që të vilen avantazhet e dy sistemeve, siç u shpjeguan më sipër.

Votimi në zonën njëemërore ka dy qëllime kryesore: *së pari*, të sigurojë një lidhje të drejtpërdrejtë midis zgjedhësit dhe përfaqësuesit dhe, *së dyti*, (*sidomos pas futjes të versionit first past the post në zgjedhjet e fundit – kushtetutshmëria e tij është e diskutueshme*) të lehtësojë procesin e bërjes së qeverisë, duke i dhënë alternativës së momentit mundësinë për të vjelë frytet e avantazhit të përkohshëm politik.

Nga ana tjetër, votimi në proporcional synon të korrigjojë deformimin e natyrshëm të zgjedhjeve në mazhoritar, por jo plotësisht. Kjo për dy arsye: *së pari*, në rast se votimi në proporcional do ta korrigjonte plotësisht distorsionin e natyrshëm dhe të dëshiruar të zgjedhjeve në mazhoritar, i gjithë sistemi i përzier do të ishte një humbje cinike kohe. *Së dyti*, fakti, që numri i vendeve të marra përmes proporcionalit është i fundëm, tregon pikërisht qëllimin e Kushtetutës për të pasë një korrigjim të pjesshëm të rezultatit të siguruar në mazhoritar. Edhe vetë Kushtetuta flet për një raport sa më të afërt midis numrit të votave dhe numrit të deputetëve, duke lënë të kuptohet se korrigjimi nuk mund të jetë kurrsesi i plotë. Tani, se sa i madh duhet të jetë korrigjimi, në mënyrë që kërkesa e Kushtetutës për një raport sa më të afërt të quhet e kënaqur, kjo është një çështje e interpretimit kushtetues dhe vetëm ndonjë vendim i Gjykatës Kushtetuese do të mund të na shpëtonte nga ky makth.

Ky, sipas mendimit tim, është dallimi kryesor midis sistemit tonë zgjedhor dhe atij gjerman që pa dyshim ka shërbyer si model. Pikërisht për këtë arsye etiketimi i sistemit tonë si proporcional i personalizuar më rri ca si ngushtë. Ndoshta do na duhet të mendojmë ndonjë emër tjetër (*pse jo mazhoritar i proporcionalizuar*).

Përpara se t'i kthehem diskutimit se sa i aftë është ky sistem të sigurojë qeverisje të fortë për Shqipërinë, është e udhës të identifikohen dy problemet kryesore të tij. Dikujt mund t'i dukem si shumë optimist teksa flas vetëm për dy probleme të sistemit zgjedhor. Mund ta kuptoj fare mire, por sqaroj se nuk kam ndërmend të ndalem te problemet që lidhen me keqadministrimin e procesit zgjedhor, por me defektet e trashëguara të të sistemit.

Konkretisht, e kam fjalën për faktin se votimi i kandidatëve individualë në zonat njëmërore e humb relativisht kuptimin në kushtet kur në Shqipëri ka një prirje të fortë për të votuar në bazë të parapëlqimeve partiake dhe jo të personalitetit të kandidatit. *Së dyti*, sistemi (*të paktën në formën aktuale me dy fletë votimi*) është ftesë e hapur për taktika zgjedhore të tipit të

Dushkut. Fakti që “Dushk” ka sot e kësaj dite edhe në Gjermani, tregon se nuk duhet t’i lidhim shpresat te ndërgjegjësimit i klasës politike, që kjo e fundit të heqë dorë nga perversiteti i sistemit përmes taktikave zgjedhore. Ata do të vazhdojnë ta bëjnë atë për sa kohë të kenë mundësi.

Si përfundim, duke abstruar për një çast nga problematika masive e administrimit të zgjedhjeve dhe duke prezumuar korrektimin e atyre, që unë i quajta defekte të trashëguara të sistemit, mendoj se sistemi zgjedhor shqiptar, në gjendjen e tij aktuale, është në gjendje të prodhojë qeverisje të fortë për dy arsye:

*Së pari*, në momente të caktuara politike, aspekti mazhoritar i sistemit është në gjendje të prodhojë mazhoranca të tilla që të garantojnë qeverisje njëpartiake, për pasojë qeverisje të fortë.

*Së dyti*, në kushte normale politike, sistemi duhet të ketë prirjen të diktojë nevojën për koalicion. Megjithatë, komponenti mazhoritar është i aftë të krijojë një parti kryesore, e cila, pavarësisht se nuk qeveris dot vetë, është disproporcionalisht më e fortë se aleatët e saj dhe, për pasojë, mund të krijojë rreth vetes një zinxhir aleancash relativisht të qëndrueshme.



# Barazia gjinore dhe sistemet e kuotave zgjedhore për gratë

*Prof. Dr. Aurela Anastasi*

*“Pikërisht, meqë forcat e rrethanave kanë përherë si prirje të shkatërrojnë barazinë, duhet gjithmonë që forcat e legjislacionit ta ruajnë atë”*

*Ruso*

## 1. KUOTAT ZGJEDHORE PËR GRATË NË KUADËR TË PARIMIT TË BARAZISË.

Përpjekjet që bëhen sot për të siguruar rritjen e pjesëmarrjes së grave në organet e larta të zgjedhura, si dhe për një rekrutim më të madh të tyre në pozicionet politike, përfaqësojnë pa dyshim çështjen më të rëndësishme për të arritur nivele të kënaqshme të barazisë gjinore në shoqëri. Qysh pas Luftës II Botërore, kur përfunduan me sukses aksionet e lëvizjeve feministe me vendosjen e votimit të përgjithshëm edhe për gratë, çështja gjinore është shndërruar në aksionin më të madh shoqëror për të finalizuar kërkesat për barazinë e përgjithshme në votim. Si pjesë thelbësore e parimit të barazisë, ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me sistemet zgjedhore në çfarëdo lloji kuptimi që t’i analizojmë ato. Kur flasim për sistemin zgjedhor si tërësi parimesh, garancish dhe rregullash, kemi parasysh garantimin e barazisë gjinore nëpërmjet sanksioneve juridike, jo vetëm në të drejtën aktive të votimit (e drejta për të zgjedhur), por edhe në atë pasive (e drejta për t’u zgjedhur). Ndërsa, kur flasim për sistemet zgjedhore në kuptimin e ngushtë të fjalës,

pra, për rregullat që përcaktojnë ndarjen e mandateve në organet e zgjedhura, kuptimi gjinor merr, gjithashtu, një rëndësi të pamohueshme, me qëllim që t'u garantohet të dyja gjinive një ndarje e drejtë dhe e ndershme e vendeve në organet e zgjedhura.

Aktualisht, në çdo sistem demokratik nuk ekzistojnë më barriera formalo-juridike për të ushtruar të drejtat zgjedhore. Barazia e kushteve për të zgjedhur e për t'u zgjedhur është e qartë si për burrat edhe për gratë. Megjithatë, aktualisht gratë përfaqësojnë vetëm 15 për qind të përbërjes së parlamenteve të të gjithë Botës. Pra, sistemet zgjedhore që praktikohen nuk janë në gjendje të na ofrojnë një baraspeshë gjinore të përfaqësuesve të zgjedhur. Është i njohur fakti se në të gjitha shoqëritë shtetërore, evolucioni drejt barazisë midis burrit dhe gruas ka qenë mjaft i ngadalshëm. Për një kohë të gjatë, kjo gjë u stimulua edhe nga e drejta zakonore e vendeve, si dhe nga ajo kishtarë. Kështu, shpjegohet që deri pas Luftës II Botërore, zotëroi votimi i përgjithshëm mashkullor. Edhe sot, duke parë hapat e ngadaltë me të cilat po rritet numri i grave në institucionet politike, janë shtuar zërat që kërkojnë marrjen e masave më të frytshme, për të arritur një balancë gjinore. Një nga mekanizmat që po përdoret gjithmonë e më tepër është vendosja e sistemit të kuotave për gratë në sistemin zgjedhor. Kjo është bërë, gjithashtu, përmes një rezistence të madhe, për shkak të debateve të shumta që ka shkaktuar vendosja e tyre. Mjaft autorë mendojnë se dhënia e të drejtës së votës për gratë, me vendosjen e votimit të përgjithshëm, është plotësisht e mjaftueshme për të siguruar barazinë në votim<sup>1</sup>. Çështja e zgjedhjes në organet për të cilat votohet, konsiderohet prej tyre si një çështje thjesht individuale. Në të vërtetë, ky mendim mbështetet mbi konceptin klasik liberal, i cili e konsideron barazinë si “barazi e mundësive” ose “barazi konkurruese”. Por, duke ndjekur lëvizjet e forta feministe të viteve të fundit, një koncept tjetër ka fituar terren dhe mbështetje më të madhe - koncepti i “barazisë së rezultateve”. Sipas tij,

<sup>1</sup> Shih: Drude Dahlerup, në [www.quotaproject.org](http://www.quotaproject.org)

nuk mjafton barazia formale dhe heqja e barrierave ligjore për të arritur një barazi të vërtetë reale. Për shkak të pengesave që ndodhen në realitetin shoqëror, veçanërisht për shkak të një konceptimi patriarkal të shoqërisë, nevojiten masa pozitive të afta për të çuar në barazinë e rezultateve. Këto e bëjnë të mundur shndërrimin e parimit të barazisë nga një opsion të sanksionuar formalisht në ligj, në një realitet të prekshëm. Në perspektivën e raportit të barazisë formale me atë thelbësore, ndërgjegjësohemi se kuotat për gratë nuk përbëjnë një diskriminim kundrejt burrave, por një kompesim për pengesat strukturore me të cilat gratë ndeshen gjatë proceseve zgjedhore. Nga ana tjetër, kundërshtuesit e kuotave për gratë e lidhin këtë me faktin se ato mund të dëmtojnë cilësinë dhe ajo që duhet të na udhëheqë është cilësia<sup>2</sup>. Çështja e cilësisë është një çështje mjaft thelbësore, por natyrisht nuk janë kuotat për gratë ato që e dëmtojnë atë. Një sërë faktorësh që ngërthehen në këtë çështje, vërejmë se janë lënë pas dore, duke kërkuar që vullneti i popullit të përkthehet vetëm në numra. *“Vëmendja jonë është drejtuar përherë e më shumë mbi çështjen e përfaqësisë së saktë, në sa më mirë o sa më keq, votat kthehen në vende. Ernes Bakëri ishte, pak a shumë, autori i fundit madhor që thekson më 1942 se “nuk mund të heqim dorë nga ideja e vlerës, nuk mund të fronësojmë shumicën vetëm pse është shumicë dhe më e madhe në numër. Duhet të gjejmë një mënyrë për të lidhur bashkë vlerën dhe numrin si gjëra të lidhura në mënyrë të pandashme” (Giovani Sartori, “Edhe njëherë për teorinë e demokracisë”).*

Të gjitha shoqëritë shtetërore janë ndeshur me problemin e pjesëmarrjes së grave në qeverisje dhe kanë marrë disa masa. Më të rëndësishme kanë qenë sistemet e kuotave të inkuadruara në sistemet zgjedhore.

## 2. KUOTAT DHE SISTEMET E TYRE

Sistemet e kuotave zgjedhore janë të ndryshme. Ato mund të zbatohen

<sup>2</sup> Po aty

me qëllim që të rezervojnë një numër të caktuar vendesh për gratë në organet e zgjedhura, duke iu ofruar atyre mbështetje për të dalë nga izolimi politik. Ideja e vërtetë e sistemit të kuotave qëndron në rekrutimin e grave në pozicionet politike. Por sistemet e kuotave mund të aplikohen edhe mbi baza të tjera sociale, p.sh., për të garantuar përfaqësimin e minoriteteve; ose mbi baza gjeografike, me qëllim që të sigurojnë në çdo rast një përfaqësim minimum të zonave të populluara. Sistemet e kuotave *gender* synojnë që të sigurojnë së paku një minoritet kritik për gratë prej 20, 30, ose 40 për qind, e deri në garantimin e një balance të vërtetë gjinore prej 50 për qind burra - 50 për qind gra. Ato përbëjnë padyshim një aspekt mjaft të rëndësishëm të sistemeve të kuotimit, për faktin se pothuajse në të gjitha shtetet, gratë përbëjnë rreth 50 për qind të popullsisë, ndërkohë që përfaqësimi i tyre mbetet në nivele mjaft të ulta.

#### A. Llojet e kuotave sipas korrektimit në sistemet zgjedhore

Sido që të paraqiten, kuotat përfaqësojnë një korrektim të sistemeve zgjedhore. Nisur nga ky fakt, kuotat gjinore paraqiten të ndryshme. Një korrektim me kuotë gjinore mund të kërkojë që së paku 40 për qind të kandidaturave në listën zgjedhore të jenë gra. Kjo mund të shoqërohet edhe me një maksimum të kërkuar për gjininë mashkullore.

Disa sisteme kuotash paraqiten *si sisteme gjinore asnjëse*. Në këtë rast, korrektimi i sistemit zgjedhor kryhet në mënyrë të tillë që asnjëri prej të dyja gjinive të mos kapërcejë një maksimum të vendosur. P.sh., asnjëra prej gjinive të mos zerë më tepër se 60 për qind të vendeve, ose më pak se 40 për qind të vendeve në parlament. Në rastin kur kuota kërkon një korrektim prej 50-50 për qind, atëherë kemi të bëjmë me një kuotë asnjëse natyrore, e cila vendos një maksimum për përfaqësimin e grave.

Është praktikuar, gjithashtu, edhe koncepti i “*double quota*”, i kuotës së dyfishtë, që konsiston në korrektimin e sistemit zgjedhor jo vetëm përmes një përqindjeje të caktuar për gratë në listën zgjedhore, por, gjithashtu, parashikon që gratë candidate të vendosen në krye të listave me shanse të

vogla për t'u zgjedhur. (Belgjika, Argjentina).

Sistemet e kuotave zgjedhore për gratë mund të jenë *të përkohshme ose jo*. Në rastin e parë parashikohet një kohë e kufizuar, në të cilën duhet të vendosen e të zbatohen këto kuota, duke u konsideruar si masa të përkohshme, derisa të shmangen barrierat për gratë brenda politikave të ndjekura. Edhe pse mjaft shtete, që kanë parashikuar kuota, nuk kanë vendosur kufi kohorë për përdorimin e tyre, duket se prirja e fundit është për të mbështetur më tepër sistemet e kuotave të përkohshme. Kjo, me qëllim që të tregohet përkohshmëria e aksioneve politike të shtetit, deri në zhdukjen e të gjitha barrierave që ekzistojnë në realitetin patriarkal të politikave zgjedhore. Një gjë e tillë duket qartë edhe në rekomandimet që Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e Diskriminimit kundër Grave, i ka bërë shtetit shqiptar<sup>3</sup>.

Ndërsa mirëpriti përdorimin e kuotave minimale të kandidatëve femra nga disa parti politike shqiptare në zgjedhjet vendore, Komiteti shprehu shqetësimin për përfaqësimin e ulët të grave në nivelet e larta të zgjedhura dhe të emëruara dhe i bëri thirrje palës qeveritare shqiptare të *marrë masa që përfshijnë përmirësime në ligjin zgjedhor, rritjen e përfaqësimit të grave në organet e zgjedhura ose të emëruara, nëpërmjet zbatimit të masave të përkohshme të veçanta*, me qëllim që të realizojë të drejtat e grave për t'u përfshirë në të gjitha fushat e jetës publike, veçanërisht në nivelet e larta të vendimmarrjes.

### **B. Sistemet e kuotave**

Nisur nga juridiksioni në të cilat shtrihet fuqia e sistemeve të kuotave, i ndajmë ato në dy tipe kryesore:

- I.** Sistemet e kuotave të parashikuara për parlamentet në nivel kombëtar.
- II.** Sistemet e kuotave të parashikuara për organet e qeverisjes vendore

---

<sup>3</sup>Rekomandime të Komitetit pas raportit të parë të shtetit shqiptar për zbatimin e Konventës "Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit për gratë" (CEDAW) Sesioni 28, 13-31 Janar 2003

(jokombëtare)

Forma juridike, me të cilën janë sanksionuar sistemet e kuotave, i bën ato të larmishme nga njëri vend në tjetrin. Megjithatë, mund të klasifikohen si më poshtë:

1. Sistemi i *kuotave kushtetuese*: Janë kuota të parashikuara nga dispozitat e kushtetutës së një vendi. Kryesisht, ato vendosen për parlamentin (Franca etj.).

2. Sistemi i *kuotave legjislative ose rregullatore*: Në këtë rast kuotat vendosen nga ligje të brendshme të vendit ose nga akte të tjera me fuqi nënligjore. Zbatimi i këtij sistemi është karakteristikë për vendet e Amerikës Latine, por është përdorur edhe në Europë (Belgjikë, Serbi, Maqedoni, Bosnje-Hercegovinë etj.).

3. Sistemi i *kuotave të vendosura nga partitë politike për kandidaturat në zgjedhje*: Ky është edhe sistemi më i përhapur në Europë (Gjermani, Itali, Norvegji, Suedi, Angli etj.). Ai konsiston në rregulla të vendosura nga partitë politike, për të përfshirë një përqindje të detyrueshme të grave si candidate në zgjedhje. Në këtë rast, është vetë vullneti i partive politike që ka rëndësi për vendosjen e kuotave. Nuk ka detyrime ligjore për to. Madje, mund të ndodhë që në disa vende të gjitha partitë politike të kenë parashikuar kuota, ndërkohë që në disa vende të tjera vetëm një ose disa prej tyre mund të vendosin kuota. Një pjesë e madhe e partive politike në të gjithë botën nuk përcaktojnë ndonjë kuota. Sidoqoftë, nëse shumica e partive politike të një vendi i përdor këto kuota, ky sistem ka rezultuar mjaft frytdhënës dhe i ka rritur standardet e përfaqësimit të grave.

II. Sistemet e kuotave, të parashikuara për organet e zgjedhura jo në nivel kombëtar, janë, gjithashtu, të larmishme dhe perifrazohen sikurse kuotat kombëtare. Në këto raste, përmes kuotave kushtetuese ose legjislative për organet e qeverisjes vendore, kërkohet një set i përcaktuar i vendeve për gratë, me qëllim që ato të përbëjnë një përqindje të arsyeshme të kandidatëve në nivelin e qeverisjes jokombëtare (në rastin e vendit tonë të qeverisjes

vendore). Shembuj të tillë janë të shumtë: Greqi, Maqedoni etj.

### 3. ÇËSHTJE TË ZBATIMIT TË KUOTAVE

Niveli më i lartë i sanksionimit të kuotave nuk ka rezultuar gjithmonë më i suksesshmi. Për fat të keq, as kuota kushtetuese dhe as ajo legislative nuk na tregojnë ndonjë epërsi për rastet kur është vendosur kuota e partive politike. Ndërkohë, është vërtetuar plotësisht se kyçi i suksesit në arritjen e standardeve më të mira në përfaqësimin gjinor, mbetet puna në partitë politike. Nuk është e rastësishme që pikat më të larta të përfaqësimit të grave në parlamentet e sotme në Europë, janë arritur nga vende që përdorin sistemin e kuotave nga partitë politike: Suedia: 45,3 për qind, Austria: 40 për qind, Danimarka: 36 për qind etj. Ndërkohë, Franca, një nga vendet me traditat më të vjetra demokratike, edhe pse e ka përforcuar sistemin e kuotës, duke e garantuar me kuota kushtetuese e ligjore të shoqëruar me sanksione për moszbatimin e tyre, ka një përfaqësim të ulët të grave në parlament prej 12.1 për qind. Aktualisht, Shqipëria shënon standardin më të ulët të përfaqësimit të grave në Europë dhe paraqitet me 7.1 për qind gra në Kuvend.

Në Kodin e Etikës, që u nënshkrua nga të gjitha partitë politike në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, theksohej shprehimisht: “*Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plotë të grave, qoftë si kandidatë edhe si anëtarë të komisioneve në procesin zgjedhor*”. Partitë më të mëdha politike parashikuan edhe një kuotë për kandidaturat e grave në këto zgjedhje. Megjithatë, rezultatet ishin krejt të pakënaqshme<sup>4</sup>,

<sup>4</sup> • Kryetarë të KZZ-ve të propozuar nga partitë politike: 100 gjithsej/4 gra, kryetarë të KQV-ve: gra 16 për qind. Politikanëve meshkuj iu dha 95 për qind e minutazhit politik në media.

- Në zonat një emërore: PS kandidoi me 8 gra/4 prej tyre fituan; PD kandidoi me 3 gra/3 prej tyre fituan;
- Në grupin parlamentar të PSD: në 7 deputetë /2 janë gra;
- Shtatë parti parlamentare nuk kanë asnjë deputete grua në radhët e tyre.

duke shkuar vazhdimisht në rënie. Kjo rënie mund të shpjegohet sidomos me ashpërsinë politike të viteve të tranzicionit, pasi Shqipëria ka trashëguar potenciale të përshtatshme për përzgjedhje nga radhët e grave, si dhe ka patur përfshirje të konsiderueshme të grave në Kuvend, pavarësisht nga fakti se kjo diktohej nga sistemi komunist. Edhe kuotat, fillimisht vendosin njëfarë imponimi demokratik.

Të bën përshtypje fakti se kuotat veprojnë në mënyra të ndryshme në sisteme të ndryshme zgjedhore. Është e qartë se në një sistem proporcional vendosja e tyre paraqitet më e lehtë. Megjithatë, në mjaft vende ajo është përdorur me sukses edhe në sistemet mazhoritare. Madje, ka ndodhur që edhe në sistemin proporcional kuotat të kenë qenë të vështira dhe jo fort rezultative për shkak të dobësisë së partive politike në përzgjedhjen e kandidateve.

Në këtë kuadër, çështja e arritjes së niveleve bashkëkohore në Shqipëri, shtrun detyra të rëndësishme në kuadrin e politikave zgjedhore. Ndërtimi i një platforme, për të harmonizuar legjisllacionin shqiptar në lidhje me barazinë gjinore (Kodi Zgjedhor dhe ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë”), do të sillte nevojën e parashikimit nga këto akte të masave të veçanta dhe të përkohshme për të arritur balancën gjinore. Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë” mund të përmbajë përkufizime që japin koncepte të qarta mbi këto lloje masash, si dhe mbi kuptimin e përfaqësimit të barabartë. Kurse, Kodi Zgjedhor mund të përcaktojë një sistem kuotash ose lejimin e një sistemi kuotash së bashku me sanksionet për moszbatimin e tyre.

· Në vijim të rekomandimeve të dhëna për Shqipërinë nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e Diskriminimit kundër Grave, do të ishte bindës parashikimi i kuotave legjisllative asnjëse dhe të përkohshme, me një afat të kufizuar. Kjo mund të realizohet në disa mënyra:

1. Të forcohet puna në partitë politike, me qëllim që të zbatohet kuota e partive politike për kandidatët për organet qendrore realisht deri në masën 30 për qind të kandidaturave për të dyja sistemet ose 50 për qind për proporcionalin.



2. Për organet vendore të parashikohet një kuotë legjislative e përkohshme nga Kodi Zgjedhor. Kjo do të ishte më rezultative, pasi organet kolegjiale vendore zgjidhen mbi bazën e sistemit proporcional, që sikurse theksuam, i përgjigjet më me lehtësi sistemit të kuotave. Kuota legjislative është e rekomandueshme për Shqipërinë, sepse ajo ka potencialin e nevojshëm intelektual për përzgjedhje nga radhët e grave, si dhe duke patur parasysh se gjatë të gjitha viteve të demokracisë emergjente, numri i grave që marrin pjesë në organet e zgjedhura ka rënë ndjeshëm.

3. Parashikimi i kuotave kalimtare legjislative për organet përfaqësuese qendrore, mund të vendoset me këndvështrim të posaçëm në proporcional, në të cilin mund të aplikohet edhe kuota e dyfishtë.

4. Ligji mund të parashikojë sanksione të ndryshme për partitë politike që nuk përmbushin kuotat e vendosura (sanksione që përmbushen nga KQZ-ja, si mospranimi i listave, sanksione financiare ndaj partive që nuk realizojnë kuotat e parashikuara për kandidatët, bllokimi i regjistrimit të subjektit dhe i kandidatëve deri në balancimin e kuotave në zbatim të Kodit, ose të normave statutorë të parashikuara nga vetë subjekti etj.)

5. Kodi Zgjedhor mund të parashikojë detyrimin e partive politike për t'u përfaqësuar në njësitë e administrimit të votës mbi baza asnjëse gjinore.

Sidoqoftë, në përfundim, ia vlen të përsëritim faktin, se roli i partive politike në rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën politike të vendit mbetet vendimtar.

## Sistemi proporcional zgjedhor, anët pozitive dhe implikimet e mundshme në vendin tonë

*Damian Gjikhuri, MA, LLM  
Qendra Studimore për Politikën  
Publike dhe Sigurinë*

Diskutimi mbi ndryshimin e sistemit zgjedhor duket se është hapur. Herët ose vonë kjo çështje do të shtrohet për zgjidhje, duke angazhuar të gjithë faktorët politikë në vend e mbase dhe më gjerë. Reforma zgjedhore, që përfshin dhe ndryshimin e mundshëm të sistemit zgjedhor, nuk është një ndërmarrje e lehtë, po të kihet parasysh se mund të kërkojë edhe ndryshim të Kushtetutës. Si e tillë, ajo kërkon hapjen e një debati të gjerë që, para së gjithash, duhet t'u përgjigjet disa pyetjeve që vijnë natyrshëm në këtë proces. Së pari, çfarë nuk shkon me sistemin aktual zgjedhor, kryesisht mazhoritar? Çfarë pasojash ka sjellë zbatimi i këtij sistemi? Sa, dhe në ç' drejtim do të ndihmonte një sistem i bazuar kryesisht në proporcional, si dhe cilat do të ishin implikimet e mundshme që mund të rrjedhin prej tij?

Duke pranuar kufizimet që kemi në trajtimin e të gjitha elementeve, që lidhen me secilën nga pyetjet e identifikuara, ndjehemi të detyruar ta fokusojmë analizën tonë në kompleksitetin që paraqet zbatimi i një sistemi kryesisht proporcional në Shqipëri, një propozim i hedhur nga një numër forcash politike në vend. Qëllimi i kësaj analize është hedhja dritë mbi avantazhet dhe disavantazhet e zbatimit të tij në kontekstin politik shqiptar.

## METODOLOGJIA

Kuptohet që marrja e një modeli dhe zbatimi i tij në kushte të caktuara të një vendi nuk premtom domosdoshmërisht të japë zgjidhje ose të shmangë të gjitha problemet që kanë lidhje me zgjedhjet. E njëjta gjë mund të thuhet për gjetjen një sistemi zgjedhor, i cili premtom të jetë së paku më i mirë së të tjerët, duke e bërë kështu debatin e zgjedhjes së sistemit zgjedhor edhe më të vështirë. Megjithatë, për aq kohë sa pengesat në konsolidimin e sistemit demokratik kanë lidhje me zbatimin e një sistemi të caktuar zgjedhor, atëherë reforma zgjedhore është më se e përligjur. Një rrugë të tillë kanë ndjekur një sërë vendesh, përfshirë edhe ato me tradita të konsoliduara demokratike.

Nisur nga sa u tha më lart, dhe për të thjeshtuar qëllimin e kësaj analize, do të zgjedhim zbatimin e sistemit proporcional dhe se si ky system mund t'i japë përgjigje disa problemeve themelore të ardhura nga sistemi actual - kryesisht mazhoritar. Në përzgjedhjen e modelit të sistemit proporcional dhe të avantazheve që ai paraqet, jemi nisur nga një konvencion i pranuar gjerësisht në lëmin e literaturës politike e kushtetuese ndërkombëtare.<sup>1</sup> E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për problemet dhe implikimet e mundshme, të shfaqura nga zbatimi i këtij sistemi zgjedhor. Të gjitha këto përfundime do të mbivendosen në një kontekst vendor, me qëllim adresimin e problemeve të vërejtura dhe të pranuar zgjedhje pas zgjedhjes në Shqipëri. Qëllimi është pasja e një panorame më të qartë se çfarë anësh pozitive ose implikime mund të sjellë zbatimi i sistemit proporcional, qofshin këto edhe afatgjata, nisur edhe nga përvojat e vendeve të tjera.

## SISTEMI I SOTËM ZGJEDHOR DHE DOBËSITË E VËREJTURA

Le të fillojmë analizën tonë duke hedhur një vështrim të shkurtër në sistemin

<sup>1</sup> Për këtë jemi bazuar në punën e studiuesve të mirënjohur politikë dhe konstitucionalistëve, si Giovanni Sartori “Comparative Constitutional Engineering” New York University Press 1994; Arend Lijphart “Pattern of Democracy” Yale University 1999; Larry Daimond “Developing Democracy” The John Hopkins University Press 1999.

zgjedhor aktual. Ky sistem është përgjithësisht mazhoritar me elemente pjesore proporcionale (megjithëse me “skemat e Mega-Dushkut” ai ka marrë një trajtë të papërcaktuar në literaturën politike botërore). Teorikisht dhe në frymën kushtetuese, sistemi zgjedhor synon të reflektojë në mënyrë sa më proporcionale trajtat politike të zgjedhësve (neni 64 i Kushtetutës). Fatkeqësisht, një objektivi i tillë kushtetues ende nuk është mishëruar në realitet. Deformimet e filluara me “Dushkun” në zgjedhjet e vitit 2001, të cilat e arritën kulmin në vitin 2005, bënë që ky sistem të jetë gjithnjë e më shumë i papërcaktuar, ku krijohet përshtypja se i jepet pak më shumë peshë proporcionalitetit, por në fakt ai cunohet më shumë.

Sistemet zgjedhore, në thelb, synojnë gjetjen e një formule sa më të përshtatshme të përkthimit të votave në “karrige” parlamentare në mënyrë sa më proporcionale. Këtë duket se ka synuar edhe ligjvënësi kushtetues, por hapësira ligjore në legjislacionin zgjedhor e ka bërë të pamundur arritjen e këtij objektivi kushtetues. Me të, jo vetëm që nuk arrihen objektivat kushtetues, por krijohen edhe përfaqësime politike fiktive, duke deformuar seriozisht vullnetin e zgjedhësve. Këto përfundime janë tashmë të pranuar nga të gjithë faktorët politikë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe si të tilla, duhet të përbëjnë fokusin kryesor të reformës zgjedhore.<sup>2</sup>

Një dukuri tjetër negative, që nuk shkëputet nga problemet e vërejtura më sipër, ka të bëjë me trafikun ilegal të votave dhe me format ilegale të ndikimit të kandidatëve të zgjedhësit dhe në administratën zgjedhore. Kjo erdhi edhe si pasojë e faktit që në zonat zgjedhore, jo vetëm që konkurronin kandidatët e partive tradicionale, por edhe ato të listave të hapura të proporcionalit, që nuk bënë gjë tjetër, veçse i shtuan edhe më shumë problemet e administrimit zgjedhor, përfshirë edhe pretendimet për blerje komisionerësh

---

<sup>2</sup> Këtu e kemi fjalën për propozimet mbi ndryshimin e sistemit zgjedhor, si dhe sugjerimet e OSBE/ODHIR në “Raportin Përfundimtar të Zgjedhjeve të 3 Korrikut në Shqipëri”

ose falsifikim rezultatesh në varësi të rezultateve të të tjerëve në zona të ndryshme të vendit.<sup>3</sup>

Dukuri të tilla, jo vetëm që nuk ndikojnë në shëndoshjen e sistemit demokratik, por e gërryejnë edhe më shumë legjitimitetin e politikës në sytë e publikut. Gjithsesi, ato nuk duken të shkëputura nga dobësitë e tjera të sistemit tonë zgjedhor, të shfaqura zgjedhje pas zgjedhesh. Sistemi kryesisht proporcional, i propozuar në këtë analizë, duhet të vendoset patjetër në këtë kontekst vendor, me qëllim minimizimin e anëve negative dhe të implikimeve të mundshme që vijnë prej tij.

### NË KËRKIM TË NJË SISTEMI KRYESISHT PROPORCIONAL

Dallimi thelbësor ndërmjet sistemit maxhoritar nga ai proporcional ka të bëjë me mënyrën se si votat e zgjedhësve përkthehen në numër vendesh në parlament. Sistemi proporcional, në dallim nga ai mazhoritar (i cili bazohet kryesisht në zonat njëemërore zgjedhore, ku fitues shpallet ai që ka marrë më shumë vota), bazohet kryesisht në ndarjen e fituesve zgjedhorë në bazë të përqindjes që ata kanë marrë dhe në proporcion të drejtë me të. Pra, në bazë të një përqindjeje të caktuar, një subjekti të caktuar politik i takon një numër i caktuar vendesh. Kuptohet, më sipër shpjeguar tiparin themelor që e karakterizon dhe e dallon këtë sistem, por kjo nuk përbën gjithçka. Sistemi proporcional mund të zbatohet në forma të ndryshme dhe mund të ketë formula të ndryshme të përkthimit të votave në vende, gjë që e bën këtë sistem shumë të larmishëm. Pikërisht këtë larmi e gjejmë në vende të ndryshme të botës. Më poshtë po identifikojmë disa nga opsionet e përdorura në vendet e tjera, që janë njëkohësisht të mundshme për zbatim edhe në vendin tonë.

---

<sup>3</sup> Këtu i referohemi pretendimeve dhe problemeve të raportuara gjerësisht në shtyp, në lidhje me falsifikimin e procesverbaleve të numërimit të votave nga ana e komisionerëve në disa zona zgjedhore të vendit.

## LISTA KOMBËTARE E PARTIVE (E MBYLLUR OSE E HAPUR)

Një variant i sistemit proporcional është ai që e trajton vendin si një zonë të vetme zgjedhore, ku partitë kandidojnë me lista partiake. Votat llogariten në favor të një subjekti dhe duke, u bazuar në përqindjen që subjekti politik përfiton në rang kombëtar, bëhet edhe ndarja e vendeve në parlament. Listat mund të jenë të mbyllura – pra, të përcaktuara në bazë të një preference të paracaktuar - ose mund të jenë të hapura – ai kandidat liste që ka marrë më shumë vota, futet i pari në listën e fituesve dhe kështu, me radhë, deri sa plotësohet numri që i takon atij subjekti politik, në bazë të përqindjes që ka marrë.<sup>4</sup>

Shpesh, një sistem i tillë parashikon edhe një prag minimal hyrës në parlament, që zakonisht varion nga 1 deri në 5 për qind. Sa më i ulët të jetë pragu hyrës, aq më shumë rriten shanset e partive të vogla për të hyrë në parlament. Kjo sjell një përfaqësim më të larmishëm dhe më të drejtpërdrejtë të interesave të zgjedhësve në forumet legjislative, duke imponuar koalicione të gjera dhe qeverisje konsensuale, si pasojë e fragmentizimit të skajshëm të parlamentit. Disa vende që zbatojnë sistemin proporcional, zbatojnë pragje të larta hyrëse, për të penguar në këtë mënyrë përfaqësimin e rrymave marginale në politikë dhe fragmentizimin e mëtejshëm të parlamentit.<sup>5</sup> Ndërkohë në vende të tjera, të cilat kanë ruajtur historikisht pragje të ulëta hyrëse, kompozimi i parlamentit ka shërbyer si shkak krizash dhe rrjedhimisht edhe reformash zgjedhore.<sup>6</sup>

ZONAT ZGJEDHORE SHUMË-EMËRORE<sup>7</sup>

Një formë tjetër e zbatimit të sistemit proporcional është ajo e zbatuar në

<sup>4</sup> Ky sistem është përdorur në Izrael, ku i gjithë vendi është një zonë zgjedhore me listë të mbyllur, si dhe në Hollandë (listë e hapur).

<sup>5</sup> Gjermania përdor pragu hyrës 5% për partitë politike.

<sup>6</sup> Izraeli – 1% deri më 1992 dhe Holanda -1.5 %

<sup>7</sup> Në Britani për zgjedhjet e Parlamentit Europian (listë e mbyllur) dhe në Finlandë, e cila përdor zonat shumëemërore me lista të hapura.

zonat zgjedhore shumemërore, ku një zonë zgjedhore nxjerr disa të zgjedhur, në bazë të përqindjes që fiton forca politike në këtë zonë. Kjo kërkon ndarjen e zonave relativisht të mëdha, në mënyrë që ato t'i korrespondojnë një numri të majftueshëm zgjedhësish dhe të krijohet edhe një raport i drejtë me të zgjedhurit. Sa më i madh të jetë numri i të zgjedhurve, që mund të nxjerrë një zonë zgjedhore, aq më të mëdha janë shanset e përfaqësimit të subjekteve zgjedhore. Kjo formulë mund të zbatohet edhe me anë të listave të hapura për çdo zonë zgjedhore, por kjo kërkon një sistem më të sofistikuar votimi e numërimi. P.sh., nëse nga një zonë zgjedhore dalin 5 deputetë, atëherë ky numër do të ndahet në bazë të përqindjes që marrin partitë e tyre përkatëse. Nëse numri është më i lartë, atëherë rriten shanset e përfaqësimit edhe për partitë më të vogla, pasi shifra që do të përpjesëtohet është më e lartë.

### SISTEMI PROPORCIONAL ME VOTË TË TRANSFERUESHME

Ekziston edhe një sistem tjetër me karakter kryesisht proporcional, por që bazohet në transferimin e votës dhe kalimin e saj në favor të kandidatit që mbetet në garë. Ky sistem është i ngjashëm me listat e hapura proporcionale, por votat e hedhura për kandidatin e eliminuar ose për kandidatin që ka arritur pragun hyrës, i kalojnë kandidatit me preferencën më të madhe që vjen më pas. Vazhdohet në këtë mënyrë, derisa të mbushen të gjitha vendet me fitues. Ky sistem zbatohet shumë pak dhe është shumë më i komplikuar, prandaj nuk po i referohemi gjatë si një opsion të mundshëm për t'u zbatuar në vendin tonë.<sup>8</sup>

Më sipër përshkruam sistemet e pastra të proporcionalit, çka zbatohet në një pjesë të rasteve, pasi një pjesë e madhe e vendeve zbatojnë një sistem të përzier, ku një pjesë zgjidhen drejtpërdrejt, kurse pjesa tjetër zgjidhet nga

---

<sup>8</sup> Ky sistem zbatohet shumë rrallë dhe vetëm në Maltë, Irlandë dhe Australi për zgjedhjet e Senatit.

proporcionali.<sup>9</sup> Këto vende mund të zbatojnë si zonat multi-përfaqësuese, ashtu edhe listat e mbyllura ose të hapura kombëtare.

### AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET QË PARAQET SISTEMI PROPORCIONAL

Pasi kemi identifikuar sistemet e ndryshme proporcionale, që zbatohen në mbarë botën demokratike dhe që mund të shërbejnë si modele të zbatueshme edhe për vendin tonë, le të hedhim një vështrim në anët pozitive dhe implikimet që sjell sistemi proporcional. Në nxjerrjen e tyre kemi bazuar në përfundimet e shumë studiuesve, të cilët kanë analizuar dhe krahasuar funksionimin e sistemit në vende të ndryshme të botës dhe që pranojnë si të mirëqena në pjesën më të madh të tyre, duke iu afruar gati një ligji të pakundërshtueshëm social, gjë që rrallë herë ndodh në shkencat politike.

Avantazhi kryesor që ofron një sistem i pastër proporcional zgjedhor është përfaqësimi i drejtë i interesave politikë të shoqërisë. Me anë të këtij sistemi arrihet të shmangët në maksimum disproporcioni i përfaqësimit ndërmjet votës së hedhur dhe përkthimit të vendeve në parlament. Në fakt është shmangia e disproporcionit të përfaqësimit tipari më dallues dhe njëkohësisht avantazhi më i madh që paraqet ky sistem. Ky përfundim ka dalë nga studime dhe krahasime të shumta të një numri të caktuar vendesh, nga ku mund të arrihet në përfundimin se, sa më i pastër dhe me prag të ulët të jetë futja në parlament, aq më i vogël është edhe disproporcioni në përfaqësim.<sup>10</sup>

Imponimi i demokracisë konsensuale mbi diktatin e shumicës është një avantazh tjetër i zbatimit të sistemit proporcional. Ky reflektohet më mirë në

<sup>9</sup> Pjesa më e madhe e vendeve europiane përdorin këtë sistem (RFGJ, Itali, France, Greqi, etj)

<sup>10</sup> Bazuar në krahasimin e bërë nga shumë studiues si Lijphart, Mackie & Rose, Nohlen etj. Shiko tabelën përkatëse Arend Lijphart "Pattern of Democracy" faqe162.



vendet ku garojnë një numër i madh partish, çka sjell shumica të pasigurta dhe që domosdoshmërisht sjell konsensus.

Sistemi lë pak shteg për manipulim në nivel vendor dhe është më i thjeshtë e ekonomik për t'u administruar. Propaganda politike do të fokusohet në nivel kombëtar, duke iu shmangur interesave të ngushtë vendore. Gjithashtu, ky sistem premtion më shumë në aspektin kualitativ, pasi të zgjedhurit do t'i besojnë më shumë vetëdijes së tyre politike, duke lënë në plan të dytë interesat e ngushta ose presionet nga zgjedhësit.

Anët pozitive të renditura më sipër sjellin edhe pasojat e tyre në vendet që e kanë zbatuar këtë sistem.

Fragmentarizimi politik sjell destabilitet në qeverisje ose krijimin e shumicave të paqëndrueshme. Kjo është një simptomë e zakonshme e politikës në vendet thellësisht proporcionale. Sistemi proporcional lë shteg për përfaqësimin e rrymave ekstreme në parlament. Sa më i ulët të jetë pragu zgjedhor, aq më i qartë bëhet ky problem.

Diktati politik nga lart dhe zgjedhja e kandidatëve nga udhëheqjet partiake janë një e metë tjetër e këtij sistemi. Kjo bëhet më e dukshme në listat e mbyllura të proporcionalit, ku diktati partiak është më i qartë dhe ku zgjedhësit nuk kanë aspak mundësi zgjedhjeje. Ky sistem i bën të zgjedhurit të jenë më tepër besnikë të lidershit partiak, sesa të interesave më të gjerë të zgjedhësve të tyre.

Përfundimet e mësipërme kanë një karakter të përgjithshëm dhe variojnë nga shumë faktorë vendorë, por sidomos nga konteksti politik, tradita dhe kultura politike në vend. Zbatimi i njërit ose tjetrit sistem, jodomosdoshmërisht i përfshin të gjitha simptomat pozitive ose negative të renditura më sipër. Por, të paktën ato shërbejnë për një krahasim të mundshëm me specifikat vendore dhe me çështjet që duhet të adresohen nga reforma zgjedhore.

Nisur nga sa u tha më lart, dhe pasi kemi nxjerrë në pah disa nga problemet e vërejtura me zgjedhjet në Shqipëri, do të ishte e udhës të analizonim avantazhet dhe disavantazhet e pranuar të sistemit në fjalë, duke i

mbivendosur këto në kontekstin vendor, për të parashikuar sadopak efektet e mundshme.

### SISTEMI PROPORCIONAL DHE IMPLIKIMET NË SHQIPËRI

Zbatimi i një sistemi proporcional në vendin tonë mund të korrigjojë dukshëm disproporcionalitetin e përfaqësimit të vërejtur vazhdimisht në vendin tonë. Kjo do të zhdukte përfundimisht dukuri të tipit “Dushk” ose çdo lloj forme të transferimit të votave. Njëkohësisht, mund të arrihet edhe një ç’ tensionim politik në nivel vendor, përsa i përket administrimit të votave, pasi të gjithë tashmë e pranojnë që propaganda “aktive” e kandidatëve në bazë, trafiku politik me strukturat vendore dhe përgatitjet e tyre zgjedhore përbëjnë burimin e shumë problemeve të vërejtura në të gjitha zgjedhjet e zhvillura në Shqipëri.

Do të ishte më e udhës për kushtet e Shqipërisë, sikur të vendosej një sistem proporcional dhe të përdorej formula e zonave shumëmemore. Me këtë kuptojmë krijimin e zonave zgjedhore me një numër që mund të variojë nga 5-10 për zonë. Kjo do të krijonte kushte reale për përfaqësimin e drejtë për të gjitha palët dhe do të rriste shanset e përfaqësimit të çdo subjekti në çdo zonë, me kusht akumulimin e një numri të caktuar votash. Kuptohet që një sistem i tillë kërkon zbatimin e formulave të veçanta të llogaritjes së votave, por këto nuk janë objekt i kësaj analize. Së paku, ky sistem do të mundësonte edhe një përfaqësim rajonal, duke ruajtur një lidhje të drejtpërdrejta me zgjedhësit.

Zbatimi i listave të hapura mund ta bënte sistemin edhe më konkurrues. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për tensionet e mundshme, të vërejtura gjatë administrimit të zgjedhjeve në vendin tonë. Por fakti se kemi të bëjmë me zona shumë herë më të mëdha se zonat aktuale zgjedhore, mund të minimizojë efektin e parregullsive.

Sistemi proporcional mund edhe të shërbejë si një mekanizëm për parandalimin e futjes së individëve pa interesa të mirëfillta politike, por me

aftësi për “të projektuar forcë në terren” ose “ndikim” te zgjedhësit. Bëhet fjalë për persona që zotërojnë burime financiare, qofshin këto edhe të paligjshme, por që sistemi zgjedhor mazhoritar i favorizon. Kjo mund ta shpëtonte politikën nga përfaqësimi në parlament i ndikimeve të paligjshme, pasi vendi ynë ka rekorde të këqia në këtë drejtim.

Megjithë anët pozitive të sipërpërmendura, një sistem proporcional nuk premtun t’i adresojë të gjitha problemet që lidhen me zgjedhjet ose me mirëqeverisjen. Edhe në vendin tonë ky sistem mund të shfaqë problemet që ka shfaqur në vendet e tjera. Këto kanë të bëjnë me krijimin e elitave politike ose apartçikëve partiakë dhe mund të shkaktojë humbjen e lidhjes me zgjedhësit.

Njëkohësisht, rritja e mundësisë së përfaqësimit mund të sillte fragmetarizim të mëtejshëm të parlamentit që, përveç konsesusit, mund të sjellë edhe kriza politike e mosqëndrueshmëri politike. Krizat e qeverisjes kanë qenë bashkudhëtare në vitet e fundit<sup>11</sup> dhe janë të pakta gjasat që këto të shuhen nga diversiteti i mëtejshëm i parlamentit, për të mos thënë që problemi mund të bëhet edhe më i mprehtë.

Kjo gjë mund të sjellë dhe një pasojë tjetër në politikë, humbjen e interesit nga ana e zgjedhësve dhe mospjesëmarrjen në votime, që kurrsesi nuk është e shëndetshme për demokracinë.

Së fundmi, një sistem absolutisht proporcional dhe me prag të ulët hyrës, mund të krijojë hapësirë përfaqësimi edhe për rrymat e skajshme në politikë, të cilat aktualisht mund të jenë anësore, por askush nuk mund të garantojë se ato do të qëndrojnë të tilla edhe më vonë.

\* \* \*

Pasi kemi renditur disa nga anët pozitive dhe negative, ose implikimet e mundshme në kontekstin politik vendor, mund të themi se vendimi per

<sup>11</sup> Nga 1997 – 2005 janë ndryshuar 8 kabinete qeveritare.

zgjedhjen e një sistemi të caktuar zgjedhor kërkon një hulumtim më të thellë dhe jashtë nevojave imediate. Zgjedhja e një modeli të caktuar duhet të jetë e lidhur me kërkesat dhe kufizimet e çdo vendi, përfshirë edhe çastin historik të këtij vendimi. Disa institucione, që janë funksionale ose të nevojshme për qëllime afatshkurtra, mund të sjellin implikime për konsolidimin demokratik afatgjatë. Përpara zgjedhjes së një sistemi të caktuar zgjedhor shoqëria duhet të zgjidhë dilema të tilla, si dhe më shumë efikasitet në qeverisje ose më shumë përfaqësim; më shumë profesionalizëm politik ose më shumë llogaridhënie poshtë. Pikërisht këtë duhet të bëjnë edhe politikanët shqiptarë, përpara se të zgjedhin zbatimin e një sistemi të caktuar zgjedhor.

## Problematika e sistemit proporcional në raport me realitetin shqiptar

*Blendi Kajsiu  
Politolog*

Pas zgjedhjeve Kuvendare të vitit 2005 në Shqipëri midis partive politike dhe më gjerë ka filluar një debat për sistemin zgjedhor. Një numër aktorësh politikë kanë shprehur shqetësimin e tyre në lidhje me sistemin zgjedhor aktual dhe kanë shtruar nevojën e kalimit në një sistem të pastër proporcional, ose proporcional rajonal për të paktën dy arsye: në mënyrë që të shmanget deformimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet dukurisë “dushk” dhe për të realizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme. Sipas “proporcionalistëve”, në një sistem proporcional të pastër zgjedhjet mund të administrohen më lehtë dhe janë më vështirësisht të manipulueshme. Gjithashtu, po sipas tyre ky sistem duhet pasi zhduk “megadushkun” dhe prodhon zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ndonëse nuk është qëllimi i këtij punimi, për të kontestuar argumentet në fjalë, duhet të theksojmë se “megadushku” mund të zhduket mjaft lehtë, duke njehsuar votën për partinë me atë të kandidatit ose nëpërmjet asaj që quhet votimi paralel, ku proporcionali nuk synon të korrektojë deformimet e mazhoritarit. Të dyja këto mënyra nuk kërkojnë ndryshimin e sistemit zgjedhor, por thjesht ndryshime të Kodit ekzistues.

Megjithatë, ky punim nuk ka si qëllim trajtimin e mënyrave sesi mund të shmanget “dukuria dushk”. Qëllimi i tij parësor është të bëjë një analizë të përgjithshme dhe parimore të impaktit që do të prodhojë në skenën politike kalimi nga sistemi zgjedhor aktual, në një sistem proporcional. Kjo analizë do

të mbetet e përgjithshme dhe parimore pasi për momentin nuk është i qartë lloji i proporcionalit që po kërkohet të implementohet në vend. Ka zëra që kërkojnë proporcional të pastër me një prag të rritur, sikurse ka edhe deklarata ku parashtrohet nevoja e një proporcionali rajonal. Ndonëse të dy këto sisteme futen në familjen e sistemeve proporcionale, ato kanë implikime mjaft të ndryshme për skenën politike shqiptare. Kështu, ndërsa një proporcional i pastër mund ta fragmentarizojë më tej skenën politike, në një sistem proporcional rajonal, sa më i lartë të jetë numri i rajoneve, aq më shumë rritet pragu zgjedhor, duke e forcuar edhe më tej bipolaritetin ekzistues dhe duke zhdukur tërësisht partitë e vogla. Pra, këto dy sisteme pavarësisht se cilësohen si proporcionale mund të kenë efekte krejt të kundërta, në varësi të mënyrës sesi zbatohen në praktikë. Për këtë qëllim përpara se të kryhet një analizë shteruese e avantazheve ose disavantazheve të secilit sistem, duhen ditur një sërë detajesh që kanë të bëjnë me prapun zgjedhor ose me numrin e zonave, nëse kemi të bëjmë me proporcional rajonal.

Në mungesë të këtij informacioni, analiza jonë do mbetet parimore dhe do të trajtojë pasojat që mund të prodhojë, si një sistem proporcional i pastër, ashtu edhe një proporcional rajonal. Për këtë arsye trajtimi do të jetë i ndarë në dy seksione: Një seksion që trajton potencialin e një sistemi të pastër proporcional dhe një seksion mbi proporcionalin rajonal. Trajtimi i këtyre sistemeve nuk do të mbetet thjesht në rrafshin teorik, pra, duke iu referuar literaturës mbi sistemet zgjedhore. Në thelb të trajtimit do të jetë konfigurimi aktual i skenës politike shqiptare dhe transformimet që mund të sjellë në këtë skenë ndryshimi i sistemit zgjedhor. Asnjë sistem zgjedhor nuk zbatohet ose prodhon pasoja në vakum, por në varësi të një konteksti të caktuar shoqëror dhe politik. Për këtë arsye analiza që vijon bazohet para së gjithash në karakteristikat e skenës politike shqiptare, duke i trajtuar ato si sistemin e referencës, në raport me të cilin vlerësohet ndryshimi i sistemit zgjedhor. Kjo për faktin e thjeshtë se nuk ekziston një sistem zgjedhor i përkryer. Çdo sistem teorikisht zgjidhet në raport me një synim të caktuar,

për të arritur një objektiv të caktuar politik, që gjithmonë realizohet në kurriz të një objektivi tjetër. Për këtë arsye edhe vlerësimi ose adoptimi i një sistemi të caktuar zgjedhor bëhet në raport me një ose disa objektiva ose karakteristika që synohen të stimulohen në një kontekst të caktuar politik.

Nga ky rregull nuk përbën përjashtim as Shqipëria. Në rastin konkret, karakteristika më kryesore, në raport me të cilën vlerësohet ndryshimi i sistemit, është përgjegjshmëria në qeverisje, ose *accountability* në anglisht. Premisa mbi të cilën bazohet analiza e ndryshimit të sistemit është se “një nga defektet më kryesore të demokracisë shqiptare është mungesa e përgjegjshmërisë në qeverisje.”<sup>1</sup> Ky është një përfundim gjerësisht i pranuar dhe i identifikuar nga një sërë analizash të ekspertëve të huaj dhe të brendshëm. Premisa e dytë më e rëndësishme që është njëkohësisht e lidhur pazgjidhshmërisht ngushtë me të parën është se demokracia shqiptare vuan si pasojë e pafrytshmërisë në qeverisje. Në fakt sondazhe të ndryshme tregojnë se ndonëse zgjedhësit shqiptarë e mbështetin demokracinë si sistem, ata janë të pakënaqur me performancën e saj në përmirësimin e nivelit të jetesës.<sup>2</sup> Përtej këtyre dy premisave themelore, elemente të tjerë, të cilët përbëjnë bazën vlerësuese në raport me të cilën trajtohet ndryshimi i sistemit zgjedhor janë: Frytshmëria në qeverisje, stabiliteti politik, përfaqësimi i interesave dhe i grupeve të ndryshme shoqërore, zbatueshmëria e sistemit zgjedhor, si dhe ndikimi i sistemit zgjedhor mbi procesin zgjedhor. Këto janë disa elemente të shkëputura prej një liste më të gjatë me kritere standarde që jepen për vlerësimin e një sistemi zgjedhor në shumicën e broshurave ose të studimeve që kanë të bëjnë me projektimin e një sistemi zgjedhor.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> “Albanian Democratization: in Search of Accountability.” Albanian Institute for International Studies (AIIS). Tirana, December 2004. p 8.

<sup>2</sup> Shiko Demokracia në Pushtetin Lokal – Rasti i Shqipërisë. Instituti Studimeve Ndërkombëtare (ISN). Tiranë 2003.

<sup>3</sup> Electoral System Design: The New International IDEA Hand Book. International Institute for Democracy and Electoral Assistance. Stockholm 2005. p7.

Në rastin konkret elementët e mësipërm janë përzgjedhur në raport me dinamikën dhe prioritet e demokratizimit shqiptar.

### IMPLIKIMET E KALIMIT NË NJË SISTEM TË PASTËR PROPORCIONAL

Për të kuptuar implikimet e kalimit në një sistem proporcional, më parë duhet të ndalemi shkurtimisht te karakteristikat e sistemit aktual dhe te pasojat që ai ka prodhuar në skenën politike shqiptare. Për momentin Shqipëria ka një sistem zgjedhor që klasifikohet si i përzier, pasi ai nuk mund të klasifikohet tërësisht as në familjen e sistemeve proporcionale dhe as në atë mazhoritare. Sistemi aktual është një kombinim i këtyre dy sistemeve. Kështu, sipas një logjike mazhoritare, 100 deputetë zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me një raund në zona njëemërore. Ndërsa për të ruajtur proporcionalitetin, pra një raport të drejtë midis përqindjes së votës dhe vendeve në Kuvend, 40 vende shpërndahen sipas përqindjes së votës së marrë në rang kombëtar, duke synuar korrektimin e deformimit që vjen nga mazhoritari.<sup>4</sup> Në fakt edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë shprehet qartë synimi për ruajtjen e proporcionalitetit në shpërndarjen e vendeve në Kuvend. Pra ndonëse shumica e deputetëve zgjidhen në mazhoritar, vetë sistemi synon të ruaj sa më shumë proporcionalitetin midis përqindjes së fituar në zgjedhje dhe përqindjes së vendeve të marra në Kuvend, çka është tipike për një sistem proporcional.<sup>5</sup>

Në thelb të sistemit aktual zgjedhor qëndron synimi për të prodhuar njëkohësisht qeverisje dhe përfaqësim, dy objektiva që shpesh janë në kundërshtim me njëra – tjetrën. Sistemi i pastër proporcional përgjithësisht prodhon përfaqësim, pasi mundëson përfaqësimin në Kuvend edhe të partive të vogla. Për të njëjtën arsye ky sistem çalon në qeverisje, pasi në të qeveriset

<sup>4</sup> Shiko Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

<sup>5</sup> Shiko Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë



nëpërmjet koalicioneve të gjera ndërpartiake, të cilat përgjithësisht nuk janë të qëndrueshme dhe për pasojë jo shumë të frytshme. Nga ana tjetër mazhoritari prodhon qeverisje të qëndrueshme, por zhduk përfaqësimin.<sup>6</sup> Rasti tipik është ai i Britanisë së Madhe, ku Partia Liberale është përfaqësuar shumë pak në Kuvend, ndonëse ka arritur të fitojë edhe më shumë se 20 për qind të votës në mbarë vendin. Ndërsa sistemi aktual zgjedhor shqiptar, nëpërmjet kombinimit të elementit mazhoritar me atë proporcional, synon të marrë dy anët më pozitive të secilit sistem, nga mazhoritari qeverisjen dhe nga proporcionali përfaqësimin. Njëkohësisht ajo që synohet është që shumica që mund të fitohet nëpërmjet mazhoritarit të kufizohet nëpërmjet elementit proporcional, në mënyrë që në Kuvend të mos krijohen shumica absolute. Të paktën ky ka qenë synimi teorik i hartuesve të sistemit zgjedhor.<sup>7</sup>

Ndonëse në praktikë kjo nuk është arritur, duhet thënë se sistemi zgjedhor e ka prodhuar rezultatin e dëshiruar. Për këtë mjafton të analizojmë shumë shkarazi rezultatet e dy zgjedhjeve të fundit Kuvendare, ato të vitit 2001 dhe 2005. Zgjedhjet Kuvendare të vitit 1996 nuk mund të jenë objekt i analizës sonë për shkak të nivelit të deformimit të tyre. Për të njëjtat arsye është e vështirë të analizosh zgjedhjet Kuvendare të vitit 1997. Të dy këto palë zgjedhje, 2001 dhe 2005, prodhuan shumica të thjeshta në Kuvend. Në rastin e zgjedhjeve të vitit 2001, shumica që u fitua në raundin e parë nga socialistët ishte fillimisht e thjeshtë. U desh manipulimi i sistemit dhe zbatimi i formulës së “dushkut”, në mënyrë që PS-ja dhe aleatët e saj të arrinin 3/5 e votës të nevojshme për të zgjedhur Presidentin. Por në këtë rast nuk ishte dështimi i sistemit që prodhoi këtë shumicë, por manipulimi i tij nga partia në pushtet,

---

<sup>6</sup> Arend Lijphart e hedh poshtë këtë argumentim në librin e tij ‘Patterns of Democracy’, Yale University Press, 1999. Ai argumenton se demokracia konsensuale (d.m.th. nëpërmjet proporcionalit) është po aq e frytshme sa ajo mazhoritare. Shiko veçanërisht Kreun 16, P 275.

<sup>7</sup> Intervistë vetjake me Alex Finnen, Zv. Kryetar i delegacionit të OSBE-së në Shqipëri. 20 shtator, 2003.

çka mund të ndodhë me çdo sistem. Po kështu, në zgjedhjet Kuvendare të vitit 2005, pavarësisht nga dukuria “megadushk”, përsëri sistemi zgjedhor prodhoi një shumicë të thjeshtë. Në të dyja rastet shumica që është prodhuar ka qenë e mjaftueshme për të qeverisur në mënyrë komode, por jo aq e madhe sa për të ndërhyrë në pjesën natyrore të shtetit ose në institucionet e pavaruara. Po kështu, në të dyja rastet, përveç qeverisjes kemi edhe përfaqësim pasi një numër i madh partish të vogla janë tashmë në Kuvend. Për më tepër sukcesi zgjedhor i Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) në zgjedhjet e fundit Kuvendare tregoi se pavarësisht nga bipolariteti që prodhon sistemi aktual, ai, gjithashtu, lejon edhe formësimin e forcave të reja politike nëse ato kanë aftësi, vullnet ose vizion për të tërhequr zgjedhësit. Kështu, në tërësinë e tij sistemi aktual duhet thënë se redukton deformimet e mazhoritarit, anashkalon destabilitetin që mund të prodhojë proporcionali dhe njëkohësisht prodhon qeverisje dhe përfaqësim. Pra, ky sistem, gjithmonë nëse nuk manipulohet, shfaq karakteristikat më të mira të të dy familjeve të sistemeve zgjedhore. Edhe kaq do të ishte e mjaftueshme që ky sistem të mos ndryshohej. Megjithatë, më poshtë do jepen edhe mjaft argumente shtesë në këtë drejtim, duke filluar nga implikimet negative të një proporcionali të pastër.

### IMPLIKIMET E SISTEMIT PROPORCIONAL

Duhet thënë që në fillim se pasojat e një sistemi proporcional mund të jenë vërtet shqetësuese për skenën politike shqiptare. Së pari, proporcionali mund të prodhojë destabilitet politik. Kuvendi do jetë i ngjashëm me atë të periudhës 2001 – 2005 pas çarjes që ndodhi brenda PS-së dhe që më pas prodhoi Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI). Në këtë periudhë Kuvendi shqiptar i ngjasonte shumë një Kuvendi të prodhuar nga një sistem proporcional i pastër. Ai, në fjalët e drejtuesit të atëhershëm të opozitës, Berisha, karakterizohej nga “aleancat fluide”, çka në fakt është normale për një Kuvend proporcional. Për këtë arsye PS-ja nuk mund të qeveriste, pasi të gjitha energjitë e saj konsumoheshin për të ruajtur ekuilibrat brenda partisë.

Shqetësimi i atëhershëm kryesor i forcës në pushtet ishte që të shmange një krizë ose bllokim në Kuvend, që do ta çonte vendin në zgjedhje të parakohshme, të cilat mund të fitoheshin nga opozita. Për këtë arsye niveli i qeverisjes në këtë periudhë ishte i dobët dhe në rënie të vazhdueshme. Kjo pasqyrohet qartë edhe në vlerësimet që i janë bërë Shqipërisë nga raporte të ndryshme ndërkombëtare, të cilat tregojnë stanjacion ose rënie në një sërë indikatorësh të qeverisjes dhe veçanërisht përsa i përket korrupsionit.<sup>8</sup>

Në përgjithësi një sistem i pastër proporcional prodhon një shumësi faktorësh politik që e bën qeverisjen të mundur vetëm nëpërmjet koalicioneve. Kjo është një formulë problematike, për të qeverisur në përgjithësi dhe për të kryer reforma në veçanti. Kjo, pasi reformat në përgjithësi kanë kosto zgjedhore dhe kërkojnë shumica të qëndrueshme në Kuvend. Me një sistem proporcional cilado forcë që do të vijë në pushtet nuk do të ketë shumicën e nevojshme për të kryer reforma, por do të përqendrohet thjesht në menaxhimin e ekuilibrave politik brenda koalicionit qeverisës, pak a shumë në të njëjtën mënyrë siç ndodhi në periudhën 2001 - 2005. Shpesh përparësitë e këtij koalicioni do përcaktohen nga tekat, dëshirat ose nevojat e brendshme të ndonjë partie me 5 për qind të votës, duke e marrë peng vullnetin e shumicës. Kështu, axhenda politike do të përcaktohet në kurriz të shumicës nga ndonjë pakicë që do të jetë vështirë të përcaktohet se përpara cilëve zgjedhës përgjigjet. Në këtë mënyrë tranzicioni shqiptar mund të zgjatet deri në pafundësi. Kjo edhe për faktin se çdo vend, në tranzicion ose jo, ka gjithmonë nevojë për reforma, në mënyrë që të përshtasë sa më mirë sistemin e tij/saj politik me nevojat e shoqërisë.

Diçka e tillë bëhet e vështirë me një sistem proporcional që, më shumë se çdo gjë, kujdeset për ruajtjen e ekuilibrave sesa për ndryshime thelbësore në qeverisje. Për pasojë, nuk është çudi që ato ndryshime, që nuk do të

---

<sup>8</sup> Shiko Freedom House, Nations in Transit (NIT) Report 2004, dhe Nations in Transit (NIT) Report 2005, të cilët i referohen periudhës 2003 – 2004. [WWW.freedomhouse.org](http://WWW.freedomhouse.org)

ndodhin në mënyre institucionale, të prodhojnë konfliktualitet ose shpërthime pakënaqësie në shoqëri. Kjo edhe për faktin sepse proporcionali sjell në pushtet një koalicion laraman që do të prodhojë më shumë administratë dhe poste politike, për të kënaqur nevojat e secilës parti, më shumë klientelizëm politik, më pak qeverisje dhe më shumë pakënaqësi me procesin politik në përgjithësi, që më pas do të përkthehet në apati politike. Nëse sot njerëzit janë mjaft të pakënaqur me “politikën”, në një sistem proporcional ata do ta urrejnë edhe më shumë atë. Nëse sot ata kanë mundësi deri diku të ndryshojnë diçka me votën e tyre, qoftë kjo edhe midis dy të këqijave, siç vlerësohen rëndom dy partitë e mëdha sot, nesër votuesit mund të ndodhen përballë një situatë, ku, pavarësisht sesi ata votojnë koalicioni qeverisës mbetet po njësoj laraman. Të gjitha këto, kombinuar edhe me pafrytshmërinë qeverisëse që prodhon proporcionali, do ta fusin vendin në kriza të njëpasnjëshme. Në mungesë të një zgjidhje politike nëpërmjet votës këto do të prodhojnë polarizim të mëtejshëm shoqëror, madje edhe konflikte sociale.

Për të kuptuar diçka të tillë duhet theksuar se në ligjërimin politik dhe popullor shqiptar tashmë ekziston, si në mjaft vende të tjera, ndarja “ne – populli” dhe “ata - politikanët”. Ekziston një hendek gjithnjë e në rritje midis atyre që qeverisin dhe të qeverisurve. Të parët futen në kategorinë homogjenizuese “politika” ose “klasa politike”, ndërsa të dytët në kategorinë homogjenizuese “populli”.<sup>9</sup> Qytetari humbet në homogjenitetin e konceptit popull, kurse procesi i politikbërjes shikohet si produkt dhe përgjegjësi vetëm e politikanëve. Në këtë mënyrë rritet pakënaqësia me atë që rëndom quhet “politika”, e cila perceptohet si gjithnjë e më larg “popullit”. Një sistem proporcional veçse e thëllon këtë hendek psikologjik, të paktën në dy mënyra. Së pari, proporcionali zhduk lidhjen e drejtpërdrejtë midis deputetit ose pushtetarit dhe votuesit. Në një sistem proporcional ata që zgjidhen nuk

<sup>9</sup> Kajsio, Blendi. “Ligjërimi steril”. Colloquium Liberal – Teza për një qeverisje të djathtë liberale. Tirana, 2004.

kanë asnjë nxitje të krijojnë marrëdhënie me votuesit si gjatë, ashtu dhe pas fushatës. Së dyti, një sistem proporcional, duke fragmentarizuar dhe destabilizuar skenën politike, e bën të vështirë përcaktimin e përgjegjësive si dhe ndarjen pozitive – opozitive. Në një sistem proporcional është e mundur që koalicioni qeverisës të mbetet njësoj shumëngjyrësh, pavarësisht nga mënyra sesi votohet. Në këtë mënyrë institucionalizohet ajo që sot quhet “klasa politike” dhe zhduket ndarja shumicë – pakicë që është e domosdoshme për të prodhuar përgjegjshmëri në qeverisje.

Fragmentarizimi i skenës politike do të nxitet edhe më tej për faktin se me një sistem proporcional fraksionet politike do të kenë edhe më shumë arsye për t’u larguar nga partia mëmë. Një nga arsyet që e ruan integritetin e partive të mëdha është fakti se sistemi aktual i penalizon partitë e vogla, çka në vetvete është diçka tejet pozitive. Në të njëjtën kohë roli dhe pushteti i kryetarit do të rritet edhe më tej, pasi ai do të ketë në dorë përcaktimin e listës së kandidatëve. Kjo kuptohet do të rriste edhe më tej pakënaqësitë dhe përplasjet brenda partisë, të cilat në praninë e një sistemi proporcional do të prodhonin më shumë shpëputje nga partia mëmë, duke e fragmentarizuar kështu skenën politike. Pra, nga njëra anë do kishim një centralizim, nga ana tjetër copëzim të mëtejshëm të partive ekzistuese. Kjo është një dukuri shqetësuese, pasi do pengonte konsolidimin e partive politike, çka tashmë ka filluar të ndodhë në Shqipëri. Ndërkohë që literatura ekzistuese mbi demokratizimin tregon se është e vështirë që të përftojme konsolidimin e demokracisë pa konsolidimin e partive politike. Me një sistem proporcional, më shumë sesa demokracia, ka shanse të konsolidohet partitokracia, sikurse e ka treguar përvoja në vende të tjera të Europës.

Diçka e tillë mund të jetë problematike jo vetëm për skenën politike, por edhe për shoqërinë përgjithësi. Në një sistem të pastër proporcional mund të formësohen parti në bazë të ndasive të ndryshme sociale, duke i thelluar këto ndasi edhe më tej. Kështu, përveç partive që mund të bazohen vetëm në një çështje të caktuar siç është prona, mund të kemi edhe parti me baza

thjesht fetare, krahinore ose rajonale. Kjo është edhe më e mundur me një sistem proporcional rajonal. Për një vend me diversitetin e Shqipërisë, kjo nuk është aspak e dëshirueshme. Një nga arsytet përse formacione të tilla nuk janë formuar është edhe sistemi zgjedhor aktual. Mbase ato nuk do të formohen edhe nëse në vend zbatohet një proporcional i pastër, megjithatë ky sistem i krijon të gjitha mundësitë që diçka e tillë të ndodhë. Duke pasur parasysh sesa e dëmshme mund të ish kjo për vendin tonë, nuk ka përse të riskohet duke kaluar në një sistem proporcional të pastër.

Një nga mënyrat për të kufizuar fragmentarizimin politik dhe pasojat që ai prodhon është nëpërmjet rritjes së pragut zgjedhor. Megjithatë, ndonëse pragu ka një ndikim mbi sistemin politik, studimet zgjedhore kanë treguar se ai nuk është një faktor përcaktues. Sado që të jetë pragu, 5 për qind, madje edhe 10 për qind, ai nuk i shmang domosdoshmërisht dukuritë e mësipërme, por thjesht mund t'i vonojë ato në kohë. Kjo, sepse sjellja e votuesit ndryshon nga sistemi mazhoritar, tek ai proporcional. Në mazhoritar votuesit gravitojnë drejt partive të mëdha, ndonëse mund të kenë simpati për ndonjë parti të vogël të të njëjtit krah. Kjo, sepse ata/ato nuk dëshirojnë që vota e tyre të shkojë dëm, pasi janë të ndërgjegjshëm që në një sistem mazhoritar partitë e vogla nuk kanë peshë. Kështu, në rastin e Shqipërisë ka mjaft votues që e ndjejnë veten më pranë Partisë Republikane, sesa asaj Demokratike, por që votojnë për këtë të fundit pasi e dinë që PR-ja nuk ka peshë dhe vota për të është një votë e humbur. Në momentin që sistemi zgjedhor ndryshon në proporcional, edhe sjellja zgjedhore e votuesve ndryshon ndjeshëm. Tashmë ata e dinë që partitë e vogla mund t'i imponohen koalicionit qeverisës nëse arrijnë një përqindje të caktuar. Për këtë arsye në një sistem proporcional është shumë më e lehtë të arrihet pragu 5 për qind. Rrjedhimisht partitë e mëdha e humbasin rëndesën e tyre, duke prodhuar fragmentarizim të skenës politike. Aq më tepër në një vend si Shqipëria ku shtrezimi social është ende larg.

## PROPORCIONALI RAJONAL

Pavarësisht se të dy sistemet, si proporcionali i pastër, ashtu edhe ai rajonal, i përkasin të njëjtës familje, asaj proporcionale, ato kanë efekte shumë të ndryshme dhe shpesh të kundërta në skenën politike të një vendi. Kjo në varësi të një sërë teknikalitetesh siç janë pragu zgjedhor, madhësia e distriktit zgjedhor, lloji i listës së kandidatëve (pra, nëse bëhet fjalë për listë të hapur ose të mbyllur), e kështu me rradhë. Së pari, duhet theksuar se, nëse në Shqipëri zbatohet një sistem proporcional rajonal është shumë e vështirë që ai të jetë me listë të hapur. Kjo për arsyen e thjeshtë sepse një listë e hapur e komplikon së tepërmi procesin e votimit, komplikon së tepërmi edhe procesin e numërimit, rrit ndjeshëm përqindjen e votave të pavlefshme si dhe koston e zgjedhjeve. Pra, në tërësi një proporcional rajonal me listë të hapur nuk ofron garanci për një proces të rregullt zgjedhor, çka është edhe arsyeja themelore se përse kërkohet ndryshimi i sistemit zgjedhor në Shqipëri. Për këtë arsye analiza që vijon ka për objekt sistemin proporcional rajonal me listë të mbyllur dhe implikimet e këtij sistemi për skenën politike në vend.

Megjithë saktësimin e mësipërm mbetet e vështirë të analizosh pasojat e një sistemi proporcional rajonal pa përcaktuar më parë numrin e rajoneve ose të deputetëve që zgjidhen për rajon. Megjithatë, në parim duhet thënë se sa më i madh të jetë numri i rajoneve, ose sa më i ulët të jetë numri i deputetëve që zgjidhen për rajon, aq më e vështirë është për partitë e vogla që të përfaqësohen në Kuvend. Kështu, nëse Kuvendi do kishte 100 deputetë, të cilët do zgjidheshin nga 20 rajone, pra 5 deputetë për rajon, atëherë një parti politike në një rajon të caktuar i duhen 20 për qind të votave për të fituar një deputet. Nëse bëhet fjalë për 10 rajone me nga 10 deputetë secili, atëherë kjo përqindje bëhet 10 për qind. Në rastin e parë kjo do të thotë që praktikisht pragu zgjedhor për t'u futur në Kuvend është 20 për qind, kurse në rastin e dytë 10 për qind. Praktikisht kjo do të thotë zhdukje tërësore e partive të vogla nga skena politike. Rrjedhimisht, përpos zgjedhjes me listë do ishte i nevojshëm edhe një element korrektues, sikurse ndodh në sistemin

aktual me 40 deputetët që merren nga proporcionali. Por kjo do të prodhonte një sistem jo më të thjeshtë, por më të komplikuar që mund të prodhojë deformime të reja në Kuvend. Megjithatë, nëse ky sistem zbatohet në mënyrë korrekte, ai do të prodhojë një konfiguracion politik të ngjashëm me aktualin, pra një sistem në thelb bipolar. Kjo në vetvete është diçka pozitive pasi bën të mundur identifikimin e përgjegjësive dhe një qeverisje të përgjegjshme.

Megjithatë, proporcionali rajonal mbart edhe një sërë pasojash negative, ndonëse mund ta lehtësojë procesin zgjedhor. Së pari, lista e mbyllur do të thotë pushtet absolut i kryetarit të partisë, i cili do të përzgjedhë kandidatët dhe do përcaktojë renditjen e tyre në listë, ose pushtet absolut i degës përkatëse në rajon që prodhon listën. Kjo do të thotë që politikisht dhe praktikisht institucioni më i rëndësishëm nuk është deputeti i zgjedhur në Kuvend, por dega e partisë ose kryetari i partisë në rajon. Për këtë arsye proporcionali rajonal me listë të mbyllur prodhon të ashtuquajturën “partitokraci”. Praktikisht në këtë sistem nuk qeveriset nga të zgjedhurit e votuesit më shumë, sesa nga organet e partisë në rajon dhe qendër.

Kjo situatë bëhet edhe më problematike, pasi prodhon rajonalizim të qeverisjes. Pra, mund të theksohen dhe pasqyrohen në Kuvend nuancat rajonale ose krahinore që janë të dëmshme për qeverisjen. Në fakt diçka e tillë ka ndodhur edhe me sistemin aktual, ndonëse ai nuk e favorizon një dukuri të tillë. Kjo tregon forcën e krahinorizmit në skenën politike shqiptare, çka e bën edhe më problematik proporcionalin rajonal. Me këtë sistem qeverisja në nivel makro ose kombëtar do të përballet me presionet që vijnë nga deputetët e rajoneve. Në të vërtetë, një nga mangësitë e sistemit aktual është se shpesh fondet e buxhetit devijohen nga deputetët të fuqishëm në zonat e tyre, duke deformuar kështu përparësitë qeverisëse në rang kombëtar. Diçka e tillë ka gjasa të ndodhë më shumë në një sistem proporcional rajonal.



## PËRFUNDIME

Shtjellimi i mësipërm është thjesht një vështrim sipërfaqësor mbi pasojat e mundshme të ndryshimit të sistemit aktual në proporcional të pastër ose rajonal. Më sipër janë trajtuar vetëm disa nga pasojat e mundshme të këtij ndryshimi. Natyrisht shumë të tjera janë lënë jashtë vëmendjes për shkak të hapësirës që ofron kjo ese, ose si pasojë e miopisë së autorit të këtij punimi. Megjithatë, ajo që vlen të theksohet në këtë pikë është se ndryshimi i sistemit zgjedhor ka pasoja sa afatgjata, aq edhe të paparashikueshme për skenën tonë politike. Më sipër janë parashtruar një sërë argumentesh, se përse kalimi në një sistem proporcional të pastër ose rajonal është problematik për Shqipërinë. Nëse janë të vërteta këto argumente, do të mjaftonin për të mos e ndryshuar sistemin aktual. Sistemi zgjedhor është një nga institucionet themelore të një demokracie, që si çdo institucion duhet konsoliduar. Ndryshimi i shpeshtë i tij prodhon destabilitet politik. Së pari, çdo ndryshim ka një kosto politike, pasi kërkon rinegociimin e rregullave të lojës, si p.sh. përcaktimi i zonave zgjedhore. Së dyti, çdo ndryshim ka edhe një kosto administrative, pasi nënkupton riorganizimin dhe ritrajnimin e trupës që do të merret me administrimin e procesit. Së treti, çdo ndryshim mund të çorientojë edhe votuesin e mësuar me një sistem të caktuar.

Të gjitha këto, kombinuar me problematikën që sjell proporcionali, do ishin të mjaftueshme për të mos e ndryshuar sistemin zgjedhor ekzistues, edhe sikur ky sistem të ishte realisht problematik. Ndërkohë që e kundërta është e vërtetë. Pra, sistemi ka qenë dhe është pjesë e zgjidhjes dhe jo e problemit. Të gjitha studimet që janë bërë për demokratizimin e Shqipërisë, si nga ekspertë vendas, ashtu edhe të huaj, publike ose jo, kanë treguar se problemi është me administrimin e zgjedhjeve dhe jo me sistemin zgjedhor. Rrjedhimisht, ajo që duhet përmirësuar është administrimi i zgjedhjeve dhe jo ndryshimi i sistemit zgjedhor, aq më tepër drejt një frymëzimi proporcional. Është e vërtetë që proporcionali e lehtëson bërjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, por zgjedhjet e lira dhe të ndershme nuk janë qëllim në vetvete.

Ato duhen në mënyrë që të identifikohet sa më qartë vullneti i shumicës, çka sistemi aktual e ka bërë edhe pse jo në mënyrë perfekte. Ndërsa proporcionali jo vetëm që nuk e bën identifikimin e vullnetit të shumicës, por përkundrazi shpesh e deformon atë edhe më shumë sesa një proces i kompromentuar zgjedhor. Në rastin më të keq proporcionali e zhduk shumicën, në rastin më të mirë shumica bëhet peng e kushtëzimit nga ndonjë pakicë.

## Ndryshimi i sistemit zgjedhor dhe pjesëmarrja në këtë proces

*Prof.Dr. Kristaq Kume  
Instituti Shqiptar për  
Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve*

Në nenin 64 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë janë dhënë pesë parimet bazë, të cilat rregullojnë sistemin zgjedhor të ne. Mbështetur në to dhe në zbatim të tyre, ligjvënësi ynë, me ligjin nr.8609, datë 8.5.2000 miratoi “Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, i cili, i ndryshuar me ligjin nr. 8770, datë 3.5.2001 shërbeu si baza ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës në qershor 2001. Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor në tetor 2003, Kodi Zgjedhor pësoi ndryshime të tjera, të cilat u fiksuan në të nëpërm et ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003. Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës, që u zhvilluan në 3 korrik 2005, patën si bazë ligjore të tyre Kodin Zgjedhor, të miratuar me ligjin nr. 9371, datë 14.4.2005.

Ndryshimet e herëpashershme të Kodit Zgjedhor në të gjitha rastet kanë qenë përpjekje për përmirësime të vazhdueshme, duke u nisur nga problemet që janë ndeshur gjatë zbatimit të tij në zgjedhjet paraardhëse. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve, ligjvënësi i ynë, për realizimin e këtyre ndryshimeve është mbështetur në rekomandimet e dhëna në raportet përkatëse përfundimtare të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it. Në mënyrë të vazhdueshme ekipet e ngritura për këtë qëllim kanë qenë të asistuar nga ekspertë të OSBE/ODIHR-it.

Duke bërë një vështrim retrospektiv për këtë proces legjislativ, të zhvilluar

pas miratimit të Kushtetutës, mund të arrihet, pa vështirësi, në një grupim të problemeve më kryesore që janë trajtuar në proceset e ndryshimeve të njëpasnjëshme të Kodit Zgjedhor. Pa dashur të analizojmë në tërësinë e tyre këto ndryshime, ndër grupimet problemore të mësipërme mund të renditen:

Problemet e që lidhen me administratën zgjedhore, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe komisionet zonale dhe/ose komisionet zgjedhore të qeverisjes vendore dhe komisionet e qendrave të votimit. Sigurimi i përfaqësimit politik në përbërjen e tyre duhet bërë në përputhje me parimin e përfaqësimit politik të ekuilibruar.

#### **Probleme të listës së zgjedhësve:**

- Probleme që lidhen me kërkesën për zbatimin e parimit kushtetues të përfaqësimit në Kuvend të forcave të ndryshme politike, në përqindje sa më të afër me përqindjen e votave të fituara prej tyre në shkallë vendi.

- Probleme të ankimimeve dhe të shqyrtimit të tyre.

Për çdo njëri nga problematikat e mësipërme, në Kodin Zgjedhor, nga njëri proces zgjedhor në tjetrin, ka pasur ndërhyrje, riformulime dhe shtesa përkatëse. Në shumicën e rasteve këto ndryshime kanë qenë shprehje e vullnetit të dy forcave kryesore politike të vendit tonë. Si të tilla, jo rrallë në to ndihet ndikimi i vullnetit të këtyre forcave, vullnet, i cili nuk është sprapsur edhe në rastet kur plotësim i tij ka kërkuar formulime që bien ndesh me Kushtetutën.

Për të gjykuar lidhur me efektet dhe rezultatit e gjithë këtij investimi legjislativ, mund mbështetemi, pa ndonjë gabim të konsiderueshëm në gjykim, te konsideratat e dhëna për procesin e fundit zgjedhor në vendin tonë. Ndër këto do të veçoja rekomandimin e dhënë në Raportin Përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, në të cilin shkruhet:

“SISTEMI ZGJEDHOR

6. Nëse ruhet sistemi zgjedhor i tanishëm:

· Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të siguruar që objektivi i proporcionalitetit në raport sa më të afërt, sipas nenit 64 pika 2 të Kushtetutës,

të mund të arrihet në mënyrë më të efektshme

7. Megjithatë, autoritetet shqiptare mund të dëshirojnë **të rishikojnë sistemin aktual zgjedhor** në mënyrë përfshirëse dhe gjerësisht konsensuale.” (*Republika e Shqipërisë. Zgjedhjet për Kuvendin, 3 korrik 2005. Raporti i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it*)

Mendoj se është i mjaftueshëm vetëm ky citim nga Raporti i Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR-it për të arritur në përfundimin se ajo që është realizuar deri më sot nuk ka arritur të zgjidhë problemet dhe tashmë, në mënyrë të qartë dhe shkoqur, rekomandohet si një ndër rrugëzgjdhjet trajtimi i problematikës legjislativë zgjedhore deri në nivelin e Kushtetutës.

Nuk jam në kundërshtim me shqyrtimin edhe të kësaj alternative, por, përpara se ta shqyrtojmë atë, të gjithë ne, klasa politike shqiptare, institucionet që janë përfshirë dhe kanë kontribuar në zhvillimin e procesit legjislativ zgjedhor, shoqëria civile për aq sa është pyetur dhe përfshirë në këtë proces, si dhe, më së fundi por jo më pak të rëndësishmit, institucionet këshilluese e ekspertët e huaj, duhet të analizojmë së pari dhe në të tërë ecurinë e tij të gjithë investimin e bërë deri më sot në këtë drejtim. Për mbi të gjitha kjo analizë retrospektive është e domosdoshme se, nëpërmjet saj, do të mund të gjykohej për ato që nuk janë bërë mirë, çfarë nuk është realizuar, si është kërkuar ose këshilluar si rrjedhojë e presioneve dhe interesave politikë, çfarë është anashkaluar ose formuluar josaktë si rrjedhojë e presionit të kohës së pamjaftueshme, pse, zakonisht, siç dihet, veprimtaria për reformimin e legjislationit zgjedhor ka qenë intensive vetëm në prag të fushatave zgjedhore.

Në referimet e tyre, kolegët parafolës trajtuan aspekte shumë të rëndësishme teorike që lidhen me sistemet e ndryshme zgjedhore, rreshtuan të mirat dhe efektet pozitive e negative të çdonjërit prej tyre, sa dhe si ato ndikojnë në institucionet dhe qeverisjet që prodhojnë. Me shumë interes ishin konsideratat e dhëna për sistemet e ndryshme, në rastet e zbatimit të tyre në vendin tonë etj. Pavarësisht nga parapëlqimet për njërin ose tjetrin sistem, pavarësisht nga konsideratat e dhëna për kushtet që duhet të rrepektohen në

rastet e zbatimit të njërit ose tjetrit sistem etj., e përbashkëta e të gjitha qëndrimeve ndaj tyre ka të bëjë me faktin se asnjëri nga këto sisteme nuk është më pak a më shumë demokratik se tjetri. Nuk është sistemi që afekton standardet në një proces zgjedhor, por janë tërësia e rregullave legjislative që hartohen në përputhje me kërkesat e sistemit dhe, akoma më shumë, mungesa ose jo e vullnetit për respektimin dhe zbatimin e këtyre rregullave. Vetëm duke u mbështetur në këto konsiderata, analiza e procesit legjislativ zgjedhor të zhvilluar në vendin tonë pas miratimit të Kushtetutës mund të bëhet më objektive dhe, për pasojë, edhe vendimmarrja për ndryshime do të jetë më e bazuar dhe efektive.

Pa pretenduar se në një paraqitje si kjo do të mund të analizohej në tërësinë e tij ky proces por, duke ftuar të gjithë kolegët ta konsiderojnë nevojën për këtë analizë si një sugjerim metodik në punën që do të bëhet për reformën e ardhshme zgjedhore, do të ndalem vetëm në një aspekt të procesit legjislativ, me synimin që, nëpërmjet tij të arrij të nënvizoj domosdoshmërinë e analizës së plotë të asaj, se çfarë është bërë dhe si është bërë, për të shkuar natyrshëm, pas kësaj, në një reforme të re zgjedhore. Fjala është për dukurinë “dushk” ose “megadushk” që, më të shumti i faturohet sistemit zgjedhor që është i sanksionuar në Kushtetutën tonë.

Përpara se kjo dukuri të emërtohej kështu, kujtoj se për të është përdorur një shprehje, më pak pezhorative, por që në thelbin e saj nuk ndyshonte asgjë - kandidatë të pavarur. Kështu u deklaruan në regjistrin e kandidatëve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në qeshor të vitit 2001, deri figura të shquara të partive politike. Të gjithë e kujtojmë procesin që pasoi këto veprime dhe kundërveprime politike të dy partive të mëdha PS e PD, në thelb të cilave ishte, shmangia në maksimum e efektit negativ që sillte për këto subjekte zgjedhore formula e fiksuar në Kodin Zgjedhor, sipas së cilës do të bëhej ndarja e 40 vendeve të proporcionalit. U desh ndërhyrja e autoriteteve ndërkombëtare që të pranohej kompromisi dhe të autorizohej Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të investiguar në lidhje me pavarësinë e kandidatit.

Megjithëkëtë, problemi, në thelbin e tij nuk u zgjidh. Për të mos i dhënë më shumë të drejta vetes në gjykim, le të pranojmë se rasti e solli që kjo formulë e ndarjes së vendeve të proporcionalit të shfrytëzohej, në këto zgjedhje, për të prodhuar atë që u emërtua dukuria “dushk”.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit të Vëzhguesve Ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR-it, ndër të tjera theksohet “Neni 66 i Kodit Zgjedhor përcakton një formulë, e cila përpiket të ndajë të 40 mandatet plotësuese në një mënyrë të tillë që “të kompensojë” partitë, të cilat kanë siguruar një pjesë të votave në shkallë vendi, por që nuk arritën të fitonin një numër të mjaftueshëm zonash njëemërore për të pasqyruar mbështetjen e tyre zgjedhore. Megjithatë, neni 66 mund të anashkalohet, duke qenë se Kodi Zgjedhor ofron mundësinë e përdorimit të dy votave, një për zonën njëemërore, ku banon votuesi, dhe një për listat partiake në shkallë vendi... formula e ndarjes mund të anashkalohet në rast se zgjedhësi hedh votën e tij të parë në favor të kandidatit “të pavarur” dhe votën e tij të dytë për partinë politike që “mbështet” kandidatin “e pavarur”, ... Në këtë mënyrë, partia politike është në gjendje të “fryjë” pjesën e saj të 40 mandateve plotësuese në shkallë vendi ... Ndarja e mandateve plotësuese dhe shfrytëzimi i pseudokandidatëve “të pavarur” u bënë çështjet më të debatuar në periudhën e fushatës zgjedhore”. (Republika e Shqipërisë. Zgjedhjet parlamentare, 24 qershor 2001. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it) Më tej në këtë Raport, duke ju referuar efekteve të dukurisë “dushk” theksohet: “Fitorja e PS-së në këto zgjedhje nuk u vu në diskutim, por vetëm thellësia e kësaj fitoreje u vu në pikëpyetje”.

Në rekomandimet e dhëna të bien në sy dy momente – mundësia që krijon formula e ndarjes së vendeve të proporcionalit, për të përthyer vullnetin e zgjedhëseve dhe votimi me dy fletëvotimi si mjeti për realizimin praktik të kësaj mundësie. Kujtoj se kjo është shprehur si e tillë menjëherë pas zgjedhjeve të qershorit 2001. Veç këtyre, në atë kohë, ndërkombëtarët rekomanduan: “Sistemi zgjedhor kërkon thjeshtim dhe reformim dhe duhet të rishqyrtohet me synimin e futjes së një sistemi që të mundësojë zhvillimin

e zgjedhjeve në një ditë të vetme në të gjithë vendin” (Republika e Shqipërisë. Zgjedhjet parlamentare, 24 qershor 2001. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it).

Veç këtyre rekomandimeve, për realizimin e reformës zgjedhore të radhës, ligjvënësit shqiptarë, iu vu në dispozicion edhe një material i gjerë me rekomandime të hollësishme të përgatitura nga Komisioni i Venecies, në bashkëpunim me Zyrën e ODIHR-it dhe Komisionin European. Ndër të tjera, në këto rekomandime theksohej edhe trajtimi i problemit të thjeshtimit të formulës së ndarjes së 40 vendeve të proporcionalit “në përputhje me të gjithë kërkesat e nenit 64 të Kushtetutës” dhe që të jetë “transparente, e thjeshtë për t’u zbatuar, e qartë dhe plotësisht e kuptueshme për votuesit”.

Rezultati i reformës zgjedhore, që u realizua mbështetur edhe në këto rekomandime, tashmë dihet. Nga dukuria “dushk” u kalua në dukurinë “megadushk”. Komisioni bipartizan dhe ligjvënësi nuk u investuan fare për gjetjen e rrugëve, të cilat do të parandalonin, me mjete ligjore, përdorimin shpërdorues të shtegut të krijuar në Kodin Zgjedhor, i cili krijonte kushte për rishfaqen e kësaj dukurie, në përmasa edhe më të mëdha. Nuk u bë asnjë këshillim dhe as nuk u provokua ndonjë diskutim për thjeshtimin e formulës së ndarjes të vendeve të proporcionalit dhe, në të njëjtën kohë edhe të zbehjes në maksimum të efektit “dushk” që ajo gjeneron. U keqinterpretua rekomandimi për “thjeshtimin, reformimin dhe rishqyrtimin e sistemit me qëllim futjen e një sistemi që mundësonte zhvillimin e zgjedhjeve në një ditë të vetme në të gjithë vendin” dhe për zbatimin e tij u anashkalua Kushtetuta.

Në këto kushte, me të drejtë mund të bëhet pyetja: Përse është vepruar në këtë mënyrë? Pse nuk u reagu në kohë por, vetëm pas shfaqes së efekteve “megadushk” rekomandohet ose nxitet diskutimi për **rishikim të sistemit aktual zgjedhor**? Cili është ndryshimi, në thelbin legjislativ, midis situatave të krijuara nga zbatimi i Kodit Zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2001 dhe rezultatit të marrë nga zbatimi i tij në zgjedhjet e vitit 2005, ndryshim që justifikon, vetëm tashti, hapjen e diskutimit për ndryshimin e sistemit zgjedhor



në Republikën e Shqipërisë?

Nga analiza e mësipërme, ani pse është një analizë e thjeshtë dhe skematike, del qartë fakti se ky diskutim dhe ndërmarrja e nismavetë tilla legjislativë janë të vonuar në kohë. Kishte dashur të diskutoheshin këto probleme menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në qershor 2001. Kjo vonesë, për mendimin tim, duhet të interpretohet dhe të përdoret si argument për mungesën e vullnetit të forcave tona politike, për zgjidhjen, në themel, të problemeve. Me sa duket, në zhvillimin e këtij procesi reformues legjislativ nuk është patur si i parë dhe udhërrëfyes interesi i të gjithë shoqërisë. Me sa duket, forcat politike, kur kanë ndërmarrë nisma legjislativë dhe kanë realizuar reforma zgjedhore, si të parë kanë pasur interesin e tyre, duke u justifikuar me faktin se këta interesa janë njëherazi edhe shprehje të koncentruara dhe të formalizuara të interesit të të gjithë shoqërisë.

Për zhvillim e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe në përputhje me standardet e gjithëpranuara, jemi të interesuar dhe i dëshërojmë të tërë. Këtë deklarojnë edhe subjektet politike dhe për këtë duhet të angazhohen edhe institucionet e tjera të vendit. Në funksion të këtij objekti me efekte gjithëpërfshirës e mbarëshoqëror nuk kanë munguar edhe nismat për bashkërendimin e përpjekjeve midis subjekteve politike, insitucioneve, grupeve të ndryshme të interesit, organizatave dhe përfaqësuesve të ndryshme të shoqërisë civile, organizmave dhe konsulentëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve vendas. Ne kemi krijuar përvojë edhe në këtë drejtim, por duhet të gjithë të pranojmë se gjithë çfarë është arritur deri sot është e pamjaftueshme. Ende nuk kemi arritur të institucionalizojmë një marrëdhënie bashkëpunimi pjellor. Historia e procesit të bashkëpunimi midis strukturave legjislativë dhe forcave politike nga njëra anë dhe pjesës tjetër të shoqërisë, mund të shkruhet vetëm me disa rreshta. Të mandatuarit me përgjegjësinë për zhvillimin e reformës zgjedhore dhe partitë politike, për të cilat hartohen këto rregulla, në raste të rralla kanë kërkuar edhe mendimin e institucioneve

jopolitike e joshtetërore dhe të ekspertëve që nuk janë të aktivizuar në struktura partiake. Ashtu sikurse në ndonjë rast, të gjithë këta janë thirrur jo për kontribute por, më shumë për të realizuar një **show** mediatik. Kjo situatë nuk duhet të vazhdojë të mbetet e tillë. Interesi i të gjithëve është që, më së fundi, të arrijmë të realizojmë një reformë zgjedhore, e cila të prodhojë një legjislacion me sa më pak hapësira për ndërhyrje shpërdoruese dhe me kosto sa më të ultë për zbatimin e saj. Dhe kjo bëhet realisht e mundur vetëm në qoftë se për realizimin e saj angazhohen të gjithë aktorët e shoqërisë, politike dhe jopolitike. Bashkime të tilla krijojnë kushte që problemet të trajtohen në tërësinë e tyre dhe jo vetëm në funksion të interesit të një ose disa forcave politike. E theksoj këtë se jam i bindur se po të ishte vepruar në këtë mënyrë, hapësirat ligjore për transformimin e dukurisë “dushk” në “megadushk” do të ishin shumë më të zvogëluara.

Përfshirja e aktorëve të ndryshëm nga shoqëria civile në krah të forcave politike dhe institucionet e tjera, në reformën zgjedhore, ka kuptim të bëhet vetëm në rastin kur secili merr përgjegjësi dhe i zhvillon ato, duke aktivizuar energjitë dhe të gjithë potencialet e veta. Pjesëmarrja për fasadë dhe pa produkte të prekshme, jo vetëm që nuk sjell gjë pozitive, por, më shumë se kaq, gjeneron efekte negative. Po kështu, nuk mjafton deklarimi për gatishmërinë për bashkëpunim, por është i domosdoshëm edhe disponimi i çdokohshëm dhe institucional. Nën këtë opsion, përpara pak kohësh një grupim prej 13 organizatash joqeveritare; që kanë si objektiv të tyre dhënien e kontributit për zhvillimin e reformës zgjedhore, u deklaruan se do të punojnë sëbashku me sloganin “Aksioni qytetar për reformën zgjedhore” Kjo është një risi që duhet të tërheqë vëmendjen e Kuvendit të Republikës dhe të të gjithë forcave politike e institucioneve që do të përfshihen në kryerjen e reformës zgjedhore. Ky grupim i organizatave më aktive të shoqërisë civile në këtë fushë, jo vetëm që ofron ndihmesën e tyre, por, në të njëjtën kohë, ka marrë përsipër të jetë edhe faktor presioni për realizimin e një reformë të ardhshme, si produkt i të gjithë shoqërisë dhe jo vetëm i partive politike e,

akoma më pak, vetëm i dy partive të mëdha politike. Përfaqësuesit e këtyre organizatave u shprehën se është koha që zëri i tyre, opsionet e teknicienëve dhe specialistëve që ato mund të aktivizojnë, duhet të konsiderohen si një ndër burimet kyësore të informacionit dhe propozimet e tyre të jenë ndër të parat që duhet të merren parasysh prej ligjvënësit në procesin e realizimit të reformës zgjedhore. Duke patur shtrirjen në pothuajse të gjithë vendin dhe duke bashkuar në to një numër të konsiderueshëm grupesh të ndryshme interesi e qytetarësh, këto organizata kanë marrë përsipër të realizojnë një proces diskutimi me pjesëmarrje sa më të madhe. Një ndër to janë edhe veprimtaritë që po zhvillojmë sot së bashku. Në këto diskutime, qytetarët do të ftohen të japin mendimin e tyre për sistemin zgjedhor që duhet të ketë vendi i ynë, për ndryshimin ose jo të Kushtetutës, për mënyrën e votimit me një fletë ose më shumë, të diskutojnë për cilësitë, përbërjen, detyrat dhe të drejtat e administratës zgjedhore, për rolin e partive politike dhe të kandidatëve të tyre në proceset zgjedhore, financimi edhe transparencën e tij, listën e zgjedhëseve dhe numërimin e përqendruar të fletëve të votimit, ankimimet etj. Kështu do të synojmë që të sjellim në tryezën e hartuesve të reformës zgjedhore sa më shumë mendime dhe sa më shumë opinione të mbarë shoqërisë.

Në suksesin e kësaj nisme, që për mendimin tonë do të jetë pjesë e suksesit të dëshiruar dhe të pritur të reformës zgjedhore, nuk mjafton vetëm dëshira dhe angazhimi i nxitësve dhe përfshirësve në të. Thelbësor është mirëkuptimi dhe realizimi i një bashkëpunimi aktiv e të vazhdueshëm me partitë politike e institucionet legjislativë. Jemi të ndërgjegjshëm se nuk është e lehtë të realizohet ky bashkëpunim. Te ne është e mangët kultura e bashkëpunimit, në përgjithësi dhe akoma më shumë mungon kjo kulturë në rastet e ndërmarrjeve të mëdha, siç është edhe reforma zgjedhore. Kështu e lexojmë ne mungesën thuajse të plotë të përfaqësuesve të partive politike, veç LSI-së e LZHK-së, parlamentit dhe të institucioneve të tjera, përjashtuar Ministrinë e Brendshme, në veprimtarinë iniciuese të “Aksionit qytetar për

reformën zgjedhore”. Megjithëkëtë vullneti nuk mungon, ndjenja e përgjegjësisë nuk prapset dhe besimi në mirëkuptimin e pritshëm për bashkëpunim midis të gjithë aktorëve që kanë për detyrë dhe/ose që dëshërojnë të kontribuojnë në reformën zgjedhore është shtysë për veprime të mëtejshme.

## Shprehja e sovranitetit të popullit: mënyrat e votimit\*

Jacques Cadart  
Përktheu : Diana Estrefi

Mënyrat e votimit janë mjetet shprehëse të sovranitetit të shtetasve. Ato quhen, gjithashtu, edhe *regjime* ose *sisteme zgjedhore dhe* janë të domosdoshme për të caktuar fituesit, pasi zgjedhjet nënkuptojnë disa rregulla, të cilat mundësojnë llogaritjen e votimeve për kandidatët, duke përcaktuar se cilët midis tyre do të jenë të zgjedhurit. Kjo është një domosdoshmëri praktike, që bazohet në teknika të sakta dhe shpeshherë të ndërlikuara.

Përzgjedhja e një mënyrë votimi është tepër e nevojshme për kryerjen e zgjedhjeve të përfaqësuesve. Ndryshe ndodh me “*votimet*” e tjera, domethënë referendumet, ku mënyra e votimit imponohet prej thjeshtësisë së opsionit që i ofrohet zgjedhësve (M. Marcel Prelot në përmbledhjen e vitit 1972, f. 658, ia rezervon termin “votim” referendumeve, sipas zakoneve zvicerane: ne na duket më e logjikshme t’i quajmë “votime” të gjitha mënyrat).

**Mënyra e votimit që përdoret në referendum** është e vetme, sepse vetëm një formulë shërben për nxjerrjen e përfundimit: sistem mazhoritar me një raund. Duke qenë se referendumi përmban dy përgjigje të mundshme, *po e jo*, përdoret *sistemi mazhoritar me një raund*, domethënë pa përsëritje. Është e qartë që do pranohet ajo përgjigje që merr shumicën, shumicë kjo

---

\* Ky material është pjesë e librit ‘Institutions politiques et Droit Constitutionnel’ Economica, 1990, Paris.

gjithmonë *absolute*, domethënë më shumë se gjysma, meqenëse ekzistojnë vetëm dy përgjigje të mundshme<sup>1</sup>.

Meqë për llogaritjen e  *shumicës absolute* përdoret vetëm shuma e *votave të shprehura*, abstenimet nuk luajnë asnjë rol në vendim: mospjesëmarrjet e zgjedhësve, të cilët nuk shkojnë para kutive të votimit dhe mospjesëmarrjet e vullnetshme, me anën e fletëve të bardha ose të pavlefshme tradicionalisht në Francë janë ngatërruar: për këto vota thuhet se janë të *pashprehura*, dhe i tillë është rregulli normal në vendet e huaja. Ky përkufizim është i diskutueshëm, sepse legjitimisht mund të mendohet se fleta e bardhë nuk përcaktohet si mungesë në votim, por si tregues i shprehjes së një opinionit. Megjithëkëtë, e drejta publike franceze e ka hartuar mirë rregullin: përveç dispozitës juridike të kundërt, fletët e bardha nuk janë vota të shprehura.

Mirëpo në *Francë*, qoftë kur bëhej fjalë për  *zgjedhje, referendume* ose *votime brenda asambleve*, pikërisht asambleve parlamentare,  *shumica është llogaritur gjithmonë, në të gjitha votimet, mbi votat e shprehura dhe vetëm mbi to, përveç teksteve shprehimisht të kundërta*. Votat e shprehura, pra, janë përcaktuar vetëm si rezultante e shfaqjeve të opinionit pozitiv ose negativ dhe jo të një opinionit asnjanes. Ndoshta mund të mendonim për një referendum të organizuar në një mënyrë tjetër, por historia e regjimeve demokratike nuk jep pothuajse fare shembuj të tillë.

**Mënyrat e votimit të përdorura në zgjedhje** janë, përkundrazi, jashtëzakonisht të larmishme dhe ndahen në disa kategori të mëdha. Të tilla janë dy format thelbësore të votimit mazhoritar me një dhe me dy raunde, përfaqësimi proporcional dhe sistemet e përziera ose hibride, ku ndërthuret sistemi mazhoritar dhe proporcional sipas modaliteteve të ndryshme dhe të shumëllojshme. Shumica e këtyre sistemeve mund të paraqiten në të dyja format e votimit njëemëror dhe atij me listë.

<sup>1</sup> Mund të krijohej një referendum me dy raunde, nëse në raundin e parë nuk është arritur shumica ose një përqindje e caktuar e të regjistruarve, por duket se nuk ka patur precedentë të tillë.

*Zgjedhja midis votimit njëëmëror dhe votimit sipas listës dhe, si pasojë, problemi i ndarjes së zonave janë çështje të rëndësishme, por që, në krahasim me përzgjedhjen mes katër kategorive të mëdha të votimit, mbeten në plan të dytë.*

Në votimin sipas listës, çdo zonë cakton disa parlamentarë, ku numri i të zgjedhurve është në proporcion me popullsinë e saj. Zonat zgjedhore përkojnë me zonat e mëdha administrative të decentralizuara ose jo, dhe në Francë me departamentet, ndonjëherë të ndara më dysh dhe me qytetet e mëdha: praktikisht nuk shtrohet problemi i ndarjes zgjedhore.

Përkundrazi, është tepër e vështirë zgjidhja me sistemin njëëmëror, i cili kërkon ndarjen e vendit në zona të barabarta, gjë që është gjithmonë në diskutim, pasi secila zonë duhet të zgjedhë vetëm një deputet. Kjo ndarje çon shpeshherë në manipulime zgjedhore të pandershme, duke siguruar fitoren e disa partive prej shkathtësisë së kalimit të territoreve në zonat fqinje.

Ky “*gerrymander*” (vjen nga emri i guvernatorit të Masaçusetsit, Gerry, i cili u bë shumë i njohur në këtë art në shekullin e XIX), është aq i thjeshtë sa frika prej tij pengoi rivendosjen e votimit njëëmëror në Francë, në vitin 1951. Mundësia e vetme e shmangies prej tij është që ndarja zonale t’i besohet personaliteteve të paanshme, sipas sistemit britanik ose duke pranuar një ndarje të pabarabartë me zonat administrative, siç janë rajonet franceze të Republikës së III. Në vitin 1958, ndarja zonale franceze u bë në mënyrë tepër korrekte nga partitë në pushtet, por sistemi që ishte i parregulluar që atëherë, do të kishte nevojë për një rishikim të vështirë për t’u realizuar, për arsye edhe të situatës të ndërlikuar politike.

Megjithatë zgjedhja midis sistemit të listës dhe atij njëëmëror shpesh nuk diktohet nga vështirësitë e ndarjes së zonave. Ai varet nga përparësitë dhe mangësitë e secilit në sy të ligjvënësit. Sistemi zgjedhor njëëmëror afron të zgjedhurin me zgjedhësit, prej të cilëve ai ka mundësi të njihet lehtë, por ai çon, gjithashtu, edhe në përzgjedhjen e kandidatëve për arsye aq lokale dhe personale, sa që i zgjedhuri shpesh ndodhet jashtë mase në varësinë e

zgjedhësve dhe interesi i përgjithshëm si edhe problemet kombëtare mbesin në harresë gjatë veprimtarisë politike, sidomos kur përfaqësuesit nuk janë të inkuadruar në partitë e mëdha; këto të këqija janë reduktuar nga partitë e mëdha në Britaninë e Madhe dhe nga rigrupimi i forcave politike në Francë që prej vitit 1958.

Sistemi zgjedhor i listës mazhoritare dhe ai i listës me përfaqësim proporcional nuk i kanë këto defekte, por ata i largojnë zgjedhësit nga të zgjedhurit, ku më pak përzgjidhen njerëzit sesa partitë dhe programet, të cilave parlamentarët u nënshtrohen, ndonjëherë edhe në mënyrë abuzive. Ky abuzim bëhet shumë i rëndë me përfaqësimin proporcional nga lista, ku përfitojnë udhëheqësit kombëtarë të formacioneve politike. Megjithëkëtë, në çdo vend, përzgjedhja e mënyrës së votimit varet më shumë nga katër kategoritë e mëdha të sistemeve zgjedhore në kuadrin e të dhënave politike të kohës.

#### § 1. – SISTEMI MAZHORITAR.

Sistemi mazhoritar i votimit është më i thjeshti dhe më i vjetri i të gjithë sistemeve zgjedhore. Sistemi mazhoritar me një raund është përdorur gjithmonë në Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara dhe në vendet e tjera anglosaksone. Sistemi mazhoritar me një raund është tradicional në Francë, ku ka ekzistuar që me krijimin e institucioneve zgjedhore në mesjetë.

I – Teknika e sistemit mazhoritar të votimit.

Zgjidhen ata kandidatë që fitojnë më shumë vota. Me *votimin mazhoritar me një raund*, i zgjedhuri caktohet nga  *shumica relative* mbi çdo kandidat tjetër, edhe pse kjo shumicë mund të jetë më e ulët se shumica absolute e votimeve të shprehura. Përkundrazi, *votimi mazhoritar me dy raunde* kërkon  *shumicën absolute në raundin e parë*, ndërsa  *shumica relative mjafton tek i dyti*.



*Praktikisht, të zgjedhurit e raundit të dytë marrin pothuajse gjithmonë shumicën absolute, që rrallëherë mund të arrihet në raundin e parë. Po kështu, fituesit e sistemit me një raund marrin pothuaj gjithnjë shumicën absolute. Ky paradoks krijohet nga ulja e numrit të kandidatëve të raundit të vetëm ose të raundit të dytë dhe nga psikologjia e zgjedhësve, të cilët e përqendrojnë votimin e tyre te kandidatët më seriozë.*

Votimi me dy raunde i jep mundësi zgjedhësve të përzgjedhin mes kandidatëve të shumtë të raundit të parë, ku ata që kanë fituar pak tërhiqen përpara raundit të dytë. Prandaj duhen ndaluar kandidaturat e reja në raundin e dytë. Në Republikën III kjo gjë nuk ishte e ndaluar, duke ndikuar kështu në rezultatin real të votimit. Në Republikën V u ndalua rikandidimi për ata që kishin marrë më pak se 5% të votave gjatë raundit të parë, ndërsa që nga viti 1967 (ligji i 29 dhjetorit 1966), më pak se 10% të numrit të zgjedhësve të regjistruar dhe mesatarisht 12 ose 13% të votave të kryera. Ky rregull i ri e zvogëlon shumë numrin e kandidatëve në raundin e dytë. Në vitin 1976 u bë një reformë e re, e cila e forcoi edhe më shumë këtë kërkesë si dhe pasojat që dalin prej saj. Në fakt, më 10 korrik 1976, Asambleja Kombëtare aprovoi përfundimisht një ligj i cili ndryshonte Kodin zgjedhor (ligji nr.76-665, datë 19 korrik 1976), duke e çuar në 12.5 përqindjen e numrit të zgjedhësve të regjistruar, si kërkesë që kandidatët e raundit të parë të mund të riparaqiteshin në raundin e dytë. Projekti i qeverisë kërkonte 15%. Por kundërshtimi i U.D.R.-së çoi në një rrugë të mesme mes përqindjes së propozuar dhe 10 përqindshit që ishte në fuqi. Kjo reformë u shtri edhe në zgjedhjet bashkiake në qytetet me më shumë se 30 000 banorë si edhe në ato kantonale, të cilat, si njëra dhe tjetra, nuk njihnin asnjë rregull të këtij lloji (liria e plotë e kandidimit në raundin e dytë që ekzistonte për zgjedhjet kantonale, lejonte që deri në datën e zgjedhjeve të këtij raundi mund të paraqiteshin edhe ata që nuk kishin qenë kandidatë në raundin e parë, ashtu si për zgjedhjet parlamentare në Republikën e III). Kjo reformë ka si qëllim kufizimin e kandidaturave në raundin e parë të zgjedhjeve parlamentare në

dy ose tre kandidatë të rëndësishëm për partitë e shumicës. Rezultati i kësaj reforme qe efektiv në shumicën e zonave më 12 mars 1978 (491 vende për t'u plotësuar) dhe në raundin e dytë më 19 mars.

Që prej vitit 1962, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës me votim të përgjithshëm të drejtpërdrejtë, në raundin e dytë mund të paraqiten vetëm dy kandidatët që janë në krye të rezultatit të raundit të parë, ose, ata që vijnë nëse të parët tërhiqen. Ky rregull mund të përdoret edhe për zgjedhjen e deputetëve, ashtu siç bëhej në Regjimin e Vjetër për zgjedhjen e Përfaqësuesve në epokën e Restaurimit.

## II – Pasojat e sistemit mazhoritar të votimit.

Të dyja format e sistemit mazhoritar kanë efekte të njëjta e të kundërta njëkohësisht.

### A. – Pasojat e sistemit mazhoritar me një raund.

Efektet e sistemit të votimit mazhoritar me një raund janë shumë të qarta dhe të sakta: janë ligje të vërteta sociologjike dhe psikologjike që rregullojnë këtë sistem zgjedhor<sup>2</sup>.

Në fakt mund të pohohet në një mënyrë praktikisht të sigurtë se *sistemi mazhoritar me një raund çon medoemos në një bipartizëm atë vend, popullsia e të cilit është mjaft homogjene*. Një provë të tillë e gjejmë në Britaninë e Madhe dhe në Shtetet e Bashkuara, si edhe në mjaft vende të tjera anglosaksone. Ky pohim mbështetet, gjithashtu, në shembullin gjerman të viteve 1949-1972, megjithëse Gjermania e ka adoptuar pjesërisht sistemin britanik, vetëm për sa i përket zgjedhjes së gjysmës së deputetëve të Bundestag-ut.

---

<sup>2</sup> Në votimin britanik, shih J. Cadart 'Sistemi zgjedhor dhe sistemi parlamentar në Britaninë e Madhe', Paris, A. Colin, 1948, dhe veprat e David Butler.

Këto vende praktikisht nuk kanë më shumë se dy parti ose “dy parti e një çerek”, siç thuhet ndonjëherë, “çereku”, F.D.P.-ja, partia liberale gjermane ka një ekzistencë gjithnjë të rrezikuar, megjithëse në vitin 1972 ajo i dyfishoi votat (8.5%), falë përfaqësimit proporcional të përdorur me sistemin britanik.

Këto pasoja të votimit mazhoritar me një raund mund të ndodhin, megjithatë, vetëm kur popullsia është mjaftueshmërisht homogjene. Kur popullsia është heterogjene, kjo tendencë prishet në atë masë, siç mund ta konstatojmë aktualisht në Kanadanë e ndarë mes dy komuniteteve kanadeze, atij francez dhe anglez. Divergjencat skoceze, galeze dhe irlandeze kanë bërë të shfaqen në Britaninë e Madhe partitë nacionaliste, të cilat e turbulluan bipartizmin britanik gjatë zgjedhjeve të 28 shkurtit 1974 dhe 10 tetorit 1974. Por këto çrregullime mbeten të kufizuara dhe nuk prekin ligjet bazë të kësaj mënyre votimi.

a) *Ligji psikologjik*, i cili përcakton këtë dukuri është i thjeshtë: “Zgjedhësi voton **utile**”<sup>3</sup>, e thënë ndryshe, zgjedhësit votojnë në atë mënyrë që votat e tyre të kenë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve. Ata votojnë shumë rrallë për kandidatin që u pëlqen më shumë kur ai nuk ka shanse serioze për t’u zgjedhur. Pra, ata votojnë për kandidatin më pak të papëlqyeshëm dhe që është i zoti të pengojë zgjedhjen e një kandidati që për ta është tepër i papëlqyeshëm. Në fakt, qëllimi i tyre është më shumë të pengojnë zgjedhjen e këtij të fundit, sesa të sigurojnë zgjedhjen e një kandidati të kënaqshëm.

Kjo votë “**utile**” e zvogëlon progresivisht numrin e partive, duke krijuar sistemin dypartiak. Fillimisht ai kthen betejën zgjedhore në çdo zonë vetëm në betejë mes dy kandidatëve. Pastaj, dukuria bëhet standarde për të gjitha zonat, sepse në një vend me shoqëri homogjene, problemet zgjedhore ndjehen njësoj nga të gjithë zgjedhësit dhe partitë reagojnë po njësoj. Anomalitë e dy zgjedhjeve të përgjithshme britanike të vitit 1974 duket se nuk mund ta përgënjeshtrojnë këtë analizë.

---

<sup>3</sup> Voter utile: je i detyruar të votosh për atë që ka më shumë shanse për të fituar (shën. i përkth.).

Këto dukuri mund të numërtohen, të maten dhe të kthehen në ligj matematik.

b) *Ligji matematik* i sistemit mazhoritar të votimit me një raund rregullon në mënyrë të përpiktë ligjin psikologjik që u përshkrua më sipër. Kjo është pothuajse e vetmja fushë e shkencës politike ku mund të përdoret një ligj i saktë matematik, duke dominuar mbi dukuritë komplekse dhe thelbësore.

Ky ligj çon, përveç kësaj, në *një ekzagjerim të përfaqësimit të shumicës* dhe në një *nënpërfaqësim të dukshëm të pakicës*. Ai u zbulua, sipas metodës eksperimentale, nga *M. David Butler* në studimet e tij prej mjeshtri të publikuara që prej vitit 1974.

Shprehja e parë e këtij ligji kuptohet lehtë, por është pjesërisht e pasaktë dhe me përfaqësim:

Në rastin e sistemit dypartiak dhe të votimit mazhoritar me një raund, kur këto dy formacione grumbullojnë së bashku të paktën 90% të votave të shprehura, nëse një parti merr një shumicë prej 1% të votimit mbi tjetrën, shumica e saj parlamentare do të jetë pak a shumë 1,5 ose 2,6% e vendeve.

Ky pohim mund të duket i çuditshëm, por ai është frut i një studimi të thellë, bërë mbi shumë zgjedhje të përgjithshme britanike, e pikërisht mbi të gjitha zgjedhjet e kryera pas luftës së fundit.

Shumica zgjedhore e një partie i jep asaj, pra, në mënyrë të pashmangshme shumicën parlamentare, por kjo është një shumicë e ekzagjeruar, e forcuar në mënyrë të konsiderueshme nga kjo mënyrë votimi, përderisa shumica zgjedhore shumëzohet me 2,6 në gjirin e Dhomës së komunave: si pasojë, shumica parlamentare është gjithmonë dërrmuese. Pra, në qoftë se partia e shumicës merr 4% të votave më shumë se partia e pakicës, shumica e saj parlamentare do të jetë 2,6 x 4, si përqindje e vendeve, domethënë një shumicë pothuajse katër herë 16 vende ose 17 vende (mesatarisht) në 630 (deri në vitin 1970), ose 635 (pas vitit 1974). Kjo është vërtet një shumicë parlamentare plotësisht e rehatshme.

Në qoftë se shumica zgjedhore arrin përqindje më të larta, pakica brenda

parlamentit rrezikon të jetë krejtësisht e dërrmuar. Pikërisht atëherë shprehja e ligjit bëhet false, sepse ajo do t'i jepte partisë fituese matematikisht, me shumica të mëdha zgjedhore, më shumë se 100% të vendeve. Ky formulim është i vlefshëm pra, vetëm për ato shumica zgjedhore relativisht të dobëta dhe jo për shumicat e forta. Megjithatë, ajo ka përparësinë të paraqesë në mënyrë të dukshme dukurinë e ekzagjerimit të shumicës dhe të nënpërfaqësimit të pakicës. Në Britaninë e Madhe, zgjedhjet e viteve 1930 dhe 1935, që i kanë dhënë qeverisë shumicat bashkëkohore më të forta, e kanë kaluar pakicën në një numër të vogël vendesh.

Për të shprehur me saktësi ligjin, duhet, megjithatë, të përdoret një tjetër formulë matematike shumë më tepër e saktë, por më pak e kuptueshme, që rëndom quhet “ligji i kubit”, sepse mbështetet në llogaritjen e numrave në kub. Ajo formulohet në këtë mënyrë:

Në qoftë se raporti i votave të marra nga dy partitë e mëdha është  $A/B$ , raporti i vendeve do të jetë:  $A$  në kub, mbi  $B$  në kub, domethënë  $A^3/B^3$ .  $A$ -ja tregon votat e partisë fituese dhe  $B$ -ja tregon ato të partisë që humbet.

Një formulë e tillë lejon llogaritjen lehtësisht të numrit të vendeve të secilës parti, ciladoqoftë përqindja në votime. Ajo është shumë e saktë, pavarësisht disa anomalive të votimit që e prekin ndonjëherë verifikimin.

Kështu, sistemi mazhoritar me një raund e çon pothuajse në mënyrë të pashmangshme në sistem dypartiak një vend homogjen, duke i dhënë shumicën absolute të vendeve partisë fituese prej numrit të votave (ka patur vetëm një përjashtim në Britaninë e Madhe, në vitin 1951), e duke e ekzagjeruar në mënyrë të konsiderueshme këtë shumicë. Rezulton një nënpërfaqësim i partisë së pakicës që është krejtësisht simetrike me mbipërfaqësimin e partisë së shumicës. Votimi është rrënjësisht i padrejtë, në proporcione të njohura fare mirë, pasi ato janë të numërtuara matematikisht. Kjo padrejtësi është, gjithashtu, e njohur shumë mirë nga zgjedhësit dhe nga partitë që përdorin këtë mënyrë votimi. Ata përshtaten lehtë me të, pasi përparësitë e sistemit janë aq të konsiderueshme, sa që

kompensohen gjerësisht të këqijat që vijnë prej tij.

Megjithëkëtë, katër zgjedhje të përgjithshme britanike i janë larguar pak këtij rregulli: zgjedhjet e viteve 1923, 1929 dhe të shkurtit 1974, të cilat nuk i dhanë shumicën absolute të vendeve asnjë partie, dhe zgjedhjet e vitit 1951, të cilat i dhanë një shumicë absolute të dobët, prej 15 vendesh Konservatorëve, edhe pse Laburistët kishin marrë 200 mijë vota më tepër (1% të votimit afërsisht). Këto parregullsi janë të shpjgueshme.<sup>4</sup>

c) *Kushtet e nevojshme për një funksionim të mirë të ligjeve të votimit* ndonjëherë bëhen pengesë.

Dukuria e vetme e vitit 1951 ishte pasojë e një ndarjeje tepër të pabarabartë të zonave dhe e shumicave tepër të mëdha të laburistëve, që e defavorizonin të majtën. Këto faktorë duket se janë neutralizuar.

Rezultatet e viteve 1923, 1929 dhe të shkurtit 1974 ishin pasojë edhe e krizës së sistemit dypartiak, që iu shkaktua sistemit zgjedhor nga shkaqe të jashtme: zëvendësimi progresiv i *Labour Party* në *Parti Liberale* që nga viti 1918 deri më 1931 dhe përtëritja liberale e vitit 1974. Përtëritja e fundit e partisë së qendrës i ka dhënë një përqindje të rëndësishme (19,3% më 28 shkurt 1974 dhe 18,3% më 10 tetor 1974), gjë që nuk kishte ndodhur që prej vitit 1929. Kjo i dedikohet krizës britanike, gabimeve të dy partive të mëdha dhe joshjes nga lëvizja liberale dinamike dhe e rinovuar.

Si rrjedhim, shuma e votave të dy partive të mëdha ra shumë më poshtë se pragu prej 90%, që kërkohet për një funksionim të mirë ligjeve të votimit

<sup>4</sup> Zgjedhjet e 28 shkurtit 1974 çuan në një tjetër parregullsi: konservatorët patën një superioritet mbi laburistët prej afër 1% të votave, ose 308 000 vota, por 4 vende më pak. Kjo parregullsi, e cila ndodhi në zonën e votimit britanik të gabimeve të mundshme dhe tepër të vështira për t'u eliminuar, ishte bërë tashmë edhe në dobi të konservatorëve në vitin 1951. Është e vërtetë se, ndryshe nga votimet e vitit 1951, asnjë nga dy partitë nuk mori shumicën absolute të vendeve më 28 shkurt 1974. Parregullsia rezultoi më shumë në vitin 1974, prej përqindjes së madhe që mori përjashtimisht partia e tretë: 19,3%. Dukuria e ndodhur në vitin 1951 mbetet, pra, e vetme dhe si rrjedhojë jashtëzakonisht e rrallë.

(75,4% më 28 shkurt 1974 dhe 75,1% më 10 tetor 1974). Është e vërtetë se shfaqja e partive të rretheve, partitë nacionaliste skoceze dhe galeze (respektivisht 7 dhe 2 deputetë më 28 shkurt 1974, si dhe 11 dhe 3 vende më 10 tetor 1974) si edhe grupet irlandeze (11 unionistë protestanë dhe 1 katolik i moderuar më 28 shkurt 1974, 10 unionistë protestanë konservatorë disidentë dhe 2 socialistë të pavarur katolikë më 10 tetor 1974), të cilët morën në total 6% të votave në të dy votimet, lidhej me përtëritjen liberale për të turbulluar ligjet e votimit. U arrit kështu ai homogjenitet social i vendit, aq i nevojshëm në lojën e këtyre ligjeve.

Megjithatë, duket se dukuritë e vitit 1974 nuk i kanë prishur ligjet mbi votimet, gjë që mund të verifikohet me rezultatet e Anglisë së vetme. Ata vetëm nënvizojnë që kushtet e domosdoshme për funksionimin e ligjeve mbi votimet nuk mund të plotësohen as në Britaninë e Madhe. Rezultate të tilla nuk duket se zgjasin shumë. Përtëritja liberale është tepër e brishtë në këtë sistem zgjedhor, ashtu siç e tregojnë edhe sondazhet dhe zgjedhjet e pjesshme (shih: mbi ato të 27 prillit 1978). Në qoftë se ajo zhduket, votimet do të prodhojnë sërish efektet e zakonshme, por të zvogëluara nga suksesi i nacionalistëve skocezë, të cilët duken se janë shumë më të fuqishëm për shkak të përqindjeve të tyre rajonale: për të arritur shumicën absolute të vendeve, sukseset e secilës nga dy partitë e mëdha duhet të jenë tepër të dukshme, që të mund të kapërcejnë atë handikap të lartë të fituesve irlandezë. Rezultatet e vitit 1974 janë aq shumë të dukshme, sa që së bashku me një tjetër precedent, përbëjnë përjashtim për ligjin e fundit mbi votimet.

d) *Ligji britanik i votimeve paralizon shfaqjen ose rishfaqjen e një partie të tretë.*

Këtë e vërtetojnë humbjet e shumta të partive të së majtës në Britaninë e Madhe, dhe pikërisht të asaj komuniste, e cila ka mbetur përherë e parëndësishme. Vetëm partia laboriste ka shpëtuar nga ky ligj tepër i ashpër deri në suksesin e nacionalistëve skocezë dhe galezë më 1974. Suksesi rajonal i partisë skoceze, e cila ishte tepër e fortë, është përjashtimi i dytë i këtij

rregulli në historinë e votimeve të Britanisë së Madhe. Mësimet e dala prej votimeve të vitit 1974 treguan se sa e vështirë mund të jetë zhvendosja e sistemit, pikërisht lufta kundër sistemit shumëpartiak në Francë, si edhe surprizat që ajo mund të përcjellë, veçanërisht në nivel rajonal.

*Efektet e votimit mazhoritar me një raund janë, megjithatë, të lakmueshme.* Ky regjim zgjedhor kompenson në kohë padrejtësitë e tij të pakontestueshme, me alternime në pushtetin e dy partive të mëdha. Ai vendos një bipartizëm tepër të favorshëm për stabilitetin qeverisës dhe për demokracinë: shumicat homogjene vijnë njëra pas tjetrës, duke rralluar krizat politike dhe duke mundësuar që zgjedhësit vetë të caktojnë partinë fituese, qeverinë dhe kryetarin e saj, domethënë gjithë ekipin drejtues dhe udhëheqësin e asaj partie, si edhe programin e saj. Në të njëjtën kohë ai siguron moderimin e luftrave politike, duke i detyruar të dyja partitë që të triumfojnë prej njëra-tjetrës, falë zgjedhësve centristë, me të cilët ata grinden dhe për të cilët ata nuk mund të propozojnë programe utopike, të perealizueshme ose ekstremiste. Ky angazhim më i madh drejt qendrës është një nga aspektet më të dukshme të votimit mazhoritar me një raund; por ai shfaqet gjithashtu edhe në votimin mazhoritar me dy raunde.

B. – Pasojat e sistemit mazhoritar me dy raunde.

Sistemi imazhoritar i votimit me dy (ose më shumë) raunde ka qenë, që prej Mesjetës (shtetet e përgjithshme, asamblatë e shteteve, asamblatë provinciale, institucionet fetare etj.) sistemi zgjedhor i Europës kontinentale, deri në vitin 1914. Veçanërisht ai u bë sistemi zgjedhor francez, përveç disa eklipseve të shkurtra (1919-1924 dhe 1945-1956), por pothuajse është zhdukur, duke përjashtuar Zvicrën në zgjedhjet e Këshillit të Shtetit, në shumicën e kantoneve.

*Efektet e këtij sistemi janë të thjeshta: ai ndërton shumica të qarta, por shumëpartizane.* Këto shumica janë frut i raundit të dytë, i cili i imponon zgjedhësit një votë po aq shumë të nevojshme sa edhe sistemi mazhoritar



me një raund. Mirëpo raundi i parë i shpërndan votat mes kandidatëve të paraqitur nga disa parti të së majtës ose të së djathtës në shumicën e zonave: kandidati i së majtës dhe ai i së djathtës, që është në krye, mbetet i vetëm në betejën për raundin e dytë në pjesën më të madhe të zonave, duke marrë votat e të gjithë spektrit që përfaqësojnë. Por në nivel kombëtar, si vendet e së djathtës edhe ato të së majtës ndahen midis shumë grupeve politike.

Ky sistem shumëpartiak që përfshin gjithë gamën politike është pasojë e votimit, i cili i lë një liri të madhe zgjedhësve dhe partive në raundin e parë, por që i detyron ata t'i përqendrojnë kandidatët dhe votat e tyre në raundin e dytë. *“Në raundin e parë zgjidhet, në të dytin eliminohet”*, e thënë ndryshe votohet sipas formulave të dhëna, tepër të sakta. Mendimi i zgjedhësve dhe marrëveshjet e heshtura, të fshehta ose zyrtare mes partive, konkurojnë së bashku për këtë rezultat, i cili arrin të ndërtojë gjithmonë shumica të qarta, por të ngritura mbi koalicione shumëpartiake.

Në qoftë se partitë e qendrës së djathtë dhe të qendrës së majtë janë mjaft të rëndësishme, rezultati i votimit është i moderuar, siç e tregojnë rezultatet e zgjedhjeve të Republikës së III dhe të V franceze. Por, përkundrazi, nëse partitë ekstremiste janë të fuqishme, rreziqet e një përballjeje mes formacioneve të kundërta dhe larg tolerancës demokratike mund të acarohen në mënyrë tepër të rrezikshme, duke shkaktuar tensione mjaft shqetësuese, siç ka ndodhur në disa aspekte në zgjedhjet e viteve 1968, 1973, dhe 1978. Megjithatë, karakteri moderator i votimeve duket se ka fituar më shpesh: që prej vjeshtës 1974 deri në mars 1978, me këtë sistem zgjedhor, frika e partisë komuniste për një bashkim të së majtës në favor të socialistëve, është pa baza.

Sistemi shumëpartiak nuk është pasojë e pashmangshme e këtij sistemi zgjedhor, i cili mund të çojë, gjithashtu, edhe në sistem dypartiak ose pothuajse dypartiak, siç e kanë treguar belgët në shekullin e XIX. Ata faktorë që mund të favorizojnë konstituimin e një partie të madhe, mund të pengojnë të tjerat për t'u grumbulluar. Atëherë zgjedhja bëhet që në raundin

*e parë, i cili bëhet kështu raundi i vetëm, megjithë mundësinë për një të dytë. E tillë qe pasoja e bashkimit të partisë së madhe katolike belge, e cila u bashkua nga një kohezion spontan me natyrë fetare, duke iu kundërvënë fillimisht partisë liberale, dhe pastaj partisë socialiste belge, deri në vendosjen e përfaqësimit proporcional, në fund të shekullit të XIX: mënyra e re e votimit i shpëtoi liberalët, të cilët partia socialiste po i eliminonte.*

*Sistemi shumëpartiak është, megjithatë, prodhimi më i shpeshtë i kësaj mënyre votimi. Ai mund të jetë shumë i padisiplinuar, ose, në të kundërt, i rrethuar nga *aleanca të fuqishme*: Republika III dhe V franceze tregon qartë që këto dy rezultate janë të mundshme.*

Epërsia e njëres apo tjetres formulë varet nga *faktorë jashtëzgjedorë me natyrë kushtetuese*. Rregullat e lojës mund të favorizojnë mungesën e stabilitetit të shumicës, siç e lejonte Kushtetuta e vitit 1875, e cila paralizonte të drejtën e shkrirjes që varej nga autorizimi i Senatit; përkundrazi, kushtetuta e vitit 1968, duke e rivendosur këtë të drejtë dhe duke forcuar qeverinë, i lejon kësaj të fundit të sigurojë në vazhdimësi kohezionin e shumicës. I njëjti fenomen luan kështu edhe me sistemin e votimit me një raund, disiplina bipartizane e të cilit nuk do të ishte kurrë koherente, në qoftë se qeveria do ishte e çarmatosur përballë shumicave të njëpasnjëshme, siç lë të nënkuptosh sistemi politik i Shteteve të Bashkuara, por ato tregojnë gjithashtu se edhe në këtë kuadër, sistemi zgjedhor me një raund ruan dypartizmin në çdo zgjedhje të përgjithshme.

Me një fjalë, *sistemi zgjedhor me dy raunde duket si një sistem votimi shumë më tepër asnjanes se ai me një raund*: ai bashkohet më lehtë me faktorët e tjerë të jetës politike, duke përcaktuar së bashku numrin dhe strukturën e partive. Ai lejon sistemin shumëpartiak të padisiplinuar, ashtu siç lejon edhe dypolarizimin, i cili mund të jetë edhe krijues i sistemit dypartiak, por që çon gjithmonë ose pothuajse gjithmonë në shumica të qarta dhe koherente, edhe pse shumë shpesh shumëpartizane. Përrjashtimet janë jashtëzakonisht të rralla, si për shembull rasti i zgjedhjeve legjislative franceze

të vitit 1988, të cilat i dhanë Partisë Socialiste vetëm një shumicë relative. Ky rezultat i çuditshëm të kujton atë britanik, rast po aq i habitshëm edhe ai, në zgjedhjet legislative të vitit 1974, bërë sipas sistemit mazhoritar njëmëror me një raund.

Këto *shumica* janë pothuajse gjithmonë të *përforcuara*, të *ekzagjeruara*, si ato të sistemit zgjedhor britanik me një raund. Shfaqen të njëjtat dukuri të *mbi-përfaqësimit* të shumicës dhe të *nën-përfaqësimit* të opozitës. Ato kanë të njëjtën rëndësi dhe të njëjtën natyrë, por ndërlikimet e multipartizmit dhe të situatave lokale dhe personale shkaktojnë efekte aq komplekse, sa i bëjnë të vështira verifikimet matematike, që janë absolutisht rigoroze. Megjithëkëtë, në zgjedhjet legislative të Republikës së V, edhe pse shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, u vu re në mënyrë të habitshme një analogji, madje një identitet i dukurisë në të gjitha vitet: 1958, 1962, 1967, 1968, 1973, 1978, 1981 dhe 1988, përjashto 1986, ku u bënë zgjedhjet me përfaqësim proporcional.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> Znj. Chantal Didier ka treguar në mënyrë krejtësisht bindëse dhe të qartë, në studimin e saj shumë të mirë, të titulluar “Mbi-përfaqësimi i shumicës në Francë dhe në Britaninë e Madhe. Studim i krahasuar mbi sistemet zgjedhore mazhoritare me një dhe dy raunde”: këto dukuri të mbi-përfaqësimit dhe të nën-përfaqësimit të sistemit zgjedhor francez janë shumë afër me ato të sistemit zgjedhor britanik. Llogaritjet e detajuara mbi to, madje, duket se janë më pak të theksuara në Francë. Llogaritjet që bëhen për zgjedhjet çojnë sigurisht në “raundin vendimtar”: raundi i parë në zonat ku zgjedhja është bërë pa nevojën e raundit të dytë, dhe raundi i dytë në të gjitha zonat e tjera, ku rezultatet janë mbledhur.

Në fakt, raundi i parë nuk shpreh vendimin e zgjedhësve kur do të duhet të mbahet një raund i dytë, por, megjithëkëtë, disa dëshira dhe orientime që përgatisin dhe thjeshtësojnë (përjashtimi i disa kandidatëve) përzgjedhjen në raundin vendimtar. Preferencat e raundit të parë përgatisin vendimet e të dytë, por zgjedhësit e marrin vendimin vetëm nëpërmjet raundit të dytë, në ato zona ku është e nevojshme.

Z. François Goguel duket se është i pari që ka përdorur termin “raund vendimtar”, të paktën sistematikisht në studimin e tij mbi zgjedhjet e përgjithshme franceze të vitit 1967, i publikuar nga FNSP, Paris. Ai me sa duket është krijuesi i termit që tregon këtë nocion.

C. – Pasojat e sistemit zgjedhor mazhoritar të listës (ose sistemi shumemëror) me një dhe me dy raunde.

Sistemi zgjedhor me listë mazhoritare u kërkon zgjedhësve të çdo zone të zgjedhin disa përfaqësues duke votuar për një listë kandidatësh. Kur ky votim është krejtësisht demokratik, ligji i jep zgjedhësit të drejtën e një përzgjedhjeje të lirë të listës së kandidatëve, për të cilët ai voton: ai mund të zgjedhë sipas dëshirës midis listave të ndryshme që paraqiten në zonën e tij. E thënë ndryshe, ai mund të përziejë kandidatët e listave të ndryshme, “përzierje” kjo që përbën një nga elementet themelorë të së drejtës natyrore të zgjedhësve për caktimin e fituesve.

Nëse përzierja është e ndaluar nga ligji zgjedhor, përzgjedhja, duke ikur gjerësisht prej zgjedhësve, kalon te partitë ose tek ata që janë në masë në krye të listave. I tillë ka qenë rasti i *zgjedhjeve bashkiake franceze* të viteve 1965, 1971 dhe 1977, ku sipas ligjit zgjedhor të 1964-ës ishte vendosur *një sistem zgjedhor me listë mazhoritare me dy raunde*, ku ndalohej përzierja, madje edhe shkrirja e listave të raundit të parë për raundin e dytë; ai anulonte praktikisht dobinë e raundit të parë duke u barazuar kështu me sistemin mazhoritar me një raund. Sistemi mazhoritar me listë pa përzierje, cilido që të jetë numri i raundeve të parashikuara, duket se çon në rezultate fare pak më të ndryshme se ato të sistemit të votimit njëmëror me një raund, ndonëse përdorimi i tij është tepër i rrallë dhe shumë i vonshëm për të lejuar konkluzione të padiskutueshme. Përkundrazi, sistemi i vërtetë me listë mazhoritare, i cili kërkon përzierje, mund të çojë në rezultate shumë interesante dhe tepër të larmishme.

*Sistemi i votimit me listë mazhoritare me një raund*, është, megjithatë, aq pa eksperiencë, saqë vetëm mund të merren me mend efektet e tij të favorshme për shumëllojshmërinë e tendencave të kandidatëve të secilës parti, të cilët shpresojnë kështu të tërheqin një klientelë më të rëndësishme. Ky sistem duhet të luajë rolin e krijuesit dhe ruajtësit të sistemit dypartiak, i cili i përket çdo sistemi mazhoritar me një raund, sipas mekanizmave të

përshkruara më parë. Zgjedhjet franceze të viteve 1848-1849 dhe 1871, të organizuara sipas këtij sistemi, janë të vetmet dhe tepër të vjetra për ta bërë këtë paraqitje të padiskutueshme.

Përkundrazi, *sistemi i votimit me listë mazhoritare me dy raunde* është përdorur në Francë për zgjedhjet legjislative më 1885, dhe pastaj në mënyrë të pandërprerë për zgjedhjet bashkiake që prej vitit 1884, me gjithë disa kufizime të rëndësishme bërë që prej vitit 1947 (në Republikën e IV i rezervohej komunave me më pak se 9 000 banorë, ndërsa në Republikën e V atyre me më pak se 120 000 banorë deri në vitin 1959, duke u rivendosur për komunat e tjera në vitin 1964, por duke ndaluar përzjerjen në komunat me më shumë se 30 000 banorë).<sup>6</sup> Rezultatet e këtij sistemi janë të njohura shumë mirë: ai krijon shumica shumëpartiake të qarta dhe shumë koherente. Partitë paraqesin lista të shumta në raundin e parë, por në raundin e dytë ato i rigrupojnë në dy ose tri lista të atij koalicioni ku forca të përafërta paraqesin një numër kandidatësh, i cili është në raport me votat që kanë marrë në raundin e parë. Madje ky rigrupim mund të bëhet që në raundin e parë në shumë zona, nga frika e fitores së kundërshtarëve më të bashkuar. Bashkimi i forcave politike në dy ose tri tendenca të mëdha duket se është i pashmangshëm në raundin e dytë. Partitë janë tepër të ndërgjegjshme për domosdoshmërinë dhe nevojën që kanë ato për njëra-tjetrën, saqë këmbëngulin gjithnjë e më tepër mbi përputhjet mes tyre, se sa mbi kundërshtitë. Shumicat kombëtare janë ndërtuar kështu me zgjedhës që janë të ndërgjegjshëm për pushtetin që kanë ato. Edhe vetë qeveria, në regjimet parlamentare, caktohet nga ky vullnet elektoral. E njëjta gjë ndodh edhe me programin e përbashkët të partive të bashkuara në lista të përbashkëta dhe të paraqitura prej tyre në shumicën e zonave, të paktën në raundin e dytë. Sistemi me listë mazhoritare me dy raunde duket se çon në rezultate tepër të afërta me sistemin njëemëror

<sup>6</sup> Dhe që prej vitit 1976 me ndalimin e paraqitjes në raundin e dytë të listave që nuk përmbajnë 12,5 % të të regjistruarve në raundin e dytë (ligji i 19 korrikut 1976).

me një raund, por me më tepër ngjyrimë dhe të goditura mirë: shumica koherente, të përforcuara dhe të ekzagjeruara, por që bashkojnë tendenca shumë të larmishme, proporcioni i të cilave është vendosur nga zgjedhësit. Për të shmangur një largim të madh të zgjedhësit prej kandidatit, një sistem votimi mazhoritar me një listë të vogël dhe me dy runde do të ishte i pëlqyeshëm në kuadrin e zonave që zgjedhin nga tre deri në pesë përfaqësues. Ky sistem do të jepte vërtet rezultate të kënaqshme për zgjedhjet legislative në Francë, mendojmë, me shumë vëzhgues kompetentë nga institucionet politike të vendit tonë.<sup>7</sup>

Cilatdo qofshin rezultatet, shpeshherë të shkëlqyera, të sistemeve mazhoritare, shumë vëzhgues ose politikanë denoncojnë padrejtësinë matematike të tyre, pasi ajo bën që shumicat të stërpërfaqësohen, duke disfavorizuar opozitën. Ata janë të pandjeshëm ndaj faktit që këto padrejtësi kompensohen me kalimin e kohës, që teknikat i moderojnë luftërat politike dhe lejojnë marrjen e vendimeve popullore të drejtpërdrejta e të qarta. Shumë prej tyre i qortojnë edhe këto moderime, pak të favorshme për formacionet dhe programet ekstremiste. Ata parapëlqejnë, kështu, përfaqësimin proporcional, drejtësia dhe efektet e të cilit janë më pak të kontestueshme se ato të votimit mazhoritar; *asnjë sistem votimi nuk është i përkryer*, dhe përzgjedhja duhet bërë në funksion të sistemit politik dhe të dhënave politike të çdo vendi.

---

<sup>7</sup> Për të eliminuar telashet që mund të dalin nga votimi mazhoritar njëemëror, pa adoptuar një votim me listë, është menduar një tjetër sistem: sistemi njëemëror me një raund me shumicë absolute, me votë preferenciale, i përdorur në Australi. Zgjedhësi voton për një kandidat të vetëm, por duke treguar menjëherë edhe kandidatin e dytë, të tretë etj. tek i cili mund të transferohet vota e tij në rast se nevojitet, domethënë nëse kandidati për të cilin ai voton, ose pasuesit e tij nuk janë zgjedhur me shumicë absolute. Sistemi i vendosur në vitin 1919 jep rezultate të afërta

## § 2. – PËRFAQËSIMI PROPORCIONAL

Sistemi me përfaqësim proporcional u shpik më shumë se një shekull më parë dhe, duke filluar nga fundi i shekullit të XIX u përfaqua në mënyrë progresive nga pothuajse të gjitha vendet e Europës perëndimore. Ishin vetëm Britania e Madhe dhe Franca vendet e kësaj pjese të botës që i rezistuan këtij sistemi. Përfaqësimi proporcional (më poshtë P.P.) ka si qëllim t'i sigurojë çdo liste dhe çdo partie një numër vendesh në proporcion me përqindjen e votimit të bërë për ta. Rezultatet e tij janë mjaft të kënaqshme në vendet e vogla dhe kryesisht në Zvicër dhe në Skandinavi, por ato kanë qenë të këqija dhe madje shkatërruese në tre vende të mëdha: Gjermaninë e Vajmarit nga viti 1918 deri më 1933, Italinë dhe Francën e viteve 1945-1956.

Zgjedhjet legjislativ franceze të vitit 1986 u bënë me P.P. nga listat, duke i dhënë të djathtës një shumicë bindëse. Një rezultat i tillë është po aq i rrallë sa mungesa e një shumice bindëse në rastin e sistemit të votimit mazhoritar me një dhe me dy raunde, siç është rasti i zgjedhjeve legjislativ franceze të vitit 1988. Në vitin 1986 zgjedhësit kishin ruajtur disiplinën e votimit të sistemit të mëparshëm mazhoritar.

Teknikat e sistemit të votimit me P.P. janë shumë të ndërlikuara. Kjo mangësi është, megjithatë, më e vogla krahas shumë të tjerave, të cilat ndoshta mund të jenë shumë të rrezikshme për regjimet politike dhe demokracinë, siç e ka treguar edhe studimi i bërë mbi pasojat e tij.

I – Teknika e përfaqësimit proporcional të listës.

Ndërlikimi i P.P. vjen si rezultat i vështirësisë së ndarjes së një numri të plotë vendesh midis listave dhe partive që kanë marrë përqindje votash të cilat variojnë pafundësisht. P.P. i përafërt nuk e zgjidh problemin në mënyrë të përkryer, por të arsyeshme. P.P. i plotë respekton drejtësinë matematike, duke i çoroditur zgjedhjet.

A.– Përfaqësimi proporcional i përafërt.

Kjo teknikë, që është më e përhapura, i ndan vendet në kuadrin e çdo zone fillimisht midis listave, pastaj midis kandidatëve të këtyre zonave.

1.– *Ndarja e vendeve midis listave*. Ky veprim bëhet në dy kohë:

a) *ndarja e vendeve sipas herësit elektoral*

Herësi elektoral është rezultati që del nga pjesëtimi i numrit të votave të shprehura në të gjitha zonat me numrin e vendeve që janë për t'u plotësuar. Kështu, ai është 25 000 kur numri i votave të shprehura është 125 000 dhe kur ka pesë vende për t'u plotësuar. Ndërsa me secilën listë veprohet kështu: supozojmë tre lista që kanë marrë rezultatet e mëposhtme, secilës i takon sipas herësit të marrë vendet si vijon:

Lista **A** ka 60 000 vota të shprehura, ku herësi hyn dy herë: 2 vende, mbetja = 10 000;

Lista **B** ka 46 000 vota të shprehura, ku herësi hyn 1 herë: 1 vend, mbetja = 21000;

Lista **C** ka 19 000 vota ta shprehura, ku herësi nuk hyn: 0 vende, mbetja = 19000.

b) *ndarja e vendeve jo sipas herësit*

Kjo ndarje mund të bëhet sipas dy metodave:

-*sistemi i mbetjes më të madhe* ia atribuon vendet e mbetura listave që kanë mbetjet më të mëdha të votave të papërdorura. Listat B dhe C marrin kështu vendin e tretë dhe të katërt;

-*sistemi me mesataren më të madhe* çon në rezultate analoge, por me më saktësi proporcionale. Vendet që nuk ndahen me herës i caktohen listave që kanë arritur mesataren më të madhe të zgjedhësve të paraqitur për çdo të zgjedhur. Secilës listë i caktohet në mënyrë fiktive vendi i parë i mbetur, pastaj llogaritet mesatarja e çdo liste, duke e pjesëtuar numrin e këtyre votave me numrin e vendeve caktuar sipas herësit, shtuar me një njësi, domethënë me këtë vend fiktiv. Vendi i jepet listës që arrin mesataren më të madhe. Në



të njëjtën mënyrë veprohet për secilën nga vendet e tjera, që nuk caktohen sipas herësit. Shembulli numerik i mësipërm jep kështu rezultatet si më poshtë:

Lista **A** 60 000 / 2 vendet e herësit + 1 = mesatarja prej 20 000 vota të shprehura për vend;

Lista **B** 46 000 / 1 vend të herësit + 1 = mesatarja prej 23 000 vota të shprehura për vend;

Lista **C** 19 000 / 0 vend të herësit + 1 = mesatarja prej 19 000 vota të shprehura për vend.

Vendi i katërt i jepet kështu listës B.

Mbetet për t'u caktuar edhe vendi i pestë. Procedohet në të njëjtën mënyrë, duke llogaritur përsëri mesataret e tre listave, pastaj i atribuohet secilës në mënyrë fiktive ky vend. Mjafton të ribëhet kjo mesatare vetëm për B-në: nëse i atribuohen 3 vende kësaj liste, dy ajo tashmë i ka, plus i fundit që mbetet për t'u plotësuar, mesatarja e B-së do të jetë 46 000, domethënë 15333. 3

Vendi i pestë duhet, pra, t'i jepet listës A, meqenëse mesatarja e saj është më e madhe: ajo është, në fakt, për tre vende, me 20 000 vota për vend, ndaj 15 333 të listës B (për 3 vende) dhe 19 000 për listën C (për një vend).

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në këtë zonë është pra, sipas sistemit të mesatares më të madhe, si vijon:

-lista A: 3 vende, nga të cilat 2 sipas herësit dhe 1 sipas mesatares;

-lista B: 2 vende, nga të cilat 1 sipas herësit dhe 1 sipas mesatares;

-lista C: asnjë vend, megjithë 19 000 votat e marra.

Rrjedhojat e kësaj metode ndryshojnë ndjeshëm nga ato të mbetjes më të madhe, sipas së cilës:

A-ja merr 2 vende, B-ja 2 vende dhe C-ja 1 vend.

Sistemi i *mesatares më të madhe* i jep një vend më shumë listës A dhe i heq vendin e vetëm listës C. Ky system *favorizon, në fakt, partitë e mëdha, ndërsa sistemi i mbetjes më të madhe duket se favorizon më tepër formacionet e vogla politike*. Ky shembull numerik nuk është një provë e

mjaftueshme e këtij pohimi, sepse, shpeshherë, rezultatet janë të njëjta, por ai jep një verifikim, konfirmuar pas një përvoje të gjatë dhe të vërtetuar me statistika.

Të dy sistemet janë të përafërt, pasi asnjëri prej tyre nuk lejon një proporcionalitet të prerë të vendeve dhe të votave. Megjithatë më i miri është proporcionaliteti që del nga sistemi i mesatares më të madhe.

*Mënyra të tjera të llogaritjes* së mesatares më të madhe japin po ato rezultate. Mund të eliminohet pikërisht etapa e parë, domethënë ajo e ndarjes së vendeve sipas herësit, duke ia atribuar vendin e parë listës që ka më shumë vota, pastaj të dytin asaj që ka mesataren më të madhe, dhe kështu me radhë deri në mbarimin e numrit të vendeve të zonës.

Së fundi, mund të përdoret metoda më e njohur, e quajtur *sistemi i Hondt-it*, sipas emrit të shpikësit të saj. Kjo metodë është e njohur edhe me emrin e pjesëtuesit elektoral, ose sistemi i herësit të përafërt. Rezultatet janë të njëjta me ato të sistemeve të mëparshme të llogaritjes: në qoftë se kemi  $N$  vende për zonën, pjesëtojmë numrin e votave të secilës listë me 1, 2, 3, etj., deri në pjesëtimin me  $N$ . Herësat e marrë renditen sipas radhës së zbritjes. Ai herës që zë vendin e  $N$ -të është herësi i përafërt. Ndarja e vendeve sipas mesatares më të madhe llogaritet menjëherë duke pjesëtuar numrin e votave të çdo liste me këtë herës elektoral të përafërt. Në praktikë duket se kjo metodë është më komode. Duke rimarrë shembullin e mësipërm, duhet të pjesëtojmë numrin e votave të marra nga secila listë me 1, 2, 3, 4, dhe 5. Do të kemi këto rezultate:

Lista A: 60 00030 00020 00015 00012 000;

Lista B: 46 00023 00015 33311 500 9 200;

Lista C: 19 000 9 500 6 333 4 750 3 800.

Duke i renditur pastaj këta herësa sipas radhës së zbritjes, shikojmë se 20 000 është i pesti. Pikërisht ky është herësi elektoral i përafërt. Po të vazhdojmë t'i pjesëtojmë votat e çdo liste me 20 000, do të marrim drejtpërdrejt rezultatet e mesatares më të madhe: A-ja merr 3 vende, B-ja 2 vende dhe

C-ja zero vende, ashtu siç u vu re edhe nga llogaritjet e bëra sipas metodës së parë.

Pasi i kemi ndarë vendet ndërmjet listave, duhet t' i shpërndajmë ato brenda secilës listë tani ndërmjet kandidatëve: ky është akti i dytë i kësaj loje të ndërlikuar.

## 2. – *Dhënia e vendeve kandidatëve të listave.*

Për të ndarë vendet midis kandidatëve përdoret një system shumë i thjeshtë kur lista është bllokuar ligjërisht nga ligji zgjedhor, dhe shumë më i ndërlikuar kur përzierja dhe vota preferenciale janë të autorizuara, ku vota preferenciale i lejon çdo zgjedhësi të tregojë preferencat e veta në mes shumë kandidatëve të listës së tij.

### a) *Sistemi i listave të bllokura nga ligji zgjedhor.*

Shpeshherë ligjet zgjedhore e ndalojnë përzierjen dhe votën preferenciale ose u vënë atyre kushte që i paralizojnë. Në këtë rast atribrimi i vendeve bëhet më lehtë. Kandidatët paraqiten në çdo listë sipas një radhe të caktuar, kështu që edhe vendet u jepen sipas kësaj radhe paraqitjeje. Nëse lista A përmban pesë emra për tre vende, do jenë tre kandidatët e parë që do marrin secili nga një vend. Zgjedhësit votojnë duke e ditur shumë mirë se vetëm kandidatët e parë të listës do të mund të zgjidhen, pasi asnjë listë nuk mund të marrë 100 % të votave: ata votojnë për listën në funksion vetëm të atyre kandidatëve që janë në krye, pasi nuk disponojnë të drejtën e ndryshimit të paraqitjes së listës.

### b) *Sistemet e përzierjes dhe votës preferenciale dhe bllokimi i listës.*

Megjithatë ekziston, të paktën teorikisht, një sistem i kundërt, sipas të cilit zgjedhësit, në sajë të votës preferenciale, mund të përziejnë kandidaët e listave të ndryshme, duke ndryshuar kështu radhën e paraqitjes së tyre në listat e hartuara prej partive. Por praktikisht është tepër e vështirë që të shmangësh bllokimin e listës. *Përdorimi i shkëputur i këtyre modaliteteve* i lejon shumë lehtë zgjedhësit e secilës parti ose të partive kundërshtarë të

shqetësojnë ose të eliminojnë personalitetet më të njohura, të cilët janë vënë në krye të listave, e thënë ndryshe, i lejon ata t'u presin kokat listave. Përdorimi i tyre i njëpasnjëshëm ose përdorimi vetëm i votës preferenciale neutralizon këto efekte të dëmshme, por duke i bllokuar listat *de facto*, pasi partitë nuk mungojnë të rekomandojnë zgjedhësit e tyre që të veprojnë në këtë drejtim. Duke qenë se shumica prej tyre zbaton këtë urdhër, mund të themi se listat bllokohen nga dëshira e partive ose e trupës zgjedhore. Rezultatet mashtruese ose absurde të këtyre shtesave të P.P. bëhen pengesë për t'u larguar këtij kufizimi të së drejtës së zgjedhësve, që aq mirë e respekton sistemi i votimit mazhoritar, gjë për të cilin është për të ardhur keq.

Ligjvënësi atëherë tenton të imponojë me ligj këtë bllokim. Për këtë ai bindet nga ndërlikimet e pazgjidhshme që krijohen gjatë numërimit të votave, përzjerjes dhe votës preferenciale. Në ligj mund të mbeten vetëm disa modalitete shumë zbutëse të këtyre të ashtuquajturave liri, efektet e të cilave shpesh janë shumë të vogla. Me këtë bllokim të listave mund të krahasohet ndalimi i zgjedhjeve të pjesshme.

c) Ndalimi i zgjedhjeve të pjesshme.

Kjo është një tjetër pasojë jo e mirë e P.P. Zgjedhjet e pjesshme, që bëhen gjatë legjislaturës me qëllim zëvendësimin e atyre që vdesin ose japin dorëheqjen, do të mund të bëheshin sipas sistemit të votimit njëemëror, pra mazhoritar. Këto votime, që mund të prishnin proporcionalitetin e përfaqësimit, shpesh ndalohen nga ligji zgjedhor: *zëvendësimi bëhet nga kandidati i parë i listës që nuk ka fituar*. Për këtë qëllim ligji zgjedhor kërkon pothuajse gjithmonë që listat të jenë të plotësuara, domethënë ata të përmbajnë aq emra sa janë vendet për t'u plotësuar.

Bllokimi i listave dhe ndalimi i zgjedhjeve të pjesshme janë, megjithatë, difekte të vogla të P.P. në formën e tij të përafërt, krahasuar me disa të tilla të rrezikshme të P.P. të plotë.

### B.– Përfaqësimi proporcional i plotë

Mospërputhjet midis përqindjeve të vendeve dhe votave të marra nga partitë me P.P. të përafërt janë shumë të mëdha në zona, por shumë të vogla në nivel kombëtar (zakonisht 2 % e totalit të votave kombëtare të shprehura, rrallëherë më shumë dhe shpeshherë më pak, në dobi të partive të mëdha ose partive fituese). Këto luhatje janë madje pa rëndësi në krahasim me atë të sistemit mazhoritar. Megjithatë ato u duken të patolerueshme partizanëve të P.P. të plotë, teknika e të cilit në parim është e thjeshtë.

Vendi i ndarë në zona zgjedh fillimisht një pjesë të deputetëve të vet, pjesën më të madhe, sipas herësit për secilën prej tyre. “Herësi kombëtar i përafërt” (afërsisht i emërtuar “numër i njëtrajtshëm” ose “numër i vetëm”) është i ndryshëm nga herësi i P.P. së përafërt, por ai luan të njëjtin rol, sipas të njëjtës teknikë. Normalisht ai është i fiksuar paraprakisht, sipas numrit që mendohet se do të kenë votat e shprehura në tërësi në të gjithë vendin (i nxjerrë ky nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit) dhe numrit të vendeve që duhen plotësuar (50 000 për 30 milion vota të shprehura dhe për 600 vende).

Mbetjet e papërdorura në zona shtohen pastaj nga çdo parti në nivel kombëtar: atëherë i jepen secilit aq vende sa herë hyn herësi në këto mbetje.

Vendet në zona u jepen kandidatëve të secilës listë sipas sistemit të P.P. të përafërt. Përkundrazi, në nivel kombëtar, ato u jepen, prej partive, kandidatëve nga listat e tyre kombëtare, ose, kandidatëve të tyre humbës të zonave sipas radhës së humbjes, domethënë sipas përqindjes së marrë.

Madje mund të organizohet një votim mazhoritar njëemëror me një raund nëpër zona për zgjedhjen e një pjese të deputetëve, të gjysmës ose diçka më shumë a më pak se gjysma, ndërsa mbetjet kombëtare sigurojnë zgjedhjen e deputetëve të tjerë sipas radhës së humbjes së kandidatëve të secilës parti. Ky sistem, i njohur me emrin “*Sistemi Adler, Leon Blum, Etienne Weill-Raynal*”, sipas emrit të autorëve të tij dhe të mbrojtësve të tij të parë, është kështu në Francë nga Partia Socialiste në programin e saj të publikuar në vitin 1972. Ndoshta ajo nuk i ka kuptuar plotësisht rreziqet e mëdha të P.P. të

plotë, edhe pse përgjithësisht sistemi i këshilluar prej kësaj partie paraqet epërsi të pakundërshtueshme mbi format e zakonshme të këtij votimi

*Rreziqet tepër të mëdha të P.P. të plotë*, janë aq serioze, saqë edhe partizanët e rrallë të tij kërkojnë t'i zbusin me dispozita, të cilat përfundojnë në shkatërrimin e karakterit të plotë të proporcionalitetit të tij. *Dhënia e vendeve kombëtare, nga shtabet e partive*, kandidatëve të listave hartuar prej tyre, është rreziku i parë: kështu një numër i madh të zgjedhurish janë caktuar sipas dëshirës së partisë dhe jo nga populli. Edhe pse kandidatët renditen sipas përqindjes së marrë në zona, vendet e tyre në listat zonale normalisht janë caktuar nga udhëheqja kombëtare e partisë si në çdo sistem të P.P. të listës, por me një mënyrë shumë më të theksuar sesa P.P. i përafërt. Vetëm sistemi Blum-Well-Raynal do të lejonte të luftohej më gjerësisht kundër këtij dominimi të krerëve të partive, prandaj dhe nuk është konsideruar shumë i përshtatshëm prej këtyre të fundit: ky është një sistem hibrid, edhe pse shumë proporcional.

E keqja e dytë e P.P. të plotë është akoma më e rëndë: *shumëzimi pothuaj pa limit i partive politike*, frut i të cilit është, bën të shpërthejë përfaqësimi kombëtar, duke ndaluar çdo konstituim të shumicës. Grupimet më pa rëndësi, më të çuditshme, më të sajuara dhe më shqetësuese për paqen publike, mund të bashkojnë një ose dy herësa kombëtarë për të fituar një ose dy vende, ngaqë edhe me votimin mazhoritar, këta lloj kandidatësh, i bashkojnë votat. Shuma e këtyre të zgjedhurve të ultrapakicës dhe atyre nga partitë e shumta të vogla, të cilat shtohen në këtë klimë, mjafton për ta ndarë parlamentin në mënyrë të pandreqshme.

Mund të përpiqemi të luftojmë kundër këtij rreziku të madh duke u ndaluar çdo përfaqësim partive që nuk marrin një përqindje të caktuar ose disa vende sipas herësit, ose që duke mos paraqitur një numër të mjaftueshëm kandidatësh, kërkojnë garanci të parimbursueshme mbi një përqindje votash. Por të gjitha këto lehtësira ose janë të paoperueshme ose shkatërruese për P.P. e plotë, i ulur kështu në nivelin e proporcionalit të përafërt, të cilin e akuzon si të pamjaftueshëm.

Si përmbledhje, P.P. i plotë duhet të pranohet me gjithë mangësitë e tij, ose të refuzohet në dobi të P.P. të përafërt. Pranimi i tij normalisht sjell pasoja katastrofike, të tilla si në Gjermaninë e Vajmarit të viteve 1920 deri 1933, ku ai qe një nga shkaqet përcaktuese të ardhjes në fuqi të nazizmit. Projektushtetuta e parë e 19 prillit 1946 u shoqërua me një ligj zgjedhor, i cili vendosi P.P. e plotë: populli francez, fatmirësisht, i refuzoi si njërin dhe tjetrin, nëpërmjet referendumit të vitit 1946. Të këqijat e P.P. të plotë shfaqen, përveç kësaj, në gjithë sistemin e P.P. të listës. Nëse ato janë shumë më pak shqetësuese në kuadrin e P.P. të përafërt, efektet e tyre mbesin, megjithatë, të rrezikshme. Prandaj një diskutim i gjallë vë përballë njëri-tjetrit partizanët dhe kundërshtarët e përfaqësimit proporcional, për sa i përket pasojave të tij që prej fundit të shekullit XIX.

## II. – PASOJAT E PËRFAQËSIMIT PROPORCIONAL TË LISTËS.

Përparësitë e sistemit të P.P. janë të dukshme: *drejtësia matematike e rezultateve* është e verifikueshme menjëherë, cilado që të jetë teknika e përdorur. Madje edhe në nivel zonash, forcat e ndryshme të pranishme, paraqiten me paanësi. Në nivel kombëtar, proporcionaliteti i përfaqësimit të partive është pothuajse i përkryer, afër 1 ose 2 % në tërësi. Ekzagjerimi i shumicave dhe nënpërfaqësimi i pakicave, të dala nga votimet me sistem mazhoritar, këtu janë hequr; pikërisht ky është qëllimi primar i P.P. Më në fund, këto efekte vijnë si rezultat i asaj që zgjedhësit votojnë për ato tendenca që u pëlqejnë më shumë.

Këto efekte përfituese të P.P. duken se janë të konsiderueshme. Megjithatë, ato shpesh humbasin, ngaqë të metat e proporcionalit janë aq të shumta, madje edhe në ato vende ku duket se ky sistem funksionon mirë. Në fakt, P.P vepron në një mënyrë përcaktuese mbi numrin dhe strukturën e formacioneve politike: ai çon domosdoshmërisht në *shumëzimin e partive*, duke i dhënë secilës prej tyre *një strukturë monolitike, jashtëzakonisht të hierarkizuar dhe të disiplinuar* nën autoritetin e e drejtuesve të tyre

kombëtarë, edhe kur këta janë të zgjedhur demokratikisht. Teknika e P.P. të përafërt ose të plotë është shkaku thelbësor i këtij fenomeni, i cili i vë të zgjedhurit në varësinë e shefave të partive në mënyrë autoritare dhe shumë të tepruar.

Kjo disiplinë e brendshme, jashtëzakonisht e prerë dhe e rëndë, është *pasojë e sistemit të listave, ligjërisht ose faktikisht të bllokuara në mënyrë të pashmangshme*. Zgjedhja e parlamentarëve, në fakt, rezulton si nga radha e tyre në listë, ashtu edhe nga zgjedhësit, sepse vetëm kandidatët në vendet e para të listës mund të zgjidhen, gjithmonë në proporcion me votat e marra nga s objekt.

Kur një parti, në një zonë, disponon një përqindje të mirë dhe që jetëgjatë, zgjedhja e kandidatit varet vetëm nga vendimi i drejtuesve të partisë, të cilët e vënë atë në një vend të mirë në listë. Këtu zgjedhësit nuk caktojnë fituesit, por vetëm një parti, një program, por asnjë person. *I zgjedhuri nuk është gjë tjetër veçse një krijesë e partisë, nga e cila varet rizgjedhja e tij*: në qoftë se ai e dëshiron këtë, ai duhet të jetë shembulli i urtësisë para drejtuesve kombëtarë të partisë gjatë gjithë kohës së mandatit të tij. Çdo shkelje serioze e disiplinës së partisë, rrezikon ta çojë të zgjedhurin e pabindur në marrjen e ndonjë sanksioni të rëndë dhe në mosrizgjedhjen e tij, për shkak të uljes më poshtë në vendet e listës së kandidatëve të zonës së tij. Monolizmi i partive dhe i grupeve parlamentare është aq i madh, sa parlamenti humbet një pjesë të madhe, dhe madje thelbin e rolit të tij, në dobi të drejtuesve të këtyre formacioneve: parlamenti bëhet kështu i padobishëm.

Përveç kësaj, presioni mbi të zgjedhurit është aq i fortë, saqë inkurajohen fort përçarjet nga tendenca të brendshme të pakicës. *Pra P.P. sjell kështu edhe ndarjen dhe shumëzimin e partive, e cila është e pakufizuar në P.P. e plotë*. Ndërsa në P.P. e përafërt ajo është e kufizuar nga nevoja e secilës parti për të marrë të paktën herësin në disa zona, me qëllim që të ruajë përfaqësimin parlamentar. Megjithëkëtë, monolizmi i disa partive mund të pakësohet nga larmia e tendencave të tyre të brendshme, që vijnë si rezultat i dimensioneve të tyre, të ndryshimeve rajonale dhe të natyrës federale të shtetit, siç mund ta



vërtetojnë partitë zviceriane, gjermane dhe italiane. Por monolitizmi mund edhe të zhvendoset në nivelin e çdo tendence të partisë, si ka treguar sistemi italian.

Këto pasoja të pashmangshme të P.P. të listës mund të konsiderohen përfituese ose shkatërruese, sipas ideve që shfaqen lidhur me pavarësinë e personit, përfshirë këtu edhe personin e parlamentarëve, me lirinë e shprehjes së opinionëve dhe me organizimin e brendshëm të sistemeve politike. Megjithatë për shumicën e vëzhguesve dhe për vetë ne, këto rezultate janë shumë të dëmshme në vende të caktuara, dhe *ulja e Parlamentit*, që vjen prej tyre, është vështirë të krahasohet me funksionimin e institucioneve (Republika e IV Franceze, Italia etj.). Përveç kësaj, prej të metave të mësipërme të P.P. dalin edhe të tjera.

Drejtësia matematike e përfaqësimit të opinionit është reale deri në momentin që ndarjet e tij nuk janë shumë të theksuara, por të përmbajtura. Sapo kjo teprohet, *P.P. deformon rrezikshëm opinionin*. Mjafton për këtë që kriza të rënda të lëkundin vendin ose që ekstremizma të fuqishëm ta bëjnë të pasigurtë unitetin e kombit. Partitë theksojnë ndarjet e tyre, duke i ushqyer ato me vështirësitë e kohës: asnjë parti nuk ka nevojë për të tjerat, pasi koalicionet janë pa interes zgjedhor, secili nënvizon me forcë divergjencat me më të afërtit, të cilit ai mund dhe dëshiron t'i marrë klientelën.

*Formimi i opinionit bëhet kështu i pamundur: ai paralizohet, pasi çdo shumicë kombëtare është e ndaluar nga mënyra e votimit.* Ndarjet artificiale të partive shkatërrojnë madje çdo ndërtim të mëparshëm të këtij lloji dhe çdo përpjekje për t'iu rikthyer atij. P.P., i cili në parim duhet të lejojë të fotografohet opinionin, paraqet një figurë të turbullt: re, moçale dhe xhungla. Në gjirin e këtij mjegullimi, shkëmbimet, kompromiset dhe kapërcimet e nevojshme për përkufizimin e interesit të përgjithshëm kërkojnë shumë mund ose janë fare të pamundura. **Sistemi i votimit mazhoritar vepron, ai proporcional paralizon.** <sup>8</sup>

<sup>8</sup> Nicolas Denis, "Kundër përfaqësimit proporcional", artikull i botuar në revistën e përmuajshme Appel, nr.42, janar 1978, f.11-15.

Mungesa e shumicës i *bën qeveritë të paqëndrueshme* ose politikat e tyre të palëvizshme, ose i bashkon të dyja këto të këqija. Në sistemet parlamentare ose gjysëmparlamentare (Republika e III dhe e IV franceze) paqëndrueshmëria qeverisëse, e dalë nga P.P. sjell rreziqe shumë të mëdha, shembuj të cilave sjellin me shumicë Franca e viteve 1945 deri 1958, Gjermania e Vajmarit dhe Italia. P.P., i cili i pushton progresivisht të gjitha organet e shtetit, ndalon marrjen e vendimeve dhe i fundos pushtetet në një ngujim politik. Mospranimi i veprimt dhe amullia vendosen për një kohë të gjatë. Zgjedhjet me proporcional i mbajnë gjallë këto situata, pasi votimet e njëpasnjëshme japin gjithmonë *rezultate pothuajse të njëjta*. Të njëjtat koalicione jetëshkurtra, por që rifillojnë pa pushim, të njëjtat parti që e mbajnë pushtetin të paralizuar.

Kjo situatë vazhdon *deri në shpërthimin* që provokon prishja e zakoneve rutinë e *zgjedhësve që bëhen gjithmonë e më shumë armiqësorë me këtë pushtet*. Kjo prishje vjen nga shkaqe të jashtme (kriza ekonomike ose ndërkombëtare) ose të brendshme (vështirësi më turbullira sociale): *atëherë lëvizje pasionante rrëmbejnë zgjedhësit, të cilët P.P. i favorizon për mrekulli*, dhe nuk ka më asnjë pengesë të ndalojë shpërthimet e vrullshme dhe dalldisjet e opinionit të shthurur. Franca e Republikës së IV, Gjermania që nga vitet 1920 deri 1933 e fundosur deri në ekstrem, dhe Italia e këtyre viteve, i tregojnë fare qartë këto pasoja të P.P.: tre regjime politike që vuajnë nga ekstremizma të fuqishëm.

*Rezultatet e mira të P.P. në Europën veriore dhe në Zvicër* flasin për kushtet dhe kufizimet e përdorimit të tij. Ai ka sukses në vendet me përmasa të vogla dhe me një traditë të gjatë në demokraci, me një shkallë të lartë zhvillimi dhe me zgjidhje të perfeksionuara të problemeve të tyre sociale, që nuk kanë njohur *asnjë formë ekstremizmi*, përveçse në përmasa të papërfillshme të ndonjë përgjegjësie ndërkombëtare me rëndësi. Këto vende mund të japin qeveri të koalicioneve të gjëra (Zvicra), ose qeveri më të ngushta, madje “minoritare”, por që mbështeten gjerësisht nga parlamenti

(raste të shpeshta në Skandinavi). Ata madje kanë bërë edhe pa qeverinë për një periudhë të gjatë kohe, siç e kanë treguar krizat e gjata ministrore hollandeze ose belge. Sa më e papërgjegjshme të jetë qeveria, aq më mirë duket se funksionon P.P.; i tillë duket të jetë mësimi i qeverisë drejtuese zviceriane që përfaqësonte 80% të parlamentit dhe 80% të trupës zgjedhore. *Jashtë këtyre kufinjve, përdorimi i P.P. të listës është shumë i rrezikshëm.* Nuk është e sigurt se P.P. pa lista, i përdorur në Irlandë, është i mbyllur brenda kufinjve të saj. Edhe pse është i panjohur në Europën kontinentale, përparësitë e tij të shquara imponojnë paraqitjen në të njëjtin rang me P.P. të listës.

### III.–PËRFAQËSIMI PROPORCIONAL PA LISTË OSE PËRFAQËSIMI PROPORCIONAL IRLANDEZ.

Kjo mënyrë votimi, e përdorur në Republikën e Irlandës që nga krijimi i saj para një gjysëm shekulli dhe në Australi për zgjedhjen e Dhomës së Dytë të saj, Senatit Federal, që prej vitit 1949, duket se po jep rezultate më të mira se P.P. i listës. Megjithatë ai është një përfaqësim proporcional i vërtetë, po aq i saktë sa përfaqësimi proporcional i përafërt, por Europa kontinentale, në mënyrë paradoksale, njih vetëm këtë të fundit. Ky sistem, *vota e vetme e transferueshme (single transferable vote)* dhe sistemi i *Hare-it*, i cili e shpiku atë në vitin 1857, dhe që liberalët donin ta institucionalizonin në Britaninë e Madhe, është shumë i ndërlikuar si për sa i përket modaliteteve të tij, ashtu edhe për sa i përket rregullave të numërimit të votave, por që funksionon, megjithatë, në mënyrë të përkryer.

Çdo zgjedhës disponon *një votë të vetme* që ia jep një kandidati në kuadrin e zonës me minimumi tre vende, por ai tregon gjithashtu *shumë preferenca në renditjen në zbritje për kandidatë të tjerë, njërit prej të cilëve i transferohet vota e tij e vetme*, në qoftë se ai ia ka dhënë në radhë të parë një kandidati që ka shumë ose jo mjaft. Zgjidhen ata kandidatë që marrin kështu një numër votash të barabartë ose më të lartë se *herësi* i domosdoshëm

për t'u zgjedhur (herësi që del nga pjestimi i votave të shprehura me numrin e vendeve për t'u plotësuar plus një). Kandidatët dhe partitë e tyre, duke pasur nevojë absolute për preferencat e tjera, përveç të parave, të zgjedhësve të partive të afërta, detyrohen të merren vesh, të theksojnë të përbashkëtat e tyre dhe të ndërtojnë shumica dhe programe qeverisëse, të cilat ata ua propozojnë opinionit para votimeve. Si pasojë, partitë ekstremiste janë krejtësisht të pafavorizuara, gjë që është e kundërta e situatës së tyre në sistemin e përfaqësimit proporcional të listës. Ky përfaqësim proporcional pa lista, po aq i vërtetë dhe autentik sa ai me lista, nuk i ka ato difekte të mëdha të këtij të fundit. Vërtet që ai çon në sistem shumëpartiak, por kjo sigurisht që bëhet në mënyrë të zbutur dhe duke përjashtuar, të paktën në Irlandë, çdo formë të rëndësishme ekstremizmi. Së fundi, ndryshe nga P.P. i listës, ai *heq çdo bllokim të listave si* edhe të gjitha pasojat aq katastrofike që vijnë prej këtij bllokimi, përderisa nuk ekziston asnjë listë, çdo njeri mund të paraqitet individualisht, pa urdhër dhe pa u shtirë në prezantimin e kandidatëve të një ane; kështu ky përfaqësim grumbullon të gjitha përparësitë e përzierjes si në sistemin e votimit mazhoritar dhe ato të votës preferenciale, duke shmangur të gjitha të metat e përfaqësimit proporcional në këto fusha.

Të çudit fakti se ky sistem është pothuajse i panjohur në Europën kontinentale. Atë e njohin vetëm vendet anglo-saksone që e kanë shpikur, por që nuk e praktikojnë, megjithëse pakicat e kërkojnë një gjë të tillë. Irlanda dhe Australia, si dhe disa shtete të federatës australiane janë pothuaj të vetmit që e përdorin. Ai u vendos në zgjedhjet e Asamblesë së vetme të parlamentit të Irlandës së Veriut në vitin 1973 nga Northern Ireland Constitution Act, adoptuar në të njëjtin vit nga parlamenti britanik. Megjithatë ky përfaqësim proporcional është lehtësisht i përdorshëm edhe gjetiu. Përdorimi i tij nga vende të Europës që sot kanë sistemin e P.P. të listës, do të përmirësonte pa dyshim në mënyrë të konsiderueshme sistemet politike dhe zgjidhjen e problemeve të tyre institucionale (pikërisht në Itali, Hollandë dhe Belgjikë).

Megjithatë askush nuk e parashikon këtë.<sup>9</sup> Në fakt telashet e mëdha që vijnë nga P.P. i listës janë luftuar në shumë vende, duke përzier përfaqësimin proporcional me sistemet mazhoritare, nëpërmjet teknikave që janë jashtëzakonisht të shumta.

### § 3. – SISTEMET ZGJEDHORE TË PËRZIERA OSE HIBRIDE: KTHIMI I P.P. NË PËRFAQËSIM MAZHORITAR

Sistemet zgjedhore hibride mund të shtohen pafundësisht, pasi ato mbështeten në dozime të ndryshme të P.P. dhe të sistemit mazhoritar të votimit, si dhe mbi shumë mendjemprehtësi të tjera, të cilat sigurojnë pak a shumë mirë homogjenitetin e përzierjes. Megjithatë dalin disa tipe të mëdha, disa prej të cilëve janë të thjeshtë dhe të tjerë tepër të ndërlikuar. Shumica janë shumë të njohur, kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në shumë vende, sidomos në Francë dhe në Gjermani.

I. – Ndërmjet *përzierjeve të thjeshta*, mund të citojmë dy sisteme elementare: *P.P. të pasaktë*, i mazhorizuar nga zvogëlimi në tre ose katër i numrit të vendeve të çdo zone, gjë që favorizon partitë e mëdha, duke u dhënë një shpërbllim mazhoritar dhe sistemin që mbështetet *mbi ndarjen e vendit në zona mazhoritare dhe zona proporcionale* me dozimeve të ndryshme, të cilat krijojnë dy kategori zgjedhësish dhe të zgjedhurish. Këto dy sisteme mund të kombinohen me shumë teknika zgjedhore që janë paraqitur këtu.

*Sistemi me listë mazhoritare me një raund, i transformuar në P.P. kur shumica absolute nuk është arritur nga asnjë listë*, përbën një përzierje të thjeshtë më të përpunuar, efektet e së cilës mund të jenë të shkëlqyera. Një numër i madh partish janë kështu të detyruara të merren vesh për të hartuar lista koalicionesh, me të cilat mund të arrihet një shumicë absolute:

---

<sup>9</sup> Mbi përfaqësimin proporcional irlandez shih artikullin tonë të publikuar në Les cahiers du droit, revue des jurists catholiques nr.23, tremujori i katërt 1950, f. 111.

ato janë pra të detyruara të ndërtojnë bashkarisht programe të shumicës dhe programe qeverisëse. Më në fund zgjedhësit votojnë **utile**. Ky lloj votimi u përdor në Francë për zgjedhjet e viteve 1919 dhe 1924 (*ligji zgjedhor i 12 korrikut 1919*) me tre modalitete plotësuese: listat e paplota, kandidaturat individuale dhe përzierjet ishin krejtësisht të lira dhe mbi të gjitha, vendet që nuk atribuoheshin sipas herësit, i jepeshin asaj liste që merrte numrin më të madh të votave, domethënë shumicës relative, ndërsa asnjë listë nuk merrte shumicë absolute, duke e shndërruar sistemin, në mënyrë tepër të ndjeshme, në mazhoritar. Ky sistem i detyronte partitë dhe zgjedhësit të votonin sikur ishin në raundin e dytë të sistemit me listë mazhoritare me dy raunde, dhe efektet, pa dyshim që nuk do të kishin ndonjë ndryshim të madh. Ai krijon shumica shumëpartiake të qarta dhe koherente, ashtu si ndodhi në vitet 1919 dhe 1924: ai i detyron partitë të merren vesh, madje të zvogëlojnë progresivisht numrin e tyre. Kushtetuta e vitit 1875, e cila paralizonte të drejtën e shkrirjes, nuk linte mundësi që të ishin jetëgjata dhe frytdhënëse ato shumica të ndërtuara me vullnetin e pakundërshtueshëm të trupës elektorale më 1919 dhe 1924. Megjithatë, ai ishte një nga sistemet më të mira të votimit francez.

II. – *Përzierjet komplekse* të sistemit të votimit mazhoritar dhe sistemit të përfaqësimit proporcional janë normalisht më afër këtij të fundit, të paktën dy sistemet kryesore të këtij lloji: sistemi francez i vitit 1951 deri në vitin 1956 dhe ai gjerman i RFGJ i vendosur në vitin 1949 dhe i ruajtur që atëherë, me të cilin mund të krahasojmë sistemet Adler, Blum, Weill-Raynal, të përshkruara më parë.

A.– *Sistemi i bashkimit (aleancave)* mund të funksionojë në kuadrin e P.P., i cili krijon paksa shumicë, ose në kuadrin e sistemit me listë mazhoritare me një raund me përfaqësimin proporcional me shumicë absolute të paraqitur më lart.

*Përfaqësimi proporcional i përafërt me bashkime*, mbështetet në një parim të thjeshtë: listat e bashkuara konsiderohen si një e vetme për ndarjen

e vendeve ndërmjet listave. Pastaj, mbledhja e votave të aleancës u lejon atyre të marrin më shumë vende nga herësi, nga mesatarja e lartë dhe nga mbetja e madhe sesa listat e tjera. Pas kësaj ndarjeje të parë, vendet e aleancës ndahen mes listave përbërëse të saj, sipas teknikës së mesatares më të lartë ose të mbetjes më të madhe.

*Votimi me listë mazhoritare me një raund me P.P. në mungesë të shumicës absolute dhe të aleancave* (sistemi francez i vitit 1951 dhe 1956) e bën shumë më tepër mazhoritar sistemin, pasi çdo bashkim që përmbledh shumicën absolute të votave të shprehura fiton të gjitha vendet, të cilat pastaj ndahen me P.P. (sipas mesatares më të madhe më 1951 dhe 1956 në Francë) midis listave të bashkuara. Nëse asnjë listë apo bashkim nuk merr shumicën absolute, të dyja ndarjet bëhen me P.P.

Të dyja teknikat e aleancave i favorizojnë aq shumë listat e bashkuara, saqë ato arrijnë të marrin një përqindje të rëndësishme të votave. Si njëra, ashtu edhe tjetra, çojnë në *rezultate shumë të diskutueshme dhe ndonjëherë jashtëzakonisht të çuditshme*. Ato mundësojnë që lista të bashkuara në aleancë të marrin shumë vende me më pak vota se të tjerat dhe, madje, në sistemin e dytë, shumë lista me përqindje të vogël votash të marrin të gjitha vendet që u zbriten kështu listave që nuk janë të bashkuara në aleancë e që janë ndoshta më të rëndësishme (kështu ndodhi në vitin 1951, pikërisht në zonën e Lilës, e cituar shpeshherë). Rezultatet e kësaj mënyre votimi janë, pra, *thellësisht të padrejta*, meqenëse janë *mohim i përbashkët i përfaqësimit proporcional dhe votimit mazhoritar*.

Madje ato u *denoncuan si skandaloze prej* atyre që i synonin në vitin 1951: *Grumbullimi i Popullit Francez* (RPF), partia e gjeneralit De Gol dhe partia komuniste, të cilat rrezikonin të merrnin secila pak më shumë se 25 % të votave, e si pasojë, t'i zinin vendet me mënyrën e votimit të vitit 1946. Këto dy parti do të kishin qenë kështu në gjendje të mos i lejonin partitë e qendrës, të ashtuquajtura “forca e tretë” e që përbëheshin nga të gjitha partitë e tjera, që nga socialistët deri te të pavarurit, së bashku me

radikalët dhe Lëvizjen Republikane Popullore (MRP), të formonin një qeveri pa ata ose të paktën pa golistët, meqenëse askush nuk pranoi të përfshinte komunistët në shumicë. Qëllimi i nisur u arrit efektivisht në vitin 1951: Golistët, me mënyrën e votimit të 1946-ës, me P.P. të përafërt të thjeshtë, do mund të detyronin forcën e tretë të krijonte, bashkë me ta, një shumicë të re, të reformonte regjimin dhe të rivendoste në pushtet gjeneralin De Gol. *Golistët dhe kryetari i tyre nuk ia kanë falur kurrë partive të forcës së tretë këtë: ky ishte një nga çelësat kryesorë të jetës politike franceze që prej vitit 1951.*

Pasojat e mënyrës së votimit të viteve 1951 dhe 1956 pasqyrojnë efektet e rëndësishme që kanë sistemet zgjedhore në jetën politike dhe në sistemet politike të një vendi. Ky sistem i lejoi partitë e qendrës që ta ruanin shumicën deri në vitin 1958. Përligjja, që partizanët e tij e bazuan në nevojën e shpëtimit të regjimit dhe krijimit për këtë qëllim të një shumice, nuk qe asnjëherë bindëse për rrethanat e kohës. Ndryshe mund të ishte *për vendet ku demokracia dhe liria kërcënohen drejtpërdrejt*. Përveç kësaj, sistemi në Francë nuk lejonte krijimin e shumicave të vërteta të forcës së tretë: partitë e bashkuara, kontradiktat në mes të të cilave ishin të mëdha, merreshin vesh vetëm për të fituar maksimumin e vendeve, falë rregullave llogaritëse të rezultateve, por pa qenë të detyruara të krijojnë një shumicë koherente dhe një program qeverisës jetëgjatë. Është e vërtetë që kushtetuta, si në Republikën e III, paralizonte gjithashtu të drejtën për shpërbërje, duke ia nënshtuar këtë mocionit të mosbesimit në Asamblenë Kombëtare, me të cilin mund të ndodhë që kjo e fundit të përmbysë edhe qeverinë (neni 40 deri 52 i Kushtetutës së vitit 1946).

B. – *Sistemi zgjedhor gjerman*, i vendour në Republikën Federale Gjermane në vitin 1949, përbën, përkundrazi, një nga sistemet hibride më të mira. Njohja e tij është e domosdoshme për mirëkuptimin e atij sistemi politik demokratik të shkëlqyer, të cilit i është kushtuar Gjermania prej më shumë



se tridhjetë vitesh. Ai mund të përmbliidhet kështu: *gjysma e deputetëve të dhomës së parë, Bundestagut, (dhoma më e rëndësishme që përfaqëson popullin, e zgjedhur kjo me votim universal të drejtpërdrejtë), zgjidhet me sistemin e votimit njëëmëror me një raund të tipit britanik, por tërësia e vendeve ndahet sipas P.P. nga listat e përfaqësuar me mesatare më të madhe.* E thënë ndryshe, 496 vendet ndahen me P.P., por 248 deputetë janë zgjedhur me votimin njëëmëror me një raund. Megjithatë, partitë kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjet e vendeve me P.P. vetëm nëse ato marrin një minimum prej 5% të votave në të gjithë vendin, domethënë në gjithë territorin e federatës, ose tre vende në sistemin mazhoritar në gjithë RFGJ gjithashtu. Përndryshe, çdo vend i P.P. u refuzohet në të gjitha zonat.<sup>10</sup>

Vendi ndahet në dy lloje zonash: zonat e vogla të votimit mazhoritar njëëmëror me një raund dhe zonat e mëdha të P.P. që ka brenda të voglat. Pra janë të njëjtët zgjedhës që votojnë si në njërën dhe në tjetrën zonë. Zonat e mëdha përfshijnë një numër shumë të madh zonash të vogla të votimit njëëmëror dhe janë më të vogla në numër: ato janë dhjetë landet me dimensione të ndryshme.

*Zgjedhësit votojnë njëkohësisht dy herë për të dyja llojet e zonave në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Ata votojnë duke futur në kuti një fletë votimi ku zgjedhin një deputet sipas sistemit njëëmëror me një raund në kuadrin e zonës së vogël, dhe një fletë të dytë votimi për një listë kandidatësh në kuadrin e zonës me sistem P.P. me mesataren më të lartë.*

---

<sup>10</sup> Sistemi Adler-Blum-Weill-Raynal i paraqitur më sipër ngjan me sistemin gjerman. Megjithatë, ai ndryshon prej tij në disa pika thelbësore. Ndërsa i pari është një P.P. i plotë, P.P. i përfaqësuar gjerman luan vetëm në nivel landesh. Listat e landeve gjermane shërbejnë vetëm për të caktuar të zgjedhurit jo fitues në sistemin mazhoritar, gjë që duket e parapëlqyeshme për sistemin me atribuum vendesh kombëtare të sistemit Weill-Raynal: kështu evitohen listat e rrezikshme kombëtare. Së fundi, rregulli esencial i 5 % pa dyshim që ekziston vetëm në Gjermani. Superioriteti i sistemit gjerman na duket, pra, tepër i konsiderueshëm.

Ndarja e vendeve dhe numërimi i votave, si rrjedhim, janë të dyfishta. Në saje të votave të *zonave të vogla* një deputet është i zgjedhur në secilën me shumicë relative, por, ashtu si edhe në Britaninë e Madhe, *shumica absolute pothuajse është arritur*, pasi zgjedhësit janë të dënuar të votojnë **utile**, “anglezçe”. Kjo votë i bën ata të përqendrojnë votimin në dy kandidatët e vendosur më mirë. Ajo e ka çuar progresivisht Gjermaninë ta zvogëlojë në dy numrin e partive të saj në kuadrin e këtyre zonave të vogla, CDU-CSU, partia demokrate kristiane dhe SPD, partia socialiste gjermane, të cilat janë të vetmet që janë në gjendje të kenë të zgjedhur në këto zona, siç e kanë treguar zgjedhjet e 19 nëntorit 1972 dhe ato të 3 tetorit 1976.

Pas shpalljes së fituesve, fletët e votimit të *zonave të mëdha* përdoren për të ndarë të gjitha vendet e *Bundestagut* midis listave të secilës zonë sipas sistemit të *P.P. të listës të parafërt me mesataren më të lartë*. Më tej këto vende duhet t'i atribuohen kandidatëve nga listat e tyre. Kjo realizohet me teknikën e *P.P. klasik* që ne e kemi përshkruar, por vetëm *pas zbritjes së numrit të vendeve tashmë atribuar çdo partie nga votimi mazhoritar*.

Në qoftë se një parti ka të drejtën e 10 vendeve në një zonë të madhe, dhe pasi ajo tashmë ka marrë 5 vende me votimin mazhoritar në kuadrin e zonave të vogla, 5 vendet e tjera i jepen kandidatëve të kësaj partie sipas renditjes në listën e paraqitur nga partia në zonë. Dhe, meqënëse lejohet kandidimi njëkohësisht në dy llojet e zonave, nëse një kandidat ka fituar në votimin mazhoritar, kapërcehet emri i tij në listë, dhe kalohet në emrin që vijon.

Së fundi, *ky sistem i vështirë për t'u paraqitur nuk është aq i ndërlikuar dhe duket tepër i mirë, sepse ruan lirinë e zgjedhësit duke hequr efektet e listave të bllokura, të paktën për gjysmën e deputetëve: zgjedhësit janë, në fakt, të lirë të caktojnë në votimin mazhoritar, ashtu si e ndjejnë ata, gjysmën e deputetëve*.

Në fakt, në kuadrin e zonave të vogla, zgjedhësit kanë psikologjinë e

zgjedhësve britanikë. Ata votojnë **utile**, duke e zvogëluar numrin e kandidatëve seriozë deri në dy më të fortët, dhe po kështu bëjnë edhe partitë: refleksi polarizues i zgjedhësve dhe i partive, imponon bipartizmin në zonat e vogla. Mirëpo zgjedhësit, që votojnë **utile** në këto zona, nuk mund të pengohen të bëjnë të njëjtën gjë edhe në zonat e mëdha, meqë edhe të dy votimet kryhen njëkohësisht: *më shumë se 85% e zgjedhësve i zhvendosin refleksat e tyre të votimit **utile** në kuadrin e P.P., dhe normalisht mbi 90%.*

Kjo zhvendosje ka çuar në zvogëlimin e numrit të partive politike gjermane nga më shumë se dymbëdhjetë që ishin në vitin 1949, në *dy ose tre parti* që janë sot. Ky është një rezultat krejtësisht i shquar: sistemi, i cili ruan nga P.P. atë që ai ka të kënaqshme, domethënë drejtësinë e tij, ia ka dalë mbanë të heqë të metën e tij themelore, domethënë shpërndarjen e votave dhe shumimin e partive. Më në fund gjermanët kanë mundur të ndërtojnë, gjithmonë duke ruajtur P.P., *një sistem mazhoritar pothuajse bipartizan, duke shmangur mangësitë e ekzagjerimit të shumicave dhe të nënprfaqësimit të pakicave, të cilat shoqërojnë pashmangshmërisht sistemin mazhoritar të votimit.*

Megjithatë, *një numër i caktuar zgjedhësish refuzojnë ta zhvendosin votën e mazhoritarit te P.P.* Ata votojnë në sistemin P.P. për formacione të tjera: kështu, në vitin 1972, 8.5% e votave të shprehura kanë shkuar për partinë liberale gjermane (ose më zyrtarisht Partia e Lirë Gjermane), duke i dyfishuar votat e marra prej saj në vitin 1969 dhe në 7.9% në vitin 1976. Këta zgjedhës vepruan kështu me ndërgegjeje, për ta shpëtuar atë nga shpërndarja dhe gjithashtu për t'ia pakësuar fuqinë partisë së madhe fituese, partisë socialiste.

Ky thjeshtësim i sistemit në parti të pakësuar në tre ose më saktë dy e gjysëm apo dy e një çerek ndoshta nuk do të ishte arritur në qoftë se sistemi i përshkruar më lart nuk do të ishte plotësuar me *rregullën* aq të prerë dhe aq drakoniane, por shumë efikase *të 5 përqindëshit ose i tre vendeve të mazhoritarit* që treguam më sipër. Eksperienca tregon, në fakt, se një parti

që nuk merr 5% të votave nuk merr asnjëherë vendet e mazhoritarit në kuadrin e votimit gjerman, për shkak të efekteve të sistemit britanik njëëmëror me një raund. E kundërta ka ndodhur vetëm një herë, mirëpo si pasojë e manovrimeve mes njëres nga partitë e mëdha, CDU-së, dhe njëres nga partitë e vogla, të cilat praktikisht ishin në koalicion, CDU-ja vendosi të mos vihet përballë kandidatëve të kësaj partie në disa zona mazhoritare.

Ky rregull është i rreptë, sepse formacionet që kanë më pak se 5% të votave dhe asnjë vend në mazhoritar nuk mund të përfaqësohen. Megjithatë rregulli kontribuon me efikasitet dhe fatmirësisht në eliminimin e shumë partive të vogla. *Ai i shtohet votimit mazhoritar me një raund për t'i nxitur zgjedhësit që të votojnë **utile** në kuadrin e P.P.:* edhe në këtë kuadër ata kanë frikë të votojnë për formacione shumë të vogla, pasi i tremben mosmarrjes së 5 përqindëshit, kështu që, për të mos e shkuar dëm votën e tyre, ata votojnë për partitë më të rëndësishme.

Nëse ky rregull i dytë i votimit gjerman është i rreptë, fare lehtë ai justifikohet nga dëshira për të krijuar shumica parlamentare dhe qeverisëse efikase. Partitë e vogla janë kështu të detyruara të futen te të mëdhatë, ku formojnë tendenca të cilat luajnë një rol mjaft të dobishëm. Në fakt partitë e mëdha me prirje mazhoritare, nuk mund të jenë homogjene. Ato janë të detyruara të pranojnë në gjirin e tyre funksionimin e një demokracie të brendshme, e cila i lejon këtyre tendencave të ruajnë efikasitetin e vet.

Më në fund, *bashkimi i votimit britanik dhe i rregullit të 5 përqindëshit e ka çuar Gjermaninë në një bipartizëm të vërtetë, ose të paktën në një pothuajse bipartizëm, për shkak të prezencës së partisë liberale midis dy partive të mëdha, e cila mori afërsisht 10 % të votave, ndërsa dy partitë e mëdha grumbulluan në total më shumë se 90 % të votave. Ky është një fenomen shumë i dukshëm i një mazhorance të ekzagjeruar. Megjithatë, pothuajse të gjitha fenomenet e bipartizmit gjenden në Gjermani, megjithë mungesën e ekzagjerimit të mazhorancave.*

Një nga përparësitë e bipartizmit britanik mungon ndërkaq: konstituimi i

shumicave parlamentare të forta dhe homogjene, i përbërë nga të zgjedhurit e një partie të vetme. Por ndoshta përparësi përbën Gjermania, sepse *shumicat e koalicionit* të krijuara nga njëra prej partive të mëdha dhe një formacion i vogël ose nga dy partitë e mëdha (1966-1969) janë më të buta dhe më me mend. Ulja e numrit të partive gjermane është tepër i dukshëm, pasi RFGJ në vitin 1949 kishte pothuajse po aq parti sa kishte edhe Franca në po këtë vit.

E vërteta është që *ky pakësim është lehtësuar në mënyrë të konsiderueshme nga zhdukja e ekstremistëve, e shkaktuar kjo nga shkaqe të tjera, jashtë mënyrës së votimit. Vetë ky sistem, në fakt, është i paaftë që të eliminojë ekstremizmat.* Partia naziste u ndalua dhe nuk kishte më klientelë, për shkak të katastrofave ku regjimi nazist e çoi Gjermaninë; partia komuniste ishte zvogëluar në një numër qesharak, për shkak të heqjes së një pjese shumë të rëndësishme nga territori gjerman të komunistëve rusë, polakë dhe gjermanolindorë dhe të tregimeve të miliona refugjatëve të këtyre territoreve mbi ekzeset e pushtimeve dhe largimeve nga vendi. *Gjykata kushtetuese federale* ndaloi një parti të vogël neonaziste dhe partinë komuniste, por ky ndalim i vjetër nuk hoqi veçse disa parti që ishin në hekë ose që nuk kishin asnjë rëndësi. Suksesin shumë të dobët të një partie të ekstremit të djathtë, NDP, rreth vitit 1969, dhe rënien e saj në vitin 1972 dhe 1976, e provojnë edhe rezultatet e parëndësishme të një partie të re komuniste (të lejuar). Megjithatë, përparësia e krijuar me zhdukjen e ekstremistëve, nuk mjafton për të shpjeguar suksesin gjerman lidhur me pakësimin e numrit jashtëzakonisht të madh të partive të vitit 1949, disa prej të cilave ishin të vendosura shumë djathtas ose shumë majtas.

Pakësimi i partive gjermane në pothuajse dy parti është pa dyshim frut i mënyrës së votimit, e ndihmuar, kjo është e vërtetë, nga një kushtetutë e shkëlqyer, e cila ka vendosur një sistem parlamentar klasik dhe tepër të ekuilibruar. Kjo mënyrë votimi ka çuar jo vetëm në pakësimin e numrit të partive, por edhe në moderimin e programeve të tyre ashtu si në Britaninë e Madhe, ku CDU-CSU-ja ngajjnë shumë me partinë konservatore britanike

dhe SPD-ja gjithmonë e më tepër me partinë laburiste. Transformimi i SPD-së që më i ngadaltë: asaj iu deshën nja dymbëdhjetë vjet për këtë, ndërsa ai i DDU-së u krye që në fillim të legjislaturës së parë (1949-1953). Megjithatë ky transformim i socialistëve gjermanë ishte pothuajse i kryer në fillim të legjislaturës së tretë (1957-1961). Mënyrat e votimit i japin efektet e tyre vetëm pas një farë kohe, me kusht që të ruhen mirë.

Hyrja e të “Gjelbërve”, domethënë e “ekologjistëve” në Bundestag gjatë zgjedhjeve të marsit 1983 me 5.6% të votave të shprehura dhe përmirësimi i këtij rezultati me 8.3% në vitin 1987, ndërsa liberalët e FDP-së qëndronin në nivelin e tyre të zakonshëm (7% më 1983 dhe 9.7% në vitin 1987) i zbeh pak realizimet dhe pohimet e mësipërme. Megjithëkëtë kjo zbehje është e lehtë, sepse dy partitë e mëdha ruajnë pozitën e tyre të forta dhe liberalët rolin e tyre të partisë lidhëse pothuajse domosdoshmërisht në aleancë me njëjërën prej dy partive të mëdha për konstituimin e shumicave dhe qeverive.

\* \* \*

Ndryshimi themelor i sistemit të partive gjermane është jashtëzakonisht inkurajues për vendet e tjera demokratike: ai provon se është e mundur t’ia arrish kësaj duke organizuar sistemin e votimit dhe sistemin kushtetues në mënyrë të kënaqshme. Kështu, një ndryshim i mënyrës së votimit mund të sjellë përmbysjen e regjimit politik. Për shembull, është e evidente se zëvendësimi i votimit njëëmëror me një raund në Britaninë e Madhe do të përbente për këtë vend një revolucion kushtetues. Po kështu sot, zëvendësimi i sistemit zgjedhor gjerman me një tjetër, mund të bëhej shkak për rilindjen përtej-Rinit të një sistemi shumëpartiak tepër të dëmshëm. Në Francë, vendosja e sistemit të votimit gjerman do të sillte rezultate interesante, por shumë të ndryshme nga ato të Gjermanisë, për shkak të ekstremitetit të majtë francez, i cili do të forcohej konsiderueshëm. Duke vepruar në një mënyrë krejt tjetër, votimi ynë mazhoritar njëëmëror me dy raunde i

vendosur në vitin 1958 dhe sistemi i zgjedhjeve presidenciale vendosur në vitin 1962, e kanë modifikuar ndjeshëm sistemin e partive franceze.<sup>11</sup>

Këto konstatime tregojnë gjithashtu se një sistem politik nuk mund të kuptohet pa njohjen e sistemit të tij të votimit dhe lidhjes që ka ai me kushtetutën në fuqi. Por ai nuk mund të zbulohet pa analizën e sistemit të partive që janë të lidhura ngushtë me kushtetutën dhe me mënyrën e votimit.

---

<sup>11</sup> Studimi i mënyrave të votimit është zhvilluar shumë më tepër në leksionet tona mbi institucionet politike dhe të drejtën kushtetuese publike në vitet 1972-1973 dhe 1973.









